

Shkurt 2015
Numri: 83
E përmuajshme

Revistë edukative-kulturore - www.revistaetika.com

ETIKA

Shqipëri: 200 Lekë
Kosovë: 1.5 Euro
Maqedoni: 90 Den
Evropë: 7 Euro




TA BËSH SHPIRTIN
FOLE MËSHIRE
OSMAN NURI TOPBASH



ALI RIZA TEMEL
IHLAS DHË IFLAS



DR. KERIM BULLADË
PËLQIMI I ALLAHUT



GRAHAM E. FULLER
NJË BOTË PA ISLAMIN



NJËRIU I LIRË
I KOHËVE MODERNE
NUREDIN NAZARKO



EDISON ÇERAJ
RRNO EDHE PËR ME KUJTUE


Ekvilibri *ne te*



ISSN 2227-3611
9 772227 361004 02

Arsyeja dhe Filozofia

IRI



Një notar profesionist mund të notojë në ujëra të thella pa frikë, duke shijuar në këtë mënyrë bukuritë nënujore. Nuk ka asnjë problem për një besimtar cilësor, i cili ka njohuri të mjaftueshme rreth fesë së tij, të shëtisë nëpër kulturat e popujve të tjerë. Problem është të notosh në ujëra të thella pa ditur not. E rrezikshme është të përballesh me kulturat, botëkuptimet dhe rrymat e tjera filozofike, pa pasur njohuritë e duhura rreth Islamit. Në këtë rast ekziston rreziku për të mbetur nën ndikimin e tyre.

Një tjetër problem që ka sjellë filozofia, është përpjekja e disa pseudofilozofëve dashamirë dhe admirues të filozofisë perëndimore, për ta bazuar mendimin islam mbi themele filozofike. Kjo është një përpjekje tinëzare për të vendosur arsyen mbi shpalljen hyjnore.

TË
RËNË



Shkurt 2015

VITI: IX
NUMRI: 83

BOTUESI
Shtëpia botuese "Progresi"

DREJTOR
Albert Halili

KRYEREDAKTOR
Alban Kali

REDAKTOR
Zija Vukaj

PËRKTHYES
Albert Halili
Artur Tagani
Fatmir Sulaj
Ilir Hoxha

DIZAJN
Bledar Xama

ADRESA
Rr: Studenti; Sheshi "2 Prilli"
Shkodër; Shqipëri

MOBILE
+355 67 607 8484

E-MAIL
rev.etika@gmail.com

WEBSITE
www.revistaetika.com

KOSOVË
Rr: Ardian Zurnaxhiu; pn. Ralin
Prizren; Kosovë
Mob: +377 4411 9848

MAQEDONI
Drvarska 28; Stara Carsija
Skopje; Makedonija
Mob: +389 7042 8245

ABONIMI VJETOR
Shqipëri: 2000 lekë
Kosovë: 15 Euro
Maqedoni: 900 Denar
Evropë: 80 Euro

Ju bëjmë të ditur se materialet e sjella në redaksi pavarësisht nëse botohen apo jo nuk i kthehen autorit. Kaha e botimit të një materiali përcaktohet nga redaksia. Honoraret e shkrimeve autoriale ose përkthimeve duhet të vini t'i l'ihiqni pranë Shtëpisë Botuese "Progresi" ose pranë zyrove të përfaqësimit në Kosovë dhe Maqedoni.

Në botën ku jetojmë, po dëshmojmë qëndrime të ndryshme në emër të Islamit, por që "e kapërcejnë masën Islame". Ekzistojnë shumë shembuj që shpalsin pamjen e një Islami jashtë vijës origjinale të Kuranit dhe të Pejgamberit (a.s.), të cilët thonë "xhihad" dhe e nxjerrin xhihadin jashtë masës së caktuar në Kuran; thonë "teuhid" dhe e kthejnë atë në një shpatë për "tekfîr"; madje thonë edhe asketizëm, duke e kthyer në një izolim prej shoqërisë.

"O besimtarë! Bëhuni të qëndrueshëm në urdhrat e Allahut dhe bëhuni dëshmuës me drejtësi! Le të mos ju nxisë urrejtja ndaj njerëzve për të bërë padrejtësi. Bëhuni të drejtë, se kjo është më afër devotshmërisë dhe frikësojuni Allahut! Pa dyshim, Allahu është i Dijshëm për çdo gjë që punoni ju." (Maide, 8)

"...Hani e pini, por mos e tepronit!.."

"Mos ia ndaloni vetes gjërat e mira, të cilat Allahu jua ka lejuar dhe mos e kaloni kufirin! Vërtet, Allahu nuk i do ata që e kapërcejnë kufirin." (Maide, 81)

"Thuaju (o Muhammed!): "Vallë, a do ta mësoni Allahun për fenë tuaj, ndërkohë që Ai di gjithçka që përmbajnë qiejt dhe Toka? Allahu është i Dijshëm për çdo gjë:" (Huxhurat, 16)

Kur Pejgamberi ynë (a.s.), ka thënë: "Padyshim që kjo fe është lehtësim. Kush e vështirëson, ajo (feja) e mposhtë (bëhet e rëndë) atë", në fakt e ka parashikuar që edhe "në fe mund të kalohet masa" dhe, për këtë arsye i ka paralajmëruar besimtarët.

Ky hadith, na e tregon në mënyrën më të bukur maturinë e Pejgamberit tonë (a.s.), në bartjen e Islamit në brendësi të jetës:

Enes bin Malik (r.a.), tregon:

Tre prej sahabëve shkuan tek gratë e Pejgamberit (a.s.), që të mësonin më tepër në lidhje me adhurimet që Resulullahu (a.s.), i kryente fshehurazi në shtëpinë e tij. Kur i mësuat adhurimet që Pejgamberi (a.s.), kryente në shtëpi, iu dukën pak dhe thanë:

- Ne nuk jemi si i Dërguari i Allahut, sepse Allahu ia ka falur të gjitha gjynahet e të shkuarës dhe të ardhmes.

Njëri prej tyre tha:

- Sa të rroj, nuk do të fle fare natën, por do të fal namaz.

I dyti tha:

- Edhe unë do të agjëroj çdo ditë gjatë gjithë jetës!..

Ndërsa i treti tha:

- Kurse unë do të qëndroj larg grave dhe nuk do të martohem kurrë!..

Pas njëfarë kohe, Pejgamberi (a.s.), shkoi tek ata dhe u tha:

"- Ju jeni ata që keni thënë këto fjalë? Shikoni këtu! Beto hem në Allahun se, unë jam ai që e ka më tepër frikë Allahun ndër të gjithë ju. Mirëpo, disa ditë i agjëroj, e disa të tjera nuk i agjëroj. Natën fal edhe namaz, fle edhe gjumë. Martohem edhe me gratë. Kush i kthen shpinën Sunetit (rrugës) tim, nuk është prej meje." (Buhari, Nikah, 1)

Përmbajtja



Zotimi për dashuri dhe unitet vëllazëror
Ma. Muhidin Ahmeti

28



8

Një jetë e ekuilibruar shpirtërore
Prof. dr. Sulejman Derin




Ta bësh shpirtin fole mëshire
Osman Nuri Topbash

34



10



22


Një botë pa Islamin
Graham E. Fuller

- 5 Ekuilibër dhe maturi
Ahmet Tashgetiren
- 10 Besimtari i vërtetë
Prof. dr. Ismail Lutfi Çakan
- 12 Islami për të drejtat e kafshëve
Nexhat Ibrahim
- 16 Ihlas dhe Iflas
Ali Riza Temel
- 18 Rrno edhe për me kujtue
Edison Çeraj
- 21 Pejgamberi (a.s.) dhe jeta jonë
Ali Byjyqçapar
- 27 Dita e llogarisë
Sadik Dana
- 32 Një Ajet - Një Hadith



52

- Njeriu, kjo genie e preferuar e Zotit 42
Ejmen A. Ismaili
- Thelbi i çështjes 44
është në fillimin e punës
Doç. dr. Harun Egmysh
- Ganxhat mbi urën e Siratit 48
Dr. Murat Kaja
- Kushtet e të qenit njeri me shpresë 50
Xhafer Durmush
- Bashkë me të rinjtë në rrugën e edukimit 52
Idris Arpat
- Pëlqimi i Allahut 55
Dr. Kerim Bulladë
- Adhuroje Zotin tënd derisa 56
të të vijë dija e qartë!
Mustafa Erish




Njeriu i lirë i kohëve moderne
Nureddin Nazarko

40

Çfarë gjuhe të huaj do të mësojmë në shkollë?
Michael A. Morris

46





EKUILIBRI DHE MATURIA

Ahmet Tashgetren

Ekuilibër: Do të thotë të ruash masën e duhur dhe të mos e kapërcesh atë.

Maturi: Do të thotë të ruash drejtësinë, të mos e teprosh, të mos kalosh kufijtë dhe të mos anosh nga dhuna e padrejtësia.

Lidhja me Islamin, në fakt është një lidhje që ka të bëjë me organizimin e vetes brenda një ekuilibri të caktuar në të gjitha fushat, si në gjykim, ndjenja, sjellje etj. Madje, Allahu i madhëruar ka vendosur një ekuilibër të caktuar edhe në gjendjen e devotshmërisë.

Lidhur me këtë, Kurani është i mbushur me paralajmërime, ndërsa vetë Pejgamberi ynë (a.s.), në këtë pikë ua ka tërhequr vëmendjen myslimanëve në shumë raste.

Në botën ku jetojmë, po dëshmojnë qëndrime të ndryshme në emër të Islamit, por që “e kapërcejnë masën Islame”. Ekzistojnë shumë shembuj që shpallin pamjen e një Islami jashtë vijës origjinale të Kuranit dhe të Pejgamberit (a.s.), të cilët thonë “xhihad” dhe e nxjerrin xhihadin jashtë masës së caktuar në Kuran; thonë “teuhid”² dhe e kthejnë atë në një shpatë për “tekfir”³; madje thonë edhe asketizëm, duke e kthyer në një izolim prej shoqërisë.

Ëjani të shohim zbatimet e Kuranit dhe Pejgamberit tonë (a.s.) dhe prej këtyre burimeve kryesore të Islamit,

1. - **Xhihad:** [Arb.] Përpjekje, luftë, mund, punë.

2. - **Teuhidit:** [Arb.] Monoteizëm; Besimi në një zot të vetëm.

3. - **Tekfir:** [Arb.] Akuzimi i dikujt si mohues i Zotit ose dalje nga feja.

të bartim ekuilibër dhe maturi në jetën tonë.

Për shembull, ky ajet i fal besimtarit një “frymë disiplinë” të tillë, të cilën nëse e bartim në jetën tonë, mbase do të mund të largohemi prej atmosferës së urrejtjes individuale e shoqërore që dallgëzon zemrat tona.

“O besimtarë! Bëhuni të qëndrueshëm në urdhrat e Allahut dhe bëhuni dëshmues me drejtësi! Le të mos ju nxisë urrejtja ndaj njerëzve për të bërë padrejtësi. Bëhuni të drejtë, se kjo është më afër devotshmërisë dhe frikësojuni Allahut! Pa dyshim, Allahu është i Dijshëm për çdo gjë që punoni ju.” (Maide, 8)

Për shembull, nëse ajeti, **“...Hani e pini, por mos e tepronit..”**⁴ do ta disiplinonte jetën tonë, mbase nuk do të kishim më nevojë të kacafytemi me kaq shumë sëmundje të aparatit tretës, ose t’i futemi dietave të ndryshme.

Kujdesi në çështjen e ushqimeve hallall, është i rëndësishëm. Por, Kurani edhe aty na paralajmëron, duke thënë: **“Mos ia ndaloni vetes gjërat e mira, të cilat Allahu jua ka lejuar dhe mos e kaloni kufirin! Vërtet, Allahu nuk i do ata që e kapërcejnë kufirin.”** (Maide, 81)

Na duhet të mendojmë edhe faktin se, në sa e sa raste na drejtohet neve ky ajet:

“Thuaju (o Muhammed!): “Vallë, a do ta mësoni

4. Araf, 31.

Allahun për fenë tuaj, ndërkohë që Ai di gjithçka që përmbajnë qiejt dhe Toka? Allahu është i Dijshëm për çdo gjë.” (Huxhurat, 16)

Kur Pejgamberi ynë (a.s.), ka thënë: *“Padyshim që kjo fe është lehtësim. Kush e vështirëson, ajo (feja) e mposhtë (bëhet e rëndë) atë.”*⁵, në fakt e ka parashikuar që edhe “në fe mund të kalohet masa” dhe, për këtë arsye i ka paralajmëruar besimtarët.

Ky hadith, na e tregon në mënyrën më të bukur maturinë e Pejgamberit tonë (a.s.), në bartjen e Islamit në brendësi të jetës:

Enes bin Malik (r.a.), tregon:

Tre prej sahabëve shkuan tek gratë e Pejgamberit (a.s.), që të mësonin më tepër në lidhje me adhurimet që Resulullahu (a.s.), i kryente fshehurazi në shtëpinë e tij. Kur i mësuuan adhurimet që Pejgamberi (a.s.), kryente në shtëpi, iu dukën pak dhe thanë:

- Ne nuk jemi si i Dërguari i Allahut, sepse Allahu ia ka falur të gjitha gjynahet e të shkuarës dhe të ardhmes.

Njëri prej tyre tha:

- Sa të rroj, nuk do të fle fare natën, por do të fal namaz.

I dyti tha:

- Edhe unë do të agjëroj çdo ditë gjatë gjithë jetës!..

Ndërsa i treti tha:

- Kurse unë do të qëndroj larg grave dhe nuk do të martohem kurrë!..

Pas njëfarë kohe, Pejgamberi (a.s.), shkoi tek ata dhe u tha:

“- Ju jeni ata që keni thënë këto fjalë? Shikoni këtu! Beto hem në Allahun se, unë jam ai që e ka më tepër frikë Allahun ndër të gjithë ju. Mirëpo, disa ditë i agjëroj, e disa të tjera nuk i agjëroj. Natën fal edhe namaz, fle edhe gjumë. Martohem edhe me gratë. Kush i kthen shpinën Sunetit (rrugës) tim, nuk është prej meje.” (Buhari, Nikah, 1)

Në një hadith të ngjashëm, bëhet fjalë për një tjetër grup sahabësh, të cilët vendosin që, “prej andej e tutje, të hiqnin dorë nga kjo botë, të ndaheshin prej ndjenjave mashkullore duke tredhur veten, ditët t’i kalojnë me agjërim, ndërsa netët në këmbë me adhurim dhe pa fjetur, të mos hanë mishin dhe produktet e tij, të mos u afrohen grave, të mos parfumohen me aromë të mirë dhe të mos shëtitin mbi tokë”. Por, Resulullahu (a.s.), edhe këtij grupi sahabësh ia tërheq vëmendjen duke i thënë: *“Unë nuk jam urdhëruar me këto!”* Më pas, i

mbledh sahabët dhe u tërheq vëmendjen në mënyrë kolektive. Këto, janë edhe kriteret që i Dërguari i Allahut (a.s.), i ka vendosur para popullit Islam:

“Çfarë u ka ndodhur disave, që ia ndalojnë (bëjnë haram) vetes martesën me gratë, ngrënien dhe pirjen, parfumosjen me aromë të mirë, fjetjen dhe kënaqësitë e lejuara të kësaj bote? Padyshim, se unë nuk ju urdhëroj të bëheni murgjër. Në fenë time, ashtu siç nuk ka gjëra të tilla si braktisja e ushqimit dhe largimi nga gratë, nuk ka as braktisje të kësaj bote, duke u mbyllur nëpër manastire. Udhëtimi i populli tim është agjërimi, ndërsa murgjëria e tyre është xhihadi. Adhurojeni Allahun, mos i shoqëroni Atij asnjë ortak, kryeni haxhin dhe umren, falni namazet tuaja, jepni zekatin dhe agjëroni Ramazanin. Bëhuni plotësisht të drejtë, që të bëhen edhe të tjerët. Popujt para jush, janë shkatërruar për shkak të teprimeve të tyre. Ata ia vështirësuan vetes fenë dhe Allahu ua vështirësoi edhe më tepër. Ata që ndodhen sot nëpër kisha dhe manastire, janë ata që kanë mbetur prej tyre.” (Ali Kari, Mirkat, I, 182-183)

Diçka e ngjashme ndodhi edhe në lidhje me gratë.

Sipas një transmetimi të Aishes (r.a.), kur ajo ishte ulur dhe po bisedonte së bashku me një grua, Pejgamberi (a.s.), u afrua dhe pyeti:

- Kush është kjo grua?

Pasi nëna jonë Aishe (r.a.), e prezantoi, “Kjo është filan grua”, i thotë edhe se ajo falte shumë namaz. Pas kësaj Resulullahu (a.s.), thotë:

“Lëri mos m’i numëro këto: juve ju mjafton të bëni adhurime aq sa keni mundësi. Beto hem në Allahun se pa u mërzitur e lodhur ju, nuk mërzitet e nuk lodhet as Allahu.” (Buhari, Iman 32.)

Sipas një transmetimi të Abdullah Ibni Mes’udit (r.a.), Resulullahu (a.s.), ka thënë:

“Ata që e kanë tepruar dhe kanë kaluar kufijtë në fjalë dhe vepra, janë shkatërruar.” Këtë shprehje, Resulullahu (a.s.), e ka përsëritur tre herë. (Muslim, IIm, 7.)

Enesi (r.a.), ka thënë:

Kur Pejgamberi (a.s.), hyri në xhami, i vajtën sytë tek një litar të shtrirë midis dy shtyllave dhe pyeti:

- Ç’është ky litar? Sahabët u përgjigjën:

- Ai është litari i Zejneb Binti Xhahsh. Kur lodhet së qëndruari në namaz, kapet pas tij. Me të dëgjuar këto fjalë, Resulullahu (a.s.), urdhëron:

“Zgjidheni menjëherë atë. Kur dikush prej jush e ndjen veten në formë dhe të vullnetshëm, le të falë namaz nafilë (vullnetar). Por, kur ndjehet i lodhur dhe i

**Në botën
ku jetojmë,
po dëshmojnë qëndrime
të ndryshme në emër
të Islamit, por që “e
kapërcejnë masën
Islame”. Ekzistojnë shumë
shembuj që shpalosin
pamjen e një Islami jashtë
vijës origjinale të Kuranit
dhe të Pejgamberit
(a.s.).**

⁵ Buhari, Iman, 29.

pavullnetshëm, le të shkojë të flejë!" (Buhari, Tehexh-xhud 18)

Ebu Xhuhajfe Uehb Ibn Abdullah (r.a.), ka thënë:

Resulullahu (a.s.), Selman Farisiun dhe Ebu Derdan (r.anhuma), i bëri vëllezër. Për këtë arsye Selmani (r.a.), e vizitonte shpesh Ebu Derdan (r.a.). Gjatë një vizite, vuri re se gruaja e tij, Ummu Derda, ishte e veshur me rroba të vjetra. Kur e pyeti:

- Pse je në këtë gjendje?, gruaja i tha:

- Vëllai yt, Ebu Derda, nuk i jep rëndësi pasurisë dhe kënaqësive të kësaj bote.

Atë çast, në shtëpi erdhi Ebu Derda, i cili duke e gostitur Selmanin me ushqimin që ishte përgatitur, i thotë:

- Urdhëroni, hani se unë jam agjërueshëm. Mirëpo, Selmani e kundërshtoi duke i thënë:

- Pa ngrënë ti, nuk ha as unë. Për këtë arsye, Ebu Derda u ul në sofër dhe hëngri bukë. Kur ra nata, Ebu Derda po përgatitej të falte namaz nate. Mirëpo, Selmani i thotë:

- Fi! Prandaj Ebu Derda ra të flejë. Pas një farë kohe, ai u përpoq të ngrihet përsëri, por Selmani përsëri i tha, "Fi!", duke mos e lënë të ngrihet. Drejt fundit të natës, Selmani i thotë:

- Ngrihu tani! Dhe të dy së bashku falën namaz. Më vonë, Selmani i thotë Ebu Deras:

- Tek ty kanë të drejta; Zoti yt, vetja dhe familja jote. Jepi gjithsecilit të drejtën që i takon!

Më vonë, Ebu Derda shkoi tek Resulullahu (a.s.) dhe i tregoi gjithçka ç'kishte ngjarë. Ndërsa Resulullahu (a.s.), i tha:

"Selmani ka thënë të drejtën!" (Buhari, Edeb, 86.)

Fuqia e cila ka vendosur masën/kriterin, ia ka bërë të ditur njerëzimit edhe ruajtjen e kësaj mase si një ligj i Kuranit.

"Ai e ka vendosur masën. Mos e kaloni kufirin e saj. Ruajeni masën dhe mos lejoni tejkalimin e saj!"

DELIKAT, AQ SA PETALJA E TRËNDAFILIT

"Ruajtja e masës", i jep myslimanit një karakter organizues brenda jetës; e bën atë një përmirësues dhe gjallërues. Në lidhje me dijetarin Islam Meulana Xhami (1414-1492), i cili njihet edhe si Molla Xhami, tregohet një ndodhi, e cila në mënyrë të goditur, shpalos para nesh "personalitetin e myslimanit":

Dijetarët, poetët, shkrimtarët dhe të urtët më të njohur në kohën e tij, kishin formuar një këshill, të cilin e quanin "Këshilli i të Heshturve". Dhe, numri i anëtarëve të këtij këshilli, ishte mbajtur i kufizuar vetëm me tridhjetë vetë. Edhe Meulana Xhami dëshironte të bëhej pjesë e këtij këshilli. Mirëpo, numri i kufizuar i anëtarëve, nuk i jepte atij mundësi të bëhej anëtarë i këtij këshilli.

Një ditë, Meulana Xhami dëgjon se një prej anëtarëve

të këshillit kishte ndërruar jetë. Dhe, ndërkohë që këshilli ishte duke mbajtur një mbledhje në lidhje me këtë ngjarje, ai shkon në ndërtesën ku mbahej mbledhja. Para derës qëndronte një roje, të cilit pa i thënë asnjë fjalë, i dha një letër ku shkroi atë që kërkonte dhe e dërgoi brenda.

Anëtarët e këshillit e njihnin mirë Meulanën. Por, para pak ditësh kishin marrë dikë tjetër në vend të anëtarit që kishte ndërruar jetë. Mirëpo, për ta ishte e vështirë ta kthenin mbrapsht një njeri si Meulana Xhami, duke i thënë thjesht "nuk mund të të bëjmë anëtar". Ata u menduan gjatë midis tyre. Më në fund, e dërguan rojën tek Meulana me një gotë të mbushur plotë me ujë. Me këtë, deshën t'i shpjegonin se numri i anëtarëve të këshillit ishte i plotësuar dhe se nuk kishte vend për dikë tjetër. Kur Meulana Xhami e pa rojën që po vinte me një gotë të mbushur plot me ujë, e kuptoi menjëherë se çfarë kishin dashur të thoshin anëtarët e këshillit. Prandaj, mori një petale nga trëndafilat që ndodheshin aty pranë dhe e vendosi me kujdes mbi sipërfaqen e ujit në gotë...

Natyrisht që petalja nuk ndikoi aspak në derdhjen e ujit prej gotës. Kur anëtarët e këshillit e panë gotën me ujë t'u vinte me një petale trëndafil sipër, e kuptuan menjëherë çështjen. Për këtë arsye, ata vendosën ta ngrënë numrin e anëtarëve mbi tridhjetë vetë për hir të Meulanës. Kur Meulana Xhami hyri në këshill, kryetari shënoi edhe emrin e tij në listë. Pastaj, duke vendosur një zero pas numrit tridhjetë, ia dha listën Meulanës. Me këtë, kryetari dëshironte të shprehte se me pjesëmarrjen e Meulanës, vlera e këshillit u shtua dhjetëfish. Mirëpo, kur Meulana e mori listën në dorë dhe e kuptoi domethënien e numrit, e fshiu zeron pas tridhjetës dhe e shkroi para saj, duke treguar se nuk ishte dakord me atë mendim. Me këtë përgjigje, Meulana shprehu mendimin se jo vetëm që numri i anëtarëve të këshillit nuk ishte shtuar, por, ai la të kuptohet se në këtë mexhlis ai nuk ishte më shumë se një zero.

Me përgjigjen e fundit që dha dhe me respektin e modestinë që tregoi, Meulana Xhami u bë një nga anëtarët më të çmuar të këshillit të të Heshturve.

Ky, është njeriu i cili nuk është i tepërt në vendin ku ndodhet, nuk është problem, e zbukuron dhe i jep vlerë atij vendi... Ky është edhe shembulli i një myslimani të mirë.

Përmbledhje: Nuk mund të ketë myslimanizëm jash-të kriterëve që ka përligjur Allahu i Madhëruar të cilat janë reflektuar në jetën e pastër të Pejgamberit tonë (a.s.). Çdo mysliman dhe çdo shoqëri islame, sot, nesër dhe në të gjitha kohërat, është e detyruar të pajiset me një identitet Islam brenda kriterëve/masës që ka caktuar Kurani dhe Resulullahu (a.s.). Kjo, do të thotë të bëhesh "njeriu i mëshirës së umetit të Pejgamberi të mëshirës".



Një jetë e ekuilibruar shpirtërore

I nderuari Imam Gazali thotë se *istikameti* që përmendet në ajetin: **“Prandaj qëndro i patundur në udhën e drejtë, ashtu siç je i urdhëruar...”** (Hud, 112), është ekuilibri. Vështirësia e *istikamet-it*, që ia pati thinjur flokët Pejgamberit (a.s.), nuk ishte thjesht në kuptimin *“ecja e drejtë në rrugën e vërtetë”*. Pasi kjo gjë është e lehtë për pejgamberët, por ajo që është e vështirë është të mbash ekuilibrin në *istikamet*; të respektosh urdhrat e Allahut, pa e tepruar. Për shembull, një njeri mund të jetë mjaft bujar, por në një vend që duhet të jepen njëqind lekë, jep njëqind mijë lekë dhe kjo nuk përshtatet me *istikamet-in*. Pikërisht ky ekuilibër, kjo drejtësi ishte, sipas Gazalit, ajo çfarë i shkaktoi zbardhjen e flokëve të Pejgamberit (a.s.).

Nuk është e lehtë që njeriu të gjejë ekuilibrin e duhur në jetë, veçanërisht në jetën shpirtërore. Sufitë janë dalluar për këtë; kanë qenë vetë ata që kanë kritikuar ata që nga radhët e tyre e kishin tepruar. Veçanërisht ky aspekt i Imam Rabbanit është për t'u lavdëruar. Qasja e tij është bërë një etalon ekuilibri për dijetarët, sufitë dhe të tjerët në përgjithësi.

Sipas Imamit, fusha më e rëndësishme në të cilën duhet bërë më shumë kujdes mbi ekuilibrin, është fusha e besimit (itikad). Ajo çfarë bëri dallimin mes fraksioneve të vërteta islame dhe atyre jo të sakta, është pikërisht

ky teprim i bërë në fushën e besimit. Për shembull, shiitë e kanë tepruar me dashurinë dhe urrejtjen; ndërkohë që një pjesë të sahabëve i lavdërojnë dhe e çojnë deri aty masën e lëndatave, sa që thuajse i bëjnë njerëz të pagabueshëm, një pjesë tjetër të sahabëve i paraqesin si krejtësisht negativë. Ndërkohë që, Ehli Suneti duke bërë kujdes që të mos bëhet pre e asnjë lloj teprimi, ka përqafuar të gjithë sahabët fisnikë. Imami e shpreh me këto fjalë kujdesin ndaj çështjeve besimore:



Të udhëzoftë Allahu i Madhëruar në rrugën e drejtë!
Dije që, ajo çfarë nevojitet për një rrugëtar të rrugës së vërtetë (salik) është rregullimi i besimit. Besimi i rregullt është besimi që kanë mësuar dhe kuptuar dijetarët e Ehli Sunnetit nga Kurani Famëllartë, nga hadithet fisnike dhe nga sahabët besnikë. Ata që kuptojnë siç duhet domethënien e Kuranit Famëllartë dhe të haditheve fisnike, janë dijetarët e rrugës së drejtë. Këta janë dijetarët e Ehli Sunneh uXhem'a. (Letra e 286-të)

Disa nga sufitë e ditëve të sotme janë mbështetur në besime të gabuara lidhur me çështjet e besimit (itikad), duke u bazuar në frymëzimet (ilham) dhe zbulimet (keshf) e tyre. Madje, përbuzin diturinë e njerëzve të apologetikës islame (kelam) dhe të jurisprudencës islame (fikh), duke i thënë dije sipërfaqësore. Gabimin në këtë qasje Imami e shpreh kështu:

Në mesin e njohurive të profecisë dhe velajetit, dallimi i dytë është që shpallja hyjnore është një dije e saktë. Kurse frymëzimi (ilham) është i lidhur me hamendësimin. Kurse vahji vjen me engjëll dhe engjëlli është i mbrojtur prej gabimeve, është inocent, pasi ashtu është krijuar, ndaj dhe nuk gabon. Sado që zemra është e hapur ndaj frymëzimit, ndonëse është nga Bota e Urdhrave (alemi emir) dhe në një status sublim, duke qenë se frymëzimi rrjedh domosdoshmërisht dhe njëkohësisht edhe nga arsyeja dhe nefsi, ajo përsëri mund të mos i shmanget gabimit të mundshëm në perceptimin e frymëzimit (në-përmjet ndikimit negativ të tyre). (Letra e 41-të)

Një tjetër pikë, mbi të cilën ndalet me vendosmëri Imam Rabbani, gjë e cila ka bërë që Tasavvufi të pasurohet, është edhe shmangia nga disa teprime në ibadete. Bie në sy përparësia që u kanë dhënë sufitë ibadeteve vullnetare si dhikri dhe sema-ja, duke lënë në plan të dytë veprime parësore në Islam. Sipas Imamit, rrugëtari i tasavvufit (salik), duhet që t'i kalojë në plan parësor farzet, në mënyrë që t'i bëjnë dobi përkujtimi i Zotit në mënyrë ceremoniale (dhikri), meditimi (fikir) dhe për-

Nuk duhet harruar që shejtani qarkullon në ifrat dhe tefrit (dy skajet e ekstremizmit). Fillimisht përpiqet që ta pengojë salikun të bëjë vepra të mira, pastaj, nëse nuk ia arrin, atëherë ia prish veprën përmes teprimit që ia ngulit në veprime. Për shembull, shejtani ndërkohë që përpiqet t'i largojë disa gafilë nga evlijatë e Zotit, murshidët, disa të tjerë bën që ta teprojnë apo të devijojnë me vepra kundrejt tyre.

pjekja islame (muxhahede):

Duhet ditur mirë se për t'i bërë dobi dhikri salikut, mbi të gjitha është e domosdoshme kryerja e të gjithë rregullave të shariatit. Ajo çfarë pikësëpari duhet të bëjë saliku, është të kryejë me përpikëri farzet dhe sunetet; të ruhet nga haramet dhe gjërat e dyshimta. Ndërkohë që bën këto, të vogla apo të mëdha qofshin, saliku duhet t'u referohet gjithnjë dijetarëve dhe fetvave të tyre. (Letra e 190-të)

Kësisoj, saliku nuk duhet të mbesë mbrapa mësimit të dijeve dhahiri. Nuk duhet neglizhuar dija e shariatit, pse po mëson dijen batini. Imami, i cili është tepër i përpiktë në këtë çështje, i qorton në këtë mënyrë pasardhësit e vet:

Ashtu sikurse lexohen veprat e tasavvufit në tubimet e nderuara, duhen lexuar edhe veprat e fikhut. Gjenden plot libra të fikhut të shkruara në persisht. Fjala vjen, Mexhmua-i Hani, Umdetul-Islam dhe Kenz-i janë të shkruara persisht. Madje, edhe sikur të mos lexohen librat e tasavvufit, nuk bëhet ndonjë dëm, sepse sidoqoftë, ato kanë të bëjnë me gjendjen dhe gjendja nuk mund të kufizohet me fjalën e llafet. Kurse dëmi që vjen nga mosleximi i librave të fikhut është më i mundshëm. (Letra e 19-të)

Përveç kësaj, Imam Rabbani këshillon që të bëhet kujdes me teprimin që mund të bëjnë salikët, ndërkohë që respektojnë murshidët (prijësit shpirtëror të tasavvufit). Pasi në mesin e sufive vërehen shpeshherë sjellje të tilla të paekuilibruara. Madje, duke u nisur nga kjo, perëndimorët mendojnë se sufitë adhurojnë evlijatë. Imami, për të shmangur këto lloj keqkuptimesh, rekomandon:

Sipas asaj që na transmeton një njeri i yni i besueshëm, muridët e një kalifi (prijësi sufi), nuk mjaftohen vetëm me puthjen që i bëjnë tokës përballë, por edhe i bëjnë sexhde personit. Shëmtimi i kësaj sjelljeje është më i qartë sesa vetë dielli. Pengojeni në mënyrë të prerë atë njeri nga kjo sjellje. Çdonjëri që është shfaqur për të drejtuar njerëzit, duhet të largohet nga kjo vepër e shëmtuar. Shmangia nga kjo sjellje veçanërisht e atyre (liderve) është një nga domosdoshmëritë. Pasi, ata që i ndjekin në gjendje dhe sjellje, imitojnë ata dhe kështu bien brenda në vorbullën e fitne-s. (Letra e 19-të)

Si përfundim, nuk duhet harruar që shejtani qarkullon në ifrat dhe tefrit (dy skajet e ekstremizmit). Fillimisht përpiqet që ta pengojë salikun të bëjë vepra të mira, pastaj, nëse nuk ia arrin, atëherë ia prish veprën përmes teprimit që ia ngulit në veprime. Për shembull, shejtani ndërkohë që përpiqet t'i largojë disa gafilë nga evlijatë e Zotit, murshidët, disa të tjerë bën që ta teprojnë apo të devijojnë me vepra kundrejt tyre. Lutja jonë është që Zoti të na mbrojë nga çdo lloj ekstremizmi dhe mungese të ekuilibrit dhe të bëjë që ta jetojmë fenë tonë në mënyrë të mesme. Amin!



Besimtari i vërtetë

Prof. dr. Ismail Lutfi Çakan

Vallë, në ç'përfundim mund të arrijmë, nëse do të testimonim veten tonë, myslimanizmin personal, sikur t'i vendosnim nga një shenjë pozitive apo negative kësaj liste, e cila përbëhet nga dyzet pyetje, që kanë për qëllim të përkufizojnë **besimtarin e vërtetë**. Kam përshtypjen se një gjendje e tillë, secilit prej nesh i ngjall kureshtje. Megjithëse mund të tregohemi subjektivë, duke shënuar në favor tonin dhe jo sipas së vërtetës, sidoqoftë kjo listë është përgatitur për lexuesit që dëshirojnë ta bëjnë provë një gjë të tillë.

1. "Besimtar i vërtetë" është ai njeri që Allahu e ka urdhëruar, Pejgamberi është përpjekur ta edukojë dhe që shoqëria myslimane dëshiron ta ketë.
2. Besimtar i vërtetë është ai që mund të jetë i sinqertë në vatrën e shpirtit të vet.
3. Besimtar i vërtetë është myslimani që mund të bëjë të gjitha veprat me qëllim të mirë dhe vetëm për hir të Allahut.
4. Besimtar i vërtetë është ai njeri që e ka bërë jetën kauzë më vete dhe përpiqet që me këtë vetëdije dhe me tërë çiltërsinë e tij të realizojë me sukses gjithë përpjekjet në jetë.
5. Besimtar i vërtetë është myslimani që i është dorëzuar tërësisht urtësive të Pejgamberit, me mendimet, ndjenjat dhe sjelljet e tij.
6. **Besimtar i vërtetë është ai që respekton Kuranin dhe Sunetin** sepse është i vetëdijshëm që fatkeqësia është e paevitueshme kur njeriu vepron vetëm sipas opinionit vetjak apo hamendjes së tij.
7. Besimtar i vërtetë është myslimani që është i lidhur me Sunetin, që jeton sipas Sunetit.
8. Kriteri i shëndetit të të qenit besimtar i vërtetë është Suneti.
9. Të përqafosh besëtytnitë dhe besime të gabuara duke menduar se janë pjesë e fesë, kjo do të ishte, siç do të thoshte populli ynë, **të trokasësh në derën e gabuar**. Ndaj dhe besimtar i vërtetë është ai njeri që jeton larg çdo lloj besëtytnie dhe bidati.
10. Përgjigja më e mirë që mund t'u jepet armiqve të Islamit dhe qasjeve antiislame është përpjekja që kemi për t'u bërë besimtarë sa më të vërtetë. Besimtar i vërtetë është pikërisht ai njeri që përpiqet të bëjë këtë xhihad të vërtetë.

11. Për besimtarin e vërtetë nuk ka rrugë tjetër për të përparuar dhe përmirësuar nga aspekti material e shpirtëror përveç **veprës së mirë dhe adhurimit**.
12. **Besimtar i vërtetë është ai njeri që ka pranuar Allahun si zot, Islamin si fe, Muhamedin (a.s.), si pejgamber dhe që përpiqet t'i qëndrojë besnik kësaj vendosmërie.**
13. **Besimtar i vërtetë** është ai njeri që përshtatet me thirrjen e istikametit që përmendet në ajetin: **"... andaj ecni në rrugën e drejtë që të çon tek Ai dhe kërkoni falje prej Tij!..."**¹
14. Besimtar i vërtetë është ai njeri që ka moral të lartë. E mira që vjen nga një njeri që është i paedukatë, edhe sikur të jetë mysliman, është një gënjeshtër e madhe.
15. Lumturia e kësaj bote dhe e tjetrës nuk arrihet nëpërmjet kënaqësive epshore të kësaj bote, por nëpërmjet vlerësimit që i bëhet ditës sipas Islamit. **Besimtar i vërtetë** është pikërisht ai që arrin ta realizojë këtë.
16. Besimtar i vërtetë është ai që ka një zemër me ndjeshmëri të atillë, sa të përqafojë të gjithë myslimanët.
17. Besimtar i vërtetë është ai që arrin të jetë njeri solidar dhe i dobishëm për tjetrin.
18. Besimtar i vërtetë është ai që e ka bërë parim të mos shqetësojë as me sjellje e as me shprehje myslimanët e tjerë. Është ai njeri që e vazhdon këtë parim gjatë tërë jetës së tij.
19. Besimtar i vërtetë është ai njeri që veçanërisht ruan gjuhën dhe nderin e tij.
20. Besimtar i vërtetë është ai njeri që njeh si vëllezër e motra të gjithë myslimanët e myslimanet.
21. Besimtar i vërtetë është myslimani që i jep përparësi vëllait të tij në fe.
22. Besimtar i vërtetë është ai njeri që është në kërkim të veprës së mirë që i shërben për botën tjetër, jo ai që u kushton vëmendje njerëzve të gjakut të vet, të farefisit.
23. Besimtar i vërtetë është ai njeri që përpiqet ta sjellë të vërtetën ashtu siç është, që e mbron atë, që përpiqet ta përhapë dhe që nuk i shmanget sipërmarrjes së saj edhe sikur të ketë ndonjë kosto kjo përpjekje.
24. Besimtar i vërtetë është ai njeri që njeh si xhihad mbrojtjen e së vërtetës.
25. *"Besimtari i vërtetë nuk bie dy herë radhazi në të njëjtën grackë."*
26. **Besimtar i vërtetë** është ai njeri që arrin të qën-

1. Fussilet, 6

- drojë larg çështjeve që "nuk e ngrohin atë".
27. **Besimtar i vërtetë** është ai njeri që ka miq njerëz të mirë dhe është mik i njerëzve të mirë.
28. **Besimtar i vërtetë** është myslimani që nuk ngurron t'u japë njerëzve selamin e Zotit.
29. Besimtar i vërtetë është ai njeri që nuk harxhon kohë me fjalë, vepra dhe mendime të kota.
30. Besimtar i vërtetë është ai që, ashtu sikurse besimin, ka dinjitoze, potente dhe të vazhdueshme edhe frikën e shpresën.
31. Besimtar i vërtetë është ai njeri që e dimjaft mirë **se kohët e krizës janë momentet më të përshtatshme për të përhapur ideale të mëdha**, ndaj dhe nuk bie në pesimizëm.
32. Besimtar i vërtetë është ai që është gjithnjë pas realizimit të pritshmërive të veta, është ai njeri që është gjithnjë në një proces të realizimit të vetes.
33. Besimtar i vërtetë është ai që nuk mjaftohet me fjalë, por e provon mirësinë me vepra. **"Njeriut i shihet puna, jo fjala."**
34. **Besimtar i vërtetë** është ai njeri që sillet –aq sa mundet– me sy e zemër të ngopur ndaj mundësive të kësaj bote dhe me respekt e nderim në syrin e Zotit dhe të popullit.
35. Besimtar i vërtetë është ai që shfaq përpjekje për të rregulluar menjëherë gabimet e veta.
36. Besimtar i vërtetë është ai që pastrohet nga gjynahet, që di të bëjë që t'i falen gabimet e vogla apo të mëdha, nuk është besimtar i vërtetë ai që pretendon se nuk gabon dhe që i sheh si të vogla gabimet e veta.
37. **"Me të vërtetë, punëdrejtët do të gjenden në Xhenet, duke shikuar nga divanet. Në fytyrat e tyre do të njohësh shkëlqimin e Lumturisë. Atyre do t'u jepet të pinë musht të pastër të ruajtur mirë, fundi i të cilit është myshku. Për këtë, le të përpiqen ata që përpiqen."**² Kështu që, për të dalë fitimtarë në një garë të tillë dhe për të arritur në një përfundim të tillë nuk kemi rrugë tjetër përveçse të bëhemi besimtarë të vërtetë.
38. Besimtar i vërtetë është ai njeri që përpiqet ta nxjerrë mirësinë nga plani individual në planin institucional, madje në planin shoqëror.
39. Besimtar i vërtetë është ai njeri që e di se nuk mund të kufizohet me shifra lidhur me çështjen e përgjegjësisë.
40. **Besimtar i vërtetë është ai që është mysliman sipas Islamit.**

2. Mutaffifin, 22 - 26



Islami

për të drejtat e kafshëve

Nexhat Ibrahimli

HYRJE

Nga fundi i shekullit XX dhe fillimi i shek. XXI organizata qeveritare e joqeveritare kanë ngritur problemin e të drejtave njerëzore, të robërve të luftës, të fëmijëve, të pakicave nacionale, të femrës, por edhe të krijesave të tjera, si të kafshëve dhe bimëve, të natyrës së pastër, ujit, ajrit, etj. Në gazeta e revista do të lexojmë tituj nga më të ndryshmit lidhur me të drejtat e njerëzve, të kafshëve, bimëve, etj. Në këtë aspekt, jo rrallë gjejmë edhe tituj se Islami nuk i përfill këto të drejta, madje qëllimisht i shkel këto të drejta. Viteve të fundit nuk kalon ditë e Islami të mos akuzohet për shkelje të drejtash të caktuara. Në këtë mënyrë, ata jo vetëm që godasin aspektin juridik në Islam, por edhe vetë burimet e fesë islame, Kuranin dhe Hadithin.

Mirëpo, një vështrim i vëmendshëm i literaturës islame, asaj burimore, veprave klasike, por edhe bashkëkohore, do të konstatojë se Islami në hollësi i ka saktësuar të drejtat e njeriut, në të gjitha nuancat e tij, madje edhe të drejtat e kafshëve, bimëve etj.¹ Me këtë rast, në pamundësi hapësinore për ndonjë zgjerim, kryesisht do të trajtojmë çështjen e të drejtave të kafshëve, kategori

1. Një prezantim i shkëlqyeshëm i shkrimeve klasike për trajtimin p-zitit të shtazëve/kafshëve në Islam shih në: Annemarie Schimmel, Islam i çudesnosti stvorenja: životinjsko carstvo, në revistën: Novi Muallim, ljeta 2014, viti xv, Sarajevë, nr. 58, fq. 45-58.

kjo, e lënë pas dore ose e trajtuar vetëm për marketing politik dhe tërheqje fondesh nga burime qeveritare apo donatorë qëllimshëm.²

TË DREJTAT E KAFSHËVE SI E DREJTË HYNORE

Islami përfshin në mbrojtjen e tij çdo gjë, kurse Muhamedi (a.s.), duke specifikuar, ka theksuar dashurinë e tij si për njeriun ashtu edhe për kafshët, bimët por edhe ambientin ku jetojmë e më gjerë. Ambienti ku jetojmë është dhuratë dhe amanet i Krijuesit, prandaj atë duhet ta ruajmë dhe mbrojmë. Natyra ka çdo gjë për një jetë të këndshme e të rehatshme, së këndejmi njeriu duhet të bëjë kujdes për sjelljet e tij. Kjo është porositur shumë herët nga Kurani:

“Mos bëni çrregullime në tokë pas rregullimit të saj (me të ardhur të peygamberëve) dhe luteni Atë duke pasur frikë (dënimin) dhe duke shpresuar (mëshirën). S’ka dyshim se mëshira e Allahut është pranë atyre të mirëve.” (Araf, 56)

Kurani i jep urdhrat në parim, kurse Muhamedi (a.s.), ka dhënë shembuj të shumtë lidhur me kujdesin e njeriut kundrejt rrethit të vet. Madje këtë kujdes të tij e vëren edhe një ekologjiste evropiane, duke thënë:

“Muhamedi ishte përfaqësues i fuqishëm i përdorimit

2. Hutbja e Lamtumirës e Muhamedit (a.s.), Prizren, 2002.

racional të tokës dhe ujit dhe raportit human të njeriut ndaj bimëve dhe kafshëve. Në këtë kontekst vërejmë qasje revolucionare mbi ruajtjen e mjedisit jetësor. Qasja e Muhamedit është revolucionare dhe e përkryer në aspekt të zgjimit të vetëdijes ekologjike...³

Pra, Kurani dhe Suneti i Pejgamberit (a.s.), flasin për tokën, ujin, por edhe për botën shtazore, bimore dhe kohën. Madje, disa sure mbajnë edhe emrat e disa kafshëve: Bekare (Lopa), En-Neml (Milingonat), Fil (Elefanti), En-Nahl (Bleta) dhe Ankebut (Merimanga) dhe përdoren në kontekste të ndryshme.

Theksimi i tyre përmban urtësi të shumta, madje edhe urtësi të natyrës shariatike, meqë për disa shtazë/kafshë lidhen edhe disa dispozita shariatike, fikho-re, sikurse është konsumimi i mishit të disa kafshëve, përdorimi i tyre për gjueti etj.

Nisur nga ky aspekt, në të drejtën islame të drejtat e kafshëve klasifikohen në grupin e të drejtave hyjnore, kurse kjo bazohet në ajetet kuranore dhe hadithet e shumta. Juristët myslimanë mendojnë se kafshët kanë të drejtë në jetë, ushqim, vendbanim, riprodhim, kurse njerëzit duhet ta respektojnë këtë të drejtë të tyre. Xhahidhi (vd. 869) njihet si shkencëtari më i madh klasik lidhur me studimin e kafshëve, duke shkruar veprën *Kitab'ul-hajevan* (Libri për kafshët). Pastaj për këtë temë nga aspektet e ndryshme ka shkruar edhe Ibn Miskevejhi, Ihvan'us-safa, F. Attari, M. Ikbali etj.⁴

Kurani u jep rëndësi të theksuar kafshëve. Ja disa ajete lidhur me këtë temë:

“Allahu nuk ngurron që të marrë çfarëdo shembulli, qoftë mushkonjë a diçka edhe më të imët se ajo. Sa u përket atyre që besuan, ata e dinë se është e vërtetë nga Zoti i tyre, ndërsa ata të cilët mohuan do të thonë: ‘Ç’deshi Allahu me këtë shembull?’ Ai me të lajthit shumë, dhe udhëzon me të shumë (në rrugën e drejtë), por nuk lajthit me të (tjetër kënd), pos mëkatarët e mëdhenj.” (Bekare, 26)

“Ai i krijon edhe kafshët. Ju me ato mbroheni nga të ftohtit, e keni edhe dobi të tjera, sepse prej tyre edhe ushqeheni.” (Nahl, 5)

“Vërtet, edhe te bagëtitë për ju ka shenja (për të meditar): ju pini atë që gjendet në barkun e tyre, hani mishin e tyre, nxirrni shumë dobi të tjera dhe udhëtoni me ato, ashtu siç udhëtoni me anije.” (Mu'minun, 21-22)

3. <http://www.akos.ba/u-fokusu/koliko-je-poslanik-a-s-doprinjeo-ekologiji>.

4. Në letërsinë arabe-persiane kemi një vepër të shkëlqyeshme lidhur me tregimet për kafshët, me titullin “Kelila dhe dimna”, të cilën në gjuhën arabe e përktheu Abdullah ibn Mukaffa. Kjo vepër e shek. VIII, depërtoi edhe në Evropë gjatë mesjetës. Sipas: Annemarie Schimmel, po aty. 45.

Madje, disa dijetarë juristë mendojnë se në rast mungese të ujit njeriu në vend të gusulit për vete do të marrë tejemum, kurse ujin për abdest do t’ia japë kafshës së caktuar që e ka të obliguar të kujdeset, njëjtë sikur do të vepronte në rastin e njeriut të etshëm.

Juristët myslimanë madje shkojnë aq larg, saqë konstatojnë se, nëse një person e lëndon një kafshë e cila e ka sulmuar, kurse ky në vetëmbrojtje e lëndon, nuk është i obliguar ndaj pronarit. E tërë kjo, nëse gjatë vetëmbrojtjes nuk është tejkulluar forca. Por, nëse e ka lënduar për diçka tjetër, atëherë lëndimin e kafshës do t’ia plotësojë pronarit të shtazës.

E DREJTA E KAFSHËS NË USHQIM E PIJE

Të drejtat e kafshëve janë detyruese. Njeriu pronar apo kujdestar ka për obligim fetar t’i furnizojë kafshët me ujë dhe ushqim përkatës. Këtu bëjnë pjesë edhe kafshët të cilave nuk u hahet mishi. Nëse kafsha nuk është e lirë të sigurojë vetë ushqimin, pronari e ka për obligim ta bëjë këtë. Me fjalë të tjera, pronari gjendet para tri alternativave: Nëse mishi i kafshës mund të hahet, pronari duhet të zgjedhë: ose ta ushqejë kafshën, ose ta therë ose ta shesë. Nëse kafsha nuk hahet, atëherë pronari ose do ta ushqejë, ose do ta shesë. Shteti nëpërmjet mekanizmave të vet do ta detyrojë pronarin në një prej alternativave të lejueshme. Por, në rast se kafsha, për shembull lopa, është e lirë të kullojë, por për shkak të thatësisë nuk ka ushqim të mjaftueshëm, pronari nuk ka të drejtë ta mjelë lopën, sepse ajo ose viçi i saj do të dobësoheshin. Disa juristë islamë shkojnë aq larg, sa në rast mungese të ushqimit dhe pamundësisë së blerjes, sepse pronari i ushqimit refuzon ta shesë barin, i lejohej pronarit të kafshës t’ia marrë me forcë ushqimin, duke ia kompensuar vlerën e ushqimit.

Edhe huazuesi i kafshës e ka për obligim të sillet mirë me kafshën sikurse pronari, pa marrë parasysh nëse





mishi i kafshës hahet apo nuk hahet. Huazuesi këtë do ta bëjë sipas traditës dhe nevojës së kafshës.

E drejta e kafshës është edhe në frytin, të voglin e saj. Nëse ushqimi (gjiri) i dhënë nuk i mjafton, pronari duhet ta ndihmojë edhe biçin me ushqim. Fjala është për të gjitha kafshët katërkëmbëshe që nuk janë të rrezikshme për jetën e njeriut. Madje edhe bletës dhe krimbit të mëndafshit duhet t'i ndihmojmë.

Muhamedi (a.s.), ka thënë:

Ebu Hurejre, radijallahu anhu, thotë se Pejgamberi, (a.s.), ka thënë:

“Duke ecur rrugës një njeri ishte i etur shumë dhe kur e gjeti një pus, zbriti në të, piu ujë dhe doli prej atje. Kur në këtë kohë qeni e zgjaste gjuhën dhe hante dheun e lagët. Ky njeri tha se qenin e ka kapur etja sikur që më kapi edhe mua dhe hyri në pus, e mbushi këpucën e tij dhe i dha ujë qenit. Allahu i Madhërishëm e falënderoi dhe ia fali mëkatet.” Sahabët thanë: “O Pejgamberi i Zotit, vallë edhe në mirësinë ndaj kafshëve kemi shpërblim?” ndërsa ai u përgjigj: “Në mirësinë ndaj të gjitha kafshëve të gjalla njeriu ka shpërblim.”⁵

E DREJTA E KAFSHËS NË PASTËRTI, VENDBANIM

Edhe pastërtia është ndër të drejtat e kafshës nga pronari. Në këtë të drejtë kuptohet vendi ku qëndron kafsha, enët e ushqimit dhe pijes, ajrosja e stallës etj. Nëse kafsha nuk mund ta pastrojë veten në mënyrë të natyrshme, është detyrë e njeriut ta bëjë këtë. Këtu hynë në plan edhe shëndeti i kafshës.⁶ Nëse kafsha helmohet ose thyen këmbën, ose ndonjë e papritur tjetër, është detyrim fetar që të kujdesemi maksimalisht duke e dërguar te veterineri ose së paku te mjekët alternativë.

5. Sahihu i Buhariut, 2/870, nr. 2466.

6. Në kohën e Perandorisë Osmane ka pasur vakuf të themeluar në mbrojtje të kafshëve, madje kanë ekzistuar edhe spitale për kafshë. Shih: Dževad Hodžić, Živa bica u islamskoj religijskoj bioetickoj perspektivi, fq. 361-367, sipas: [file:///C:/Users/Nexhatlb/Downloads/01_hodzic035_hodzicBook_SE_4_2%20\(2\).pdf](file:///C:/Users/Nexhatlb/Downloads/01_hodzic035_hodzicBook_SE_4_2%20(2).pdf) (qasje më 01.12.2014).

Kafshët kanë nevojë për pushim dhe fjetje, prandaj, pronari duhet ta sigurojë vendin adekuat për këtë. Nëse vendi nuk është i përshtatshëm, ky veprim i pronarit konsiderohet mundim i kafshës. Juristët vendin për pushim të kafshës e fusin në kategori me ushqimin. Për më tepër, kur nuk dimë se jashtë shtëpisë kafsha është e sigurt apo jo nga kafshët e tjera apo nga njerëzit dëmtues.

E DREJTA E KAFSHËS NË DREJTËSI, RIPRODHIM DHE TRAJTIM

Ndaj kafshës duhet të sillemi drejt, sikur që këtë duhet ta bëjmë edhe ndaj njerëzve, bimëve etj. Mundimi i kafshëve është veprim i përbuzur dhe i urryer. Kafshët bartëse nuk mund të ngarkohen më shumë seç është normale dhe në rrugë më të gjata se normale, pa pushim e ushqim. Kafshët kanë të drejtë të mos mundohen dhe të mos abuzohen nga pronarët e tyre. Fjala vjen, nuk mund të theret një kafshë duke e shikuar kafsha tjetër. Urdhri i Muhamedit (a.s.), ishte që mos të pritët kafsha me thikë joadekuate dhe me mënyra të mundimshme, por:

“Vërtet Allahu ka përcaktuar mirësi në çdo gjë. Kur vrisni, këtë bëjeni në mënyrën më të mirë, kur therni, bëjeni këtë në mënyrën më të mëshirshme. Ai që nga ju do të presë (një kafshë), le ta mprehë thikën që t'ia lehtësojë kafshës së vet.”

Madje, kafshët meritojnë kujdes edhe në gjëra shumë më të vogla. Nuk duhet të milet kafsha deri në pikën e fundit, as personi që e mjet të ketë thonj të mëdhenj.

Buhariu dhe Muslimi transmetojnë një hadith nga Ibn Omeri, (r.a.), se Muhamedi (a.s.), ka thënë:

“Gruaja është dënuar për shkak të maces. E ka mbajtur të mbyllur derisa ka ngordhur dhe për këtë shkak ka hyrë në xhehenem. Nuk e ka ushqyer as dhënë ujë pasi e ka mbyllur, as e ka lënë të lirë të ushqehet me zvarranikë dhe insekte nëpër tokë.”

Rasti tjetër shpjegon një gjendje shumë të prekshme.



Abdullah ibn Xhaferi tregon:

“Pejgamberi hyri në kopshtin e një medinasi. Në kopsht gjendej deveja dhe sa e pa Pejgamberin klithi dhe lotoi. Ai iu afrua, e përkëdheli nëpër veshë, kurse ajo heshti... Atëherë pyeti: ‘E kujt është kjo deve?’ Një djalosh medinas, tha: E imja o Pejgamber i Zotit.’ Kurse Pejgamberi (a.s.), tha: ‘A nuk i frikësohesh Zotit për këtë kafshë të cilën ta ka dhënë në dispozicion? Ajo m’u ankua se po e mban të uritur dhe se skajshëm po e përndjek.’”⁷

Kafshët kanë të drejtë në riprodhim/shumëzim. Pronarët nuk kanë të drejtë në paaftësimin e tyre seksual, domethënë në kastrimin e tyre. Po ashtu, është i ndaluar armiqësimi i kafshëve mes veti, zënka qensh, duke u krijuar njerëzve çaste dëfrimi. Kafshët meritojnë kujdes më të madh sesa ajo që ndodh deri tash.

E DREJTA E KAFSHËVE NË RESPEKT DHE MBIJETESË

Edhe pse kemi të drejtë t’i shfrytëzojmë qumështin e kafshëve, mishin e tyre ose prodhimet e tyre, megjithatë duhet t’i respektojmë si kafshë, sikurse mosgoditja në kokë, mosgoditja në përgjithësi etj. Nuk kemi të drejtë as në sakatimin e kafshëve ose rrahjen e tyre pa ndonjë arsye të madhe.

Kjo mund të shtrohet edhe në një rrafsh tjetër: Nëse pronari nuk kujdeset për kafshën e vet, dhe e lë në vend ku kafsha nuk mund të ekzistojë vetë, këtë mund ta bëjë dikush tjetër dhe pronësia i takon atij që kujdeset, siç ndodh me tokën e papunuar, ai që e punon atij i përket.

Pronari nuk ka të drejtë ta keqpërdorë kafshën. Fjala vjen, kafshët për bartje dhe ngarkim nuk bën të përdoren për një kohë të gjatë pa pasur nevojë. Pra, duhet të zbrisim dhe bisedën ta bëjmë nga toka e jo nga shpina e kafshës së caktuar.

Kafsha ka të drejtë të mos bëhen objekt gjuetie jash-

7. H. M. Halid, Insanijatu Muhammed s.a.v.s.

të nevojave njerëzore, fjala vjen, për rekreacion, sport, apo për nevoja luksi, sikur lëkura dhe gëzofi i tyre. Muhamedi (a.s.), qartë e ka ndaluar gjuetinë që si motiv ka sportin, rekreacionin apo argëtimin.⁸

Madje, Muhamedi (a.s.), përmes porosisë: *“Mos vini në shënjestër asgjë që ka shpirt!”*; ka ndaluar që kafshët të bëhen objekt i stërvitjeve të gjuajtjes, ka ndaluar prerjen e organeve të tyre për qëllime të kota, shkurt, ka ndaluar torturimin e botës animale.⁹

NË VEND TË PËRMBYLLJES

Të gjitha pikëpamjet që kemi theksuar në këtë shkrim dhe shumë të tjera të patheksuara¹⁰ qartë tregojnë se Allahu edhe kafshëve të egra apo të buta u ka dhënë të drejta, të cilat njeriu nuk ka të drejtë t’i rrezikojë apo shkelë. Kjo e drejtë shtrihet edhe në botën bimore dhe çdo gjë të krijuar. Myslimanët e hershëm kësaj teme i kanë kushtuar rëndësi të madhe, madje kanë kultivuar kafshë të caktuara për nevoja konkrete, sikur për punë, transport, rekreacion etj. Janë të njohur kuajt e racës me emrin *arap*, pëllumbat postierë, qentë besnikë, devetë, macet etj. Ky kujdes ka qenë në nivel të kënaqshëm, madje edhe në kohën kur feja nuk njihet dhe nuk respektohet sa duhet, sepse ishte mbyllur vetëm si traditë familjare e private. E keqja është se kohëve të fundit, kur vlerat fetare janë nëpërkëmbur ka rënë edhe kujdesi ndaj shtazëve e kafshëve, apo kujdesi për kafshët ka kaluar në një rrafsh tjetër, atë të modës, trendit të caktuar, maniakizmit (hobit) të individëve e jo më si detyrim njerëzor ndaj krijesave të ndryshme. Është për të shpresuar se vlerat do të kthehen në vendin e vet, kurse trojet tona shqiptare myslimane kanë përvojë të mjaftueshme për të qenë shembull për rajonin e më gjerë.

8. Sipas: Sahihu'l-Myslim, (arabisht –anglisht, Saudi Arabia, juni 2007, 4, 2593.

9. Mehmet Gormez etj., Islami në hadithe, Pjesa III.

10. Për disa nga çështjet e sipërme shih: Jusuf Karadavi, Hallali dhe harami në Islam, Logos-A, fq. 77 e tutje.



IHLAS DHE IFLAS

All Riza Temel

Fjala ihlas është në kuptimin: dëlirje, pastrim dhe shpëtim; që përkufizohet si të bësh ibadete dhe mirësi, duke iu larguar sipërfaqësisë dhe interesave të caktuara dhe duke bërë gjithçka vetëm për hir të Allahut.

Shpirti i ibadetit është ihlas. Njeriu nuk ka dobi, as nga vepra pa ihlas e as nga ihlasi pa vepër. Zoti i Madhëruar e përkufizon fenë e vërtetë kështu: **“...ata qenë urdhëruar vetëm që të adhuronin Allahun me përkushtim të sinqertë, duke qenë në fenë e pastër (të Ibrahimit), si dhe të falnin namazin e të jepnin zeqatin. Kjo është feja e drejtë.”** (Bejjine, 5)

Ndërkohë që bën ibadetet, të kesh tjetër qëllim përveç pëlqimit të Zotit, të bësh shirk apo të veprosh për sy e faqe, janë vepra që bien ndesh me ihlasin. Gjithçka që është e pastër dhe e sinqertë, është e pranuar.

Njerëzit janë në tre pozicione të lidhur me çështjen e ibadetit. Ose bëjnë ibadete krejtësisht për sy e faqe, ose bëjnë ibadete duke përzier ihlasin me syfaqësinë, ose bëjnë ibadete vetëm me ihlas. Të parët, përveçse nuk kanë asnjë sevap, kanë gjynahe shumë të mëdha. Të dytët, pra ata që përziejnë veprën e sinqertë me të pasinqertën, shpresohet që të falen, nëse do të pendohen. Të tretët, pra atyre që veprojnë vetëm me ihlas, shpërblimin ua jep vetë Zoti i Madhëruar.

Feja është sinqeritet. Cilësia kryesore e besimtarit është sinqeriteti. Syfaqësia është cilësi e hipokritit. Ata, ndërkohë që nuk besojnë, shfaqen sikur besojnë, që të arrijnë ndonjë interes të tyre ose për t’iu larguar ndonjë të keqeje të mundshme. Me shprehjen e Kuranit Famëlartë: **“...Kur ata ngrihen për namaz, ngrihen me përtesë, vetëm sa për t’u dukur para botës dhe Allahun e përmendin fare pak.”** (Nisa, 142)

Synimi i besimtarëve, kibleja e tyre, është gjithnjë vetëm pëlqimi i Zotit. Ata thonë: **“Vetëm Ty të adhurjmë dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë.”** (Fatiha,

5) Sjellja e besimtarit është sjellja e Ibrahimit, i cili kaloi jetën me një betejë monoteiste (tevhid) dhe mori përsipër që për hir të kësaj kauze të hidhej edhe në zjarr. Ai u shpreh kështu: **“Unë e kthej fytyrën time nga Ai që i ka krijuar qiejt dhe Tokën, duke qenë besimtar i vërtetë, dhe nuk jam nga idhujtarët!”** (En’am, 79)

Le t’u kushtojmë vëmendjen e duhur këtyre këshillave të Pejgamberit (a.s.), që shprehin në mënyrën më të thjeshtë të mundshme ihlasin dhe dorëzimin (teslimi-jet): **“Kur të shtrihesh në shtrat, lutu në këtë mënyrë: ‘Allahu im! Ta dorëzova Ty tërë qenien time. E mbështeta shpinën tek Ti. Po e lë tek Ti veprën time me shpresë e frikë. Nuk ka tjetër strehë, tjetër mbrojtje përveç Teje. I besova Librit që ke zbritur. E pranova pejgamberin që ke dërguar. Nëse do të vdesësh në një natë pasi ke thënë këto, do të vdesësh mbi natyrshmërinë tënde (fitra). Nëse do të zgjohesh, do zgjohesh në një ditë të mbarë.”** (Ibn Maxhe, Kitabud-dua, 15.) Këto shprehje janë shprehje të dorëzimit dhe ihlasit të plotë. Janë përtej frikës së shirkut dhe dyfytërsisë.

Dyfytërsia është një shirk i fshehur. Shirku është e kundërta e teuhidit. Zoti fal gjnahet, përveç shirkut. Kurrë nuk pranon ibadetet që janë të përziera me shirk dhe dyfytërsi. **“...Kush shpreson takimin me Zotin e vet, le të bëjë vepra të mira dhe të mos i shoqërojë askënd në adhurim Zotit të vet!”** (Kehf, 110)

Begatia është në ihlas, kurse iflasi (falimentimi) është dyfytërsia. Begatia që gjendet në ihlas shpjegohet në këtë mënyrë: **“Ata që shpenzojnë pasurinë e vet në rrugë të Allahut, i shembëllojnë atij që mbjell një kokërr nga e cila dalin shtatë kallinj, ku secili kallë ka nga njëqind kokrra. Allahu ia shton (shpërblimin) edhe më tepër kujt të dëshirojë; Allahu është Mirëbërës i madh dhe i Gjithëdijshëm.”** (Bakara, 261) Hipokrizia e njerëzve të syfaqësisë përbëhet nga shkatërrimi dhe falimentimi total i tyre.

“O besimtarë! Mos i çoni dëm lëmoshat tuaja duke ua kujtuar ato (atyre që ua keni dhënë) dhe duke fyer, siç vepron ai që e shpenzon pasurinë e vet për sy e faqe të botës dhe nuk beson në Allahun dhe Ditën e Fundit. Ai shembëllen me një gur të lëmuar të mbuluar me dhé, mbi të cilin bie shiu me rrebesh, duke e lënë të zhveshur. Ata nuk kanë kurrfarë dobie nga veprat që kanë bërë, se Allahu nuk e udhëzon në rrugë të drejtë popullin mohues.” (Bakara, 264)
Ashtu sikurse shiu pastron dheun që gjendet mbi një shkëmb, edhe dyfytërsia heq begatinë e veprës në mënyrë të njëjtë.

Besimtari i vërtetë nuk pret ndonjë shpërblim apo falënderim nga njerëzit për ibadetet apo lëmoshat e tij. ***“Por vetëm për të kërkuar Fytyrën (kënaqësinë) e Zotit të tij, më të Lartit.”*** (Lejl, 20)

Shejtani nuk përzihet me robërit e sinqertë. Iblisi ka thënë kështu: ***“... dhe të gjithë do t'i shpie në mashtrim, përveç robërve të Tu të sinqertë.”*** (Hixhr, 39-40)

Përfaqësuesit më idealë të ihlasit janë pejgamberët. Në jetën e tyre nuk kanë asnjë grimcë dyfytërsie. Përndryshe nuk mund të ishin të besueshëm. Pasi ai që nuk beson, nuk arrin të bëjë të tjerët ta besojnë atë.

Isai është përpjekur që njerëzit t'i këshillojë që të ruhen nga dyfytërsia. Përmbledhtazi ai ka thënë këto: ***“Ruhuni që të mos bëni syfaqësi para njerëzve. Kur të jepni lëmoshë, të mos e dijë dora e majtë atë çfarë jep dora e djathtë. Edhe kur të luteni, mos u bëni sikurse hipokritët. Kur të luteni mos bëni sikurse politeistët që u drejtohen idhujve të tyre me përsëritje të kota. Edhe kur agjëroni, mos të dukeni si hipokritët. Mos u dukni si agjërueshëm karshi njerëzve, por karshi Zotit.”*** (Ungjilli, Mateu, 16.) Shprehjen “Atë” që kalon në Inxhil, e përkthjem si “Zot”.

Një false e një gjëje është armikja më e madhe e origjinales, sepse, kanë të njëjtën pamje. Ari i vërtetë ka armik arin fals, pasi nuk është e lehtë të dallosh të vërtetën nga falsja. Prandaj dhe për besimtarët nuk janë rreziku më i madh femohuesit, por hipokritët. Mohuesi është i qartë, mund të mbahet qëndrim i qartë përballë tij. Kurse hipokriti, ngaqë duket si besimtar, është si një mikrob që qarkullon nëpër trup, i padallueshëm dhe nuk mund të mbahet qëndrim ndaj rrezikut që vjen prej tij. Paraja false është rreziku më i madh për paranë e vërtetë. Shprehjet dhe sjelljet e pasinqerta janë mashtruese dhe të rrezikshme.

Vlera e njeriut është në varësi të sinqeritetit që ka. Kauzat e mëdha janë bartur në supet e njerëzve të sinqertë dhe nëpërmjet njerëzve mashtrues janë degjeneruar.

Gjatë gjithë historisë ka ekzistuar dhe do të ekzistojë gjithmonë beteja e falses me origjinalen. Nuk janë fjalët ato që faktojnë të sinqertin dhe hipokritin, por janë veprat. Veçanërisht në raste kur nevojitet një kosto

e lartë apo sakrificë e madhe dallohet i sinqerti nga hipokriti.

Historia e njerëzimit është e mbushur me shembuj të njerëzve të sinqertë dhe atyre hipokritë. Le të përmendim një shembull tejet domethënës nga historia islame:

Njëri nga beduinët erdhi tek Pejgamberi (a.s.). I besoi Pejgamberit, nisi ta ndjekë atë dhe i tha se do të bënte hixhret bashkë me të. Resulullahu i rekomandoi disa nga sahabët për një udhëtim të tillë. Ndërkohë, nisi një luftë. Pejgamberi mblodhi ganimete (pasuri lufte) nga kjo luftë. Ashtu sikurse ndau për të gjithë, ndau edhe për të. Pjesën e personit në fjalë, Pejgamberi (a.s.) ia dorëzoi sahabëve që ata t'ia jepnin atij, pasi personi në fjalë po kulloste bagëtitë e tyre. Kur i shkuan pranë, i dhanë pjesën e ganimitit. Kur pyeti “Ç’është kjo?”, ata iu përgjigjën: “Është pjesa që ka ndarë për ty Pejgamberi!” E mori pjesën e vet dhe shkoi pranë Pejgamberit (a.s.) dhe e pyeti edhe atë se ç’ishte ajo. Resulullahu i tha: ***“Kjo është pjesa nga ganimeti.”*** Pas kësaj, beduini i tha: Unë nuk të kam besuar ty për këtë dhe duke bërë me shenjë tek tyti, i tha: ***“Unë të besova ty, duke menduar se mu këtu do më binte një shigjetë për të rënë shehid dhe për të hyrë në xhenet.”*** Atëherë, Resulullahu iu drejtua: ***“Nëse vërtet je i sinqertë para Allahut për këtë fjalë, atëherë Allahu do ta plotësojë këtë dëshirë.”*** Pas një kohe të shkurtër, u shfaq një tjetër luftë dhe personit në fjalë, ngaqë ishte gjuajtur me shigjetë aty ku ai kishte bërë me shenjë, kishte ndërruar jetë dhe, ashtu sikurse ishte u soll në prezencë të Resulallahut (a.s.). ***“A është ky ai personi?”*** – pyeti Pejgamberi (a.s.). ***“Po”*** – i thanë. ***“Kjo do të thotë se ai paska qenë i sinqertë në fjalën që thoshte. Ndaj dhe Allahu ia plotësoi dëshirën e tij.”*** – tha Pejgamberi (a.s.). U qefinos me xhyben e Pejgamberit, iu fal xhenazja dhe Resulullahu (a.s.), u lut në këtë mënyrë: ***“Allahu im! Ky njeri për hir Tëndin bëri hixhret dhe për hir Tëndin ra shehid. Unë jam dëshmitar i kësaj.”*** (Suneni Nesai, Xhenaiz, 61.)

Nga jeta e sahabëve fisnikë dhe të besimtarëve të tjerë gjenden plot shembuj të tillë mbi sinqeritetin. Sikur mos të kishte trima të tillë, që vepronin vetëm për hir të Allahut, pa pritur asgjë nga kjo botë, nuk do të jetonin dhe zhvilloheshin kauzat e vërteta, do të shkatërrroheshin nga dora e abuzuesve dhe interesaxhinjve.

Dyfytërsia, mbi të gjitha është mashtrimi që i bën njeriu vetes dhe në një farë kuptimi është një vetëvrasje konceptuale. Është shndërrimi i identitetit të vërtetë në identitet fals. Ndonëse njeriu fiton ndonjë gjë nëpërmjet falsitetit, humbet veten. Çfarë mund të fitojë një njeri që ka humbur veten? Me siguri ky është edhe falimentimi më i madh. Pasuria që është humbur mund të fitohet sërish, mirëpo të rifitosh personalitetin është mjaft e vështirë. Le të mos na ndajë Zoti nga sinqeriteti dhe le të na ruajë nga iflasi (falimentimi) shpirtëror. Amin...

RRNO

edhe për me kuptue

Edlson Çeraç

Duhet të kujtohem herë pas here se ndalesa më domethënëse për të kuptuar një aspekt apo fenomen të së tashmes është e shkuara, pasi e tashmja ka rrënjët e saj, dhe këto rrënjë përkasin diku në të shkuarën. Një veprim apo një *modus operandi* i caktuar, është rrjedhojë "e ligjshme" e një mënyrë të caktuar të menduari. Mirëpo, në rrafshin e të menduarit apo ideve nuk ka asgjë të re – ka vetëm interpretime dhe sidomos interpretime mbi interpretimet.

Por, si përherë, pjesa dërrmuese as që duan t'ia dinë, aq më tepër sot kur kulti i progresit, ose e shqipëruar: adhurimi i asaj që është për-para, që ka të bëjë vetëm me atë që pritet të vijë; domethënë, me të ardhmen e ndriçuar si qëllim më vete, shënon mjegullimin deri dhe fashitjen e rrënjëve tona te prologu në qiell mes Zotit dhe njeriut të parë. E thënë përmbledhtazi, ai i cili nuk e di se nga vjen, është afërmendsh se nuk di as se për ku është nisur. Prandaj, në qoftë se do mëtonim një lloj përkufizimi për këtë kohë, del të jetë koha e një hutimi të pashoq, apo siç e shpreh Heidegger-i, "harresa e Qenies".

Prandaj edhe një temë si ajo e marrëdhënieve mes tre komuniteteve më të njohura, mes hebrenjve, të krishterëve dhe myslimanëve, nuk kemi se si ta kuptojmë pa kthyer kokën pas në të kaluarën. Kjo nuk nënkupton kurrsesi leximin e të shkuarës vetëm në rrafshin e ngushtë historik e historiografik, pasi në këtë drejtim ka shumëçka që ka ndryshur për sa i takon rrethanave socio-kulturore në veçanti, por, ajo që ia vlen është një lexim i historisë si mësim, si një metaforë që hedh dritë edhe në të sotmen dhe në çdo kohë, siç ka ndodhur, fjala vjen, me ngjarjen e Trojës rrëfyer nga Homeri, i cili ka anashkaluar "faktet" për të na sjellë mësimin/mesazhin, që si i tillë i flet çdo kohe dhe çdo brezi. Pra, "faktet" e mbysin mesazhin – ja pse letërsia na thotë shumë më tepër sesa historia; sepse e para merret me anën cilësore të subjektit, kurse e dyta me atë sasiore; e para kërkon për atë që fshihet pas syprinës, ndërsa e dyta mjaftohet vetëm me atë

që duket dhe preket. "Mjerë për faktet", shkruan diku Hegeli. Pikërisht në këtë pikë duhet kërkuar një prej arsyeve kyçe se pse një personazh si Jezui (historik) është kaq i diskutueshëm për sa i takon mesazhit që sjell, dhe pse një si Hamleti (metahistorik?) është kaq sugjestionues dhe bindës; ndërkohë që i pari ka ekzistuar, kurse i dyti, sipas të gjitha gjasave, ekziston vetëm në tokën pa kufij të metaforës.

Duke u nisur nga sa më sipër, përmes disa citimeve do përpiqemi të japim disa shkëndija nga e kaluara në lidhje me marrëdhënien mes tre komuniteteve që përmendëm. Pavarësisht se ajo që citohet është e faktuar, në këtë rast nuk synohet fakti, se fatkeqësisht kemi plot të tillë, por ajo që pluskon si përvajshëm nën të.

...hebrenjtë që po persekutoheshin në zonën e Europës Qendrore, kërkuar strehim te osmanët myslimanë. Shumë hebrenj që i shpëtonin persekutimit në Europën Qendrore do të merrnin letra si ajo që do të vijojë, ajo e Rabi Isak Tzarfatit, që i takoi osmanët pak para marrjes së Konstandinopojës, në vitin 1453. Ja çfarë u shkroi ai hebrenjve që ndodheshin në Europën Qendrore dhe që po kërkonin ndihmë: "Vëllezër, dëgjojeni këtë këshillë që po ju jap! Edhe unë linda në Gjermani dhe studiova atje Torën bashkë me rabinët gjermanë. U përzura nga vendlindja ime dhe erdha në tokat turke, të cilat janë bekuar nga Zoti me gjithë të mirat. Këtu gjeta prehjen dhe kënaqësinë. Në tokën e turqve nuk kemi për çfarë të ankohemi. Nuk na janë ngarkuar taksa të rënda, dhe as tregtia nuk na është vështirësuar. Çdokush prej nesh jeton në paqe dhe liri. Këtu veshja e një kapeleje të verdhë nuk shihet si shenjë turpi siç shihej në Gjermani. Atje edhe pasuria e mirëqenia iu mallkoheshin hebrenjve, sepse kjo xhelozonte të krishterët. Dëgjoni mëni vëllezër, mbliidhni forcat dhe ejani tek ne. Këtu do çlirohemi nga armiqtë dhe do gjeni prehjen!"²

Kjo është letra e patriarkut Nestorian, Isho-Jabh i III për Simeonin, mitropolitin e Rev-Ardashirit, kryepeshkopi i Persisë: "Ajme, ajme... Asnjë nga ata qindra vetë që mbanin emrin të krishterë nuk i kushtuan jetën Zotit duke derdhur gjakun për besimin e vërtetë... Arabët nuk sulmuan besimin e krishterë; përkundrazi, ata e favorizonin fenë tonë, i nderonin priftërinjtë dhe shenjtorët e Zotit tonë, dhe këshilloheshin në të mirë të kishave dhe manastireve tona. E pse atëherë populli yt i Mervit braktisi besimin e tij për hir të këtyre arabëve?"³

1. ...me të cilin e gjuajmë kaq dendur njëri-tjetrin, por pa arritur gjë të qenësishme; përkundrazi, vetëm se kemi çimentuar pozicionet respektive duke pamundësuar edhe një prej gjendjeve më të nevojshme për qenien: shkëmbimin.

2. Cituar nga Reza Sheh-Kazemi, në esenë *Spirit of Jihad* (2001).

3. Po aty.

Megjithëse mjaft i mprehtë si kritik i Islamit, Bernard Lewis-i nuk mund të bëjë ndryshe veçse të ripohojë faktet historike për karakterin e vërtetë të marrëdhënieve midis myslimanëve dhe hebrenjve deri në ditët e sotme. Në librin e tij *The Jews of Islam*, ai shkruan se, ndonëse mund të kishte një nivel të caktuar diskriminimi ndaj të krishterëve dhe hebrenjve nën ligjin mysliman, "persekutimi, shtypja e dhunshme dhe e vazhdueshme ishte e rrallë dhe aspak e zakonshme. Hebrenjtë dhe të krishterët nën ligjin mysliman, normalisht nuk vuanin për shkak të besimit të tyre. Ata nuk gjendeshin asnjëherë të detyruar të bënin një zgjedhje, sprovë me të cilën u përballën myslimanët dhe hebrenjtë kur u ripushtua Spanja, kohë kur ata ose duhet të mërgonin, ose të hiqnin dorë nga feja e tyre, ose të vdisnin. Ata nuk ishin subjekte të asnjë kufizimi territorial dhe as të ndonjë ndalesë për ushtrim profesioni, gjë që ishte e zakonshme për shumë hebrenj në Europën paramoderne".⁴

Dijetari hebre Mark Cohen kujton: "Interpretimi rabin i Biblës, që është aq i neveritshëm për teologët e krishterë, shqetësoi klerikët myslimanë vetëm sepse kjo gjë turbulloi kthjellësinë e monoteizmit abrahamik. Për këtë arsye, polemika islame kundër rabinëve ishte më pak e egër dhe jehonte më pak. Talmudi u dogj në Paris, jo në Kajro apo Bagdad"

...Parimi që është vendosur këtu është jetësuar më së miri nga Emir Abdulkadri, që udhëhiqte myslimanët algjerianë gjatë qëndresës së tyre heroike ndaj agresionit kolonial francez ndërmjet viteve 1830 dhe 1847. Francezët ishin fajtorë për krimet barbare që kishin kryer në emër të *mission civilisatrice*. Emiri nuk ju përgjigj me hakmarrje dhe zemërim, por me gjakftohësi dhe në bazë të parimeve të luftimit. Në kohën kur francezët masakronin pa dallim fise të tëra, në kohën kur u jepnin ushtarëve shpërblim me nga 10 franga për çdo palë veshë të prerë arabësh dhe kur kokat e arabëve mbaheshin si trofe lufte, Emiri u qëndronte besnik parimeve islame. Refuzimi i tij për të rënë në nivelin e kundërshtarëve të tij të "civilizuar" parashtrohet në këtë dekret: "Çdo arab që kap të gjallë një ushtar francez, do shpërblehet me 8 douros. Çdo arab që ka nën pronësi një francez është i detyruar ta trajtojë mirë dhe ta dorëzojë sa më shpejt te kalifi, ose te vetë emiri. Nëse i burgosuri i luftës ankohet për trajtim të keq, arabi nuk do ketë të drejtën e shpërblimit".⁵

...është e dobishme të prezantojmë këtë pjesë të shkruar nga francezi Léon Roche, që hyri në shoqërinë

4. Po aty.

5. Po aty.

e ngushtë të emirit duke u shtirur sikur kishte pranuar Islamin. Përgjatë rrethimit të Ajn Madit në vitin 1838, i traumatizuar nga të luftuarit dhe vrasjet, Roche u fut në tendën e emirit dhe iu lut ta ndihmonte: "Ai më qetësoi dhe më dha të pija një ekstrakt *schiehh* (një lloj absynthe që pihej rëndom në shkretëtirë). Unë nuk mund të mbaja dot më as kokën time dhe ai e mbështeti në njërin prej gjunjëve të tij. Emiri ishte ulur këmbëkryq sipas mënyrës arabe, ndërsa unë isha zgjatur në anë të tij. Ai vendosi duart në kokën time, më largoi *haik*-un dhe *chechias*-in dhe po më fërkonte kokën. Nën këto lëvizje, më mori gjumi. U zgjova gjatë natës. Hapa sytë dhe u ndjeva i ringjallur. Fiteli i fenerit arab që lëshonte tym, mezi ndiçonte tendën e madhe të emirit. Ai po qëndronte tre hapa larg meje. Mendonte se isha akoma në gjumë. Të dy krahët i kishte ngritur në lartësinë e kokës dhe i dilte në pah *bernous*-i dhe *haik*-u i bardhë, të cilët i derdheshin madhësisht. Sytë e shkruar blu i kishte të ngritur. Buzët i ishin hapur pak dhe dukej sikur recitonte një lutje, por sidoqoftë qëndronte i palëvizur. Kishte arritur në gjendje ekstaze. Aspirata e tij për parajsën ishte e tillë, sa që dukej sikur nuk po e prekte më tokën. M'u dhurua mundësia dhe nderi të flija në tendën e Abdulkadrit, e kisha parë atë teksa lutej dhe përhumbej në mistikë. Por, në atë natë ai më dha imazhin më të mrekullueshëm të besimit. Kështu duhet të jenë lutur edhe shenjtorët e mëdhenj të Krishterimit."⁶

"Pikërisht mbi vrojtimin dhe eksperimentimin mbështeten arritjet e pionierëve të shkencës arabe, arritje që do të përcaktonin hapin e parë drejt çlirimit të mendjes oksidentale nëpërmjet Roger Bacon-it, Alberit të Madh, Leonardo da Vinci-t dhe Galilei-t."⁷

"Dyqind vjet më parë, paraardhësit e Abdullahut kishin lënë Kajrauanin, kryeqytetin e Tunizisë që prej mbretërimit të Sidi Okbazit (pushtuesit të Afrikës Veriore) dhe kishin rendur fluturimthi drejt Sicilisë. Falë puseve dhe makinave të tyre hidraulike ata kishin arritur ta shndërronin truallin e thatë të ishullit, të shkelur aq shpesh nga ushtritë, në një kopsht mahnitës të ngopur me ujë. Ata kishin sjellë me vete nga Tunizia në Sicili palmat e hurmave arabike dhe frashër, kishin mbjellë pemë portokalli, dushkull, banane, mirrë dhe shafra. Ata i kishin ofruar këtij vendi të varfëruar e të rrënuar, një pasuri të re duke shfrytëzuar fushat e pambukut e të kallamit të sheqerit dhe e kishin stolisur me një girlandë kasabash përralore e xhamish të mrekullueshme (në vitin 970, gjeografi Ibn Hukal

6. Po aty.

7. Hunke, S. (2007) *Dielli i Allahut shkëlqen mbi Perëndimin*. Përkth.: Ornela Ademovi.

numëronte jo më pak se treqind, vetëm në qytetin e Palermos). Pallate e xhami përcillnin jehonën e zërave të qartë të poetëve e këngëtarëve të shumtë, kurse filozofë e mjekë, natyralistë e matematikanë përhapnin aty dijen. Atje eruditët shkruanin veprat e tyre në fletë të bardha e të holla, nga letra e parë që ka mbërritur në kontinent, shumë përpara se Spanja t'ia përcillte Oksidentit. Atje poetët thurnin vargjet e tyre delikate, të shkruara në një stil që as grekët, as latinët, as gjermanët nuk e kishin njohur, lirizmi i të cilave do të frymëzonte së shpejti artin poetik të të gjithë popujve të qytetëruar. Ky ishull që u kishte ofruar lumturi, begati e famë ishte bërë atdheu i tyre. Dhe kur luani normand u hodh mbi të, të shumë qenë ata që besuan se nuk do të mund ta duronin "zgjedhën e pamëshirshme të të krishterëve të papastër" dhe, kur mërguan, i breu malli për atdheun e tyre të largët, "kur rrezja e diellit u jep bimëve një gjallëri këndellëse që mbush ajrin me aroma, ku shijohet një ngazëllim që largon çdo mërzi, ku ndjehet një gëzim që asgjëson edhe grimcën më të vogël të armiqësisë".

*Si lukuni që pështjellazi shkojnë pyjesh
E gjithçka handakosin kudo shkelin,
Ashtu lëshohet tutje tëhu skamja
Arat e Sicilisë për t'i shkretuar e mbushur me
pikëllim*

Kështu i përshkruante poeti Ibn Hamdi, i mërguar në Sevilje, tmerret e regjimit të ri."⁸

"Gjithsesi, sjellja e normandëve karshi të nënshtuarve të tyre myslimanë (sjellje që shkaktoi jehonë të madhe në *engagement d'honneur* të gjermanikut përballë kundërshtarit të mbajtur si të barabartë) karakterizohet nga një tolerancë krejtësisht e pakonceptueshme për pjesën tjetër të Oskidentit të krishterë, qoftë për sa i përket kalorësve teutonikë ose për *reconquistadores* spanjollë. A s'na bëhet sikur i ridëgjojmë fjalët e kapitenit Amr para kapitullimit të Aleksandrisë kur, nën dyert e Palermos, duka Roberto Guiscardi u garantoi myslimanëve të rrethuar sigurinë e jetës dhe ruajtjen e pasurive të tyre, duke u garantuar njëkohësisht ushtrimin e lirë të fesë së tyre?"⁹

"Ne besojmë në atë që na është zbritur neve dhe në atë që ju është zbritur juve. Zoti ynë dhe Zoti juaj është një." (Ankebut, 46)

8. Po aty.

9. Po aty.



Pejgamberi DHE Jeta jonë

All Byjyqçapar

Ndriçimi me dije i errësirës së jetës, duhet të jetë misioni ynë primar. Dihet mirë se sa zgjat jeta jonë si individë, por ne duhet të kuptojmë se si njerëzim kemi me mijëra vjet në këtë botë.

Çfarë është bota?

Ne ekzistojmë në sajë të cilësisë së "jetës" që zotëron Allahu i Madhëruar. U krijuam si njerëz dhe para nesh u vu synimi për ta merituar këtë nder. Për këtë arsye, Islami u caktua si kriter i kësaj. A ka mendjelehtësi më të madhe se sa t'ia atribuosh rastësisë gjithçka që ndodh, ndërkohë që në këtë jetë nuk ka asnjë mundësi të jetohet kot e rastësisht?

Mendja dhe pjekuria janë dy vlera të mëdha, në të cilat njeriu gjen kuptimin e ekzistencës së vet. Prandaj, pikërisht këtu e ka vendosur edhe feja islame fushën e ekzistencës. Dhe duke e përdorur këtë si referencë, i ka dhënë drejtim jetës prej kësaj pike.

Edukimi i mendjes është një fazë, e cila mund të realizohet mbi njerëzit e pjekur. Në këtë aspekt, gjykimi "kush nuk ka mendje, nuk ka fe", është shumë i rëndësishëm. Jeta sociale që bëjmë dhe ndodhitë në botën që zhvillohet vazhdimisht, shtyjnë gjithmonë e më shumë që mendja të lihet jashtë funksionit.

Po përse ndodh kështu?

Pikërisht këtu shfaqet edhe një nga të fshehtat e sprovës së kësaj jete. Pranë mendjes duhet të merret edhe dija dhe duke i gatuar të dyja në zjarrin e dashurisë, duhet t'i shndërrojmë në shpirt. Fakti se dijet dhe njohuritë që ndikojnë në jetën tonë dhe na çojnë në thellësi mund t'i përmendim edhe sot, është për shkak se ato na kanë ardhur prej njerëzve të mëdhenj.

Në Kuranin Fisnik urdhërohet: **"O besimtarë! Bindjuni Allahut dhe të Dërguarit, kur ju thërret drejt asaj që ju jep jetë! Dhe ta dini se Allahu ndërhyt midis njeriut dhe**

zemrës së tij dhe se tek Ai do të mbliidheni të gjithë!" (Enfal, 24)

Këta njerëz, që i quajmë pejgamberë, resulë, të dërguar e nebi, janë njerëzit që Allahu i Madhëruar i ka ngarkuar me detyrën për t'i njoftuar njerëzit me urdhrat, ndalesat dhe këshillat e Tij. Kjo dhuatë është si një shkëndijë në errësirat e zemrave dhe një ujë jetëdhënës që rrjedh drejt thelbit të ekzistencës. Pa pejgamberë, shpirtat janë të shkretë dhe shpresat janë të pakuptimta.

Pejgamberët, tek të cilët janë mbledhur virtytet më të larta, janë si oaze jetëdhënëse.

Nëse shohim me vëmendje ato që kanë thënë pejgamberët, do të përballemi me një fushë dijeje, e cila përfshin gjithë jetën. Kjo derë e urtësisë, së cilës bota moderne ka dyqind vjet që i ka kthyer shpinën, vazhdon t'u falë jetë atyre që trokasin në të.

Ky botëkuptim, që i pajis besimtarët me fushën e besimit, adhurimit, moralit, drejtësisë, ekonomisë dhe estetikës, duke i mbajtur ata të gjallë në çdo aspekt të jetës, na thërret edhe ne pesë herë në ditë.

Të gjitha këto dije vijnë tek ne nëpërmjet Pejgamberit tonë (a.s.). Ai është resuli dhe nebiu i fundit i Allahut, i cili është dërguar për të gjithë njerëzimin. Pejgamberi ynë (a.s.), në të cilin ishin përmbledhur të gjitha virtytet e bukura, ishte përgëzues dhe paralajmërues. Ai posedonte moralin më të bukur.

Përpjekja që po bëhet sot për ta kuptuar Pejgamberin tonë (a.s.), me disa nocione të zbrazëta dhe të ngushtuara, na lëndon jashtë mase. Sa e hidhur është që Pejgamberi ynë (a.s.), të përmendet vetëm për "tolerancën", ndërkohë që e gjithë jeta e tij ka qenë e përfshirë nga respekti, rregulli e disiplina!

Ne kemi shumë nevojë për fjalët e Pejgamberit tonë (a.s.), i cili ishte fjalëdrejtë, besnik, i pastër nga gjynahet dhe që i kumtoi njerëzimit të gjitha urdhrat dhe ndalesat që mori prej Allahut të Madhëruar.



NJË BOTË PA ISLAMIN

Graham E. Fuller

Po sikur Islami të mos kishte ekzistuar kurrë? Sikur është mendim lehtësues deri diku, nuk do të kishte përplasje civilizimesh, luftëra të shenjta, as terroristë. A do ta kishte pushtuar Krishterimi botën? A do të ishte Lindja e Mesme fanar paqësor i demokracisë? A do të kishte ngjarë 11 shtatori? Në fakt, hiqni Islamn nga udha e historisë, dhe bota përfundon saktësisht aty ku është sot.

Nëse doni, imagjiloni një botë pa Islamn. Vërtet një gjendje thujse e pakonceptueshme punësh, duke pasur parasysh centralitetin e caktuar të tij në lajmet tona të përditshme. Islami ngjan të gjendet pas një rrezeje të gjerë çrregullimesh ndërkombëtare: sulmet vetëvrasëse, makinat bombë, pushtimet ushtarake, luftërat e rezistencës, trazirat, fetvatë, xhihadet, luftërat guerrile, videot kërcënuese, dhe vetë 11 shtatori. Pse ngjasin këto gjëra? "Islami" duhet të ofrojë një standard analitik të atypëratyshëm dhe jo të komplikuar, duke na dhënë mundësi të nxjerrim kuptimin e botës konvulsive të ditëve të sotme. Në të vërtetë, "Islamofashizmi" është tani, për ca neokonservatorë, armiku ynë i betuar në një "Luftë të Tretë Botërore" të paqartë.

Por më shkoni pas valles për një moment, po sikur të mos kishte gjëra të tilla si Islami? Po sikur të mos kishte ekzistuar kurrë Profeti Muhamed, as saga e përhapjes së Islamit anëve të paana të Lindjes së Mesme, Azisë dhe Afrikës?

Duke pasur parasysh fokusin tonë të madh aktual në terrorizmin, luftën dhe antiamerikanizmin e tërbuar, që janë disa nga çështjet më emocionale ndërkombëtare të ditës, është jetike të kuptohet burimi i vërtetë i këtyre krizave. Në fakt, a është Islami burimi i problemit apo ai ka të bëjë me faktorë më pak të qartë dhe më të thellë? Për hir të argumentit, në një akt të imagjinatës historike, përfytyroni një Lindje të Mesme në të cilën Islami nuk është shfaqur kurrë. A do të ishin kursyer shumë nga sfidat aktuale para nesh? A do ishte Lindja e Mesme më e paqte? Sa i ndryshëm mund të ishte karakteri i marrëdhënieve Lindje-Perëndim? Sigurisht, rendi ndërkombëtar do të paraqiste një tablo krejt të ndryshme pa Islamn nga ç'paraqet sot. Apo do të paraqiste atë?

ÇFARË, PRA, SIKUR TË MOS ISHTE ISLAMI?

Islami i ka trajtësuar në dukje normat kulturore dhe

madje parapëlqimet politike të ndjekësve të tij që në ditët më të hershme të një Lindjeje të Mesme më të gjerrë. Pra, si mund ta ndajmë Islamit nga Lindja e Mesme? Nuk është e vështirë ta imagjinosh ndërsa kjo ngjet.

Të fillojmë me etnicitetin. Pamja e rajonit mbetet ende komplekse dhe konfliktuale pa Islamit. Politikën do ta dominonin përsëri grupet etnike mbizotëruese të Lindjes së Mesme, arabët, persianët, turqit, kurdët, hebrejtë, edhe berberët dhe pashtunët. Merrni persianët: perandoritë e njëpasnjëshme të mëdha persiane qenë në dyert e Athinës shumë përpara Islamit dhe ishin rivalët e përhershëm të kujtdo populli rivalizues semitik të Anadollit të banuar, që gjithashtu i luftuan persianët anekënd *Fğtail Kresğntit (Fertile Crescent)* [Gjysmëhënës Pjellore] dhe në Irak. Pastaj janë forcat e fuqishme të fiseve dhe tregtarëve të ndryshëm arabë, që u hapën dhe migruan para Islamit në hapësirat e tjera semite të Lindjes së Mesme. Mongolët përsëri do t'i kishin shtypur dhe shkatërruar në shekullin e trembëdhjetë qytetërimet e Azisë Qendrore dhe shumë prej Lindjes së Mesme. Turqit përsëri do ta kishin pushtuar Anadollin, Ballkanin, deri në dyert e Vjenës. Këto luftëra për pushtet, territore, ndikim dhe tregti ekzistuan shumë përpara shfaqjes së Islamit.

Por, gjithashtu, është arbitrarë ta përjashtosh plotësisht fenë nga ekuacioni. Në fakt, sikur Islami të mos ishte shfaqur kurrë, pjesa më e madhe e Lindjes së Mesme do të kishte mbetur përgjithësisht e krishterë, me sektet e saj të ndryshme, ashtu siç kishte qenë në agim të Islamit. Asnjë fe tjetër e madhe nuk do të ishte e pranishme, përjashtuar ca zoroastrianë dhe një numër të vogël hebrejsh.

Por a do të kishte mbizotëruar vërtet harmonia me Perëndimin, sikur e tërë Lindja e Mesme të kishte mbetur e krishterë? Kjo është një arritje e largët. Ne do të pretendonim se një botë e paqetë dhe ekspansive mesjetare europiane nuk do ta kishte projektuar pushtetin dhe hegjemoninë e saj në Lindjen fqinje, në kërkim të bazave ekonomike dhe gjeopolitike. Tek e fundit, çfarë ishin kryqëzatat, nëse një aventurë perëndimore nuk ishte shtyrë para së gjithash nga nevojat politike, sociale dhe ekonomike? Flamuri i Krishterimit ishte pak më shumë se një simbol i fuqishëm, një kushtrim grumbullimi për të bekuar impulset më shekulare të europianëve të fuqishëm. Në fakt, feja e veçantë e

vendasve kurrë nuk figuroi shumë në mësymjen perandorake të Perëndimit anembanë globit. Europa mund të ketë folur në mënyrë frymëzuese mbi sjelljen "vendasve të vlerave të krishtera", por objektivi i dukshëm ishte vendosja e bazave koloniale si burime pasurie për metropolet dhe pikëmbështetje për projektimin e pushtetit perëndimor.

Dhe kështu, është e pamundur që banorët e krishterë të Lindjes së Mesme ta mirëprisnin rrëkenë e flotave europiane dhe tregtarëve të tyre, mbështetur nga armët perëndimore. Imperializmi do të kishte prosperuar në mozaikun kompleks etnik të rajonit, lënda e parë për lojën e vjetër të ndarjes dhe sundimit. Dhe europianët, për të plotësuar nevojat e tyre, do të kishin vendosur të njëjtët sundimtarë lokalë të predispozuar për t'u drejtuar.

Lëvizeni orën para, në epokën e naftës në Lindjen e Mesme. A do ta kishin mirëpritur shtetet e Lindjes së Mesme, edhe nëse të krishtera, vendosjen e protektorateve europiane mbi rajonin e tyre? Vështirë! Perëndimi do të kishte ndërtuar dhe kontrolluar përsëri të njëjtat ngushtica, të tilla si Kanali i Suezit. Nuk ishte Islami që i bëri shtetet e Lindjes së Mesme t'i rezistojnë fuqishëm projektit kolonial, me rivijëzimin e tij drastik të kufijve sipas parapëlqimeve gjeopolitike europiane. As të krishterët e Lindjes së Mesme nuk do t'i kishin mirëpritur më shumë se myslimanët kompanitë imperiale perëndimore të naftës, mbështetur nga më-

këmbësit, diplomatët, agjentët e shërbimeve të fshehta dhe ushtritë e tyre europiane. Vështroni në historinë e gjatë të reagimeve të Amerikës Latine ndaj dominimit amerikan mbi naftën, ekonominë dhe politikën e tyre. Lindja e Mesme do të kishte qenë një lloj e prirur për të krijuar lëvizje nacionaliste antikolonialiste, për ta marrë kontrollin mbi tokën, tregjet, sovranitetin dhe fatin e saj prej zotërimit të huaj, ashtu si përpjekjet antikoloniale në Indinë hinduiste, Kinën konfuciane, Vietnamin budist, në Afrikën e krishterë dhe animiste.

Dhe, sigurisht, francezët do të hapeshin lehtësisht në një Algjeri të krishterë, për të pushtuar tokat e saj të pasura dhe për të vendosur një koloni. Po ashtu, italianët nuk e lanë kurrë krishterimin e Etiopisë t'i ndalojë për ta kthyer atë vend në një koloni të administruar ashpërsisht. Shkurt, nuk ka arsye për të besuar se një reagim i Lindjes së Mesme ndaj përvojës së rëndë

Për hir të argumentit, në një akt të imagjinatës historike, përfytyroni një Lindje të Mesme në të cilën Islami nuk është shfaqur kurrë. A do të ishin kursyer shumë nga sfidat aktuale para nesh? A do ishte Lindja e Mesme më e paqetë?

koloniale europiane do të kishte dalluar në mënyrë domethënëse nga mënyra se si reagoi në të vërtetë nën Islamin.

Por, vallë, Lindja e Mesme do të kishte qenë më demokratike pa Islamin? Vetë historia e diktaturës në Europë nuk të jep besim këtu. Spanja dhe Portugalia i dhanë fund diktaturës vetëm në mesin e viteve 1970. Greqia doli vetëm pak dekada më parë nga diktatura e lidhur me kishën. Rusia e krishterë nuk është ende jashtë gardhit. Amerika Latine ishte deri tani vonë e bërë shoshë me diktatorë, të cilët sunduan shpesh me bekimin e SHBA-së dhe në partneritet me Kishën Katolike. Pjesa më e madhe e vendeve të krishtera afrikane nuk ia kanë kaluar shumë më mirë. Pse një Lindje e Mesme e krishterë do të kishte parë ndonjë ndryshim?

Pastaj është Palestina. Sigurisht, ishin të krishterët të cilët i persekutoan paturpësisht hebrenjtë për më shumë se njëmijëvjeçar, duke kulmuar me Holokaustin. Këta shembuj të tmerrshëm të antisemitizmit ishin rrënjësor fort në tokat dhe kulturën perëndimore të krishterë. Prandaj hebrenjtë do të kishin kërkuar prapëseprapë një atdhe jashtë Europës; lëvizja sioniste do të kishte lindur përsëri dhe do të kërkonte një bazë në Palestinë. Dhe përsëri shteti i ri hebre do t'i kishte përzënë të njëjtët 750.000 vendas arabë të Palestinës nga tokat e tyre, edhe sikur të kishin qenë të krishterë. E, në të vërtetë, disa prej tyre ishin të tillë. A nuk do të kishin luftuar këta palestinezë arabë për t'i mbrojtur apo rimarrë tokat e tyre? Problemi izraelito-palestinez mbetet në thelb një konflikt nacional, etnik dhe territorial, i mbështetur dhe përforcuar vetëm së fundi nga sloganet fetare. Dhe të mos harrojmë se të krishterët arabë luajtën një rol shumë të madh në shfaqjen fillestare të tërë lëvizjes nacionaliste arabe në Lindjen e Mesme. Vërtet, themeluesi ideologjik i së parës parti panarabe bathe, Mishel Aflaku (Michel Aflaq), ishte një i krishterë sirian i arsimuar në Sorbonë.

Por sigurisht, të krishterët në Lindjen e Mesme do të kishin qenë së paku të predispozuar fetarisht nga Perëndimi. A nuk mund ta kishim shmangur ne tërë atë konflikt fetar? Në fakt, vetë bota e krishterë u përçua nga herezitë që nga shekujt e parë të pushtetit të krishterë, herezi që u bënë pikërisht mjeti i opozitës politike ndaj pushtetit romak apo bizantin. Luftërat

fetare perëndimore, larg bashkimit nën fenë, mbuluan pandryshueshmërisht përpjekje më të thella etnike, strategjike, politike, ekonomike dhe kulturore për dominim.

Pikërisht dhe referencat për një "Lindje të Mesme të krishterë" fshehën një armiqësi shëmtarake. Popujt e Lindjes së Mesme do të kishin qëndruar pa Islamin siç ishin në lindjen e Islamit, përgjithësisht pasues të Krishterimit Ortodoks të Lindjes. Por është e lehtë të harrosh se një nga diskutimet më të pambarimta, më therëse dhe më të hidhura të historisë ishte ai midis Kishës Katolike në Romë dhe Krishterimit Ortodoks të Lindjes në Konstandinopojë, një mერი që vazhdon ende sot. Të krishterët ortodoksë nuk e harruan apo nuk e falën kurrë plaçkitjen e Konstandinopojës nga kryqtarët perëndimorë më 1204. Papa Gjon Pali II kërkoi afër 800 vjet më vonë, më 1999, të ndërmerre ca hapa të vegjël për pajtim në vizitën e parë në njëmijë vjet të një pape katolik në botën ortodokse. Qe një fillim, por konflikti mes Lindjes dhe Perëndimit në një Lindje të Mesme të krishterë do të kishte mbetur thuajse ashtu siç është sot. Për shembull, merrni Greqinë: kauza ortodokse është një shtysë e fuqishme pas nacionalizmit dhe ndjenjës antiperëndimore atje, dhe veç një dekadë më parë pasionet antiperëndimore në politikën greke u bënë jehonë të të njëjtave dyshime dhe pikëpamjeve therëse mbi Perëndimin që ne dëgjojmë sot nga shumë udhëheqës islamistë.

Kultura e Kishës Ortodokse dallon fort nga etosi perëndimor pas Iluminizmit, që i mëshon shekullarizmit, kapitalizmit dhe parësisë së individit. Ajo akoma mban frikëra të mbetura mbi Perëndimin, që krahasohen në shumë drejtime me pasiguritë aktuale myslimane. Frikëra nga prozelitizmi misionar perëndimor, një tendencë për ta perceptuar fenë si një mjet kyç për mbrojtjen dhe ruajtjen e komuniteteve dhe kulturës së tyre, dhe një dyshim mbi karakterin "e zvetënuar" dhe imperial të Perëndimit. Vërtet, Moska do të gëzonte edhe sot ndikim të veçantë në një Lindje të Mesme krishtere ortodokse, si qendra e fundit e madhe e Ortodoksisë së Lindjes. Bota ortodokse do të kishte mbetur një arenë kyçe gjeopolitike e rivalitetit Lindje-Perëndim në Luftën e Ftohtë. Në fund të fundit, Samuel Hantingtoni (Samuel Huntington) e përfshiu botën krishtere ortodokse mes një sërë qytetërimesh të përfshirë në një

përplasje kulturore me Perëndimin.

Sot, pushtimi i Irakut prej SHBA-ve nuk do të ishte më shumë i mirëpritur për irakenët sikur ata të qenë të krishterë. SHBA-të nuk e rrëzuan Saddam Huseinin, një udhëheqës shumë nationalist dhe shekullar, sepse ai ishte mysliman. Popujt e tjerë arabë do t'i kishin mbështetur përsëri arabët irakenë në traumën e tyre nga pushtimi. Asgjëkund populli nuk e mirëpret pushtimin e huaj dhe vrasjen e qytetarëve të tij nga trupat pushtuese. Sigurisht, grupet e kërcënuara nga forcat e tilla të jashtme kërkojnë ideologjitë e duhura për të justifikuar dhe glorifikuar luftën e tyre të rezistencës. Feja është një ideologji e tillë.

Ky, pra, është portreti i një "bote pa Islamin" të imagjinuar. Është një Lindje e Mesme e dominuar nga Krishterimi Ortodoks i Lindjes, një kishë historikisht dhe psikologjikisht mosbesuese, madje armiqësore ndaj Perëndimit. E përçarë nga dallimet e mëdha etnike dhe madje sektariane, ajo ka një ndjenjë të fortë vetëdijeje dhe mërie historike kundër Perëndimit. Ajo është pushtuar në mënyrë të përsëritur nga ushtritë imperialiste perëndimore, burimet e saj janë marrë me forcë, kufijtë janë ravijëzuar me vendimin perëndimor sipas interesave të tij të ndryshme, dhe regjimet e vendosura kanë qenë të bindura ndaj diktatit perëndimor. Palestina prapë do të digjej. Irani do të ishte përsëri shumë nationalist. Ne do t'i shihnim përsëri palestinezët t'u rezistonin hebrenjve, çeçenët t'u rezistonin rusëve, iranianët t'u rezistonin britanikëve dhe amerikanëve, kashmirët t'u rezistonin indianëve, tamilët t'u rezistonin singalezëve në Sri Lanka, dhe ujugurët e tibetianët t'u rezistonin kinezëve. Lindja e Mesme do të kishte qenë përsëri një model i lavdishëm historik – Perandoria e madhe Bizantine me më shumë se 2000 vjet mbi shpinë – me të cilën të identifikohesh si një simbol kulturor dhe fetar. Në shumë aspekte do të përjetësonte një ndarje Lindje-Perëndim.

Nuk është plotësisht një tablo e paqte dhe lehtësuese.

NËN FLAMURIN E PROFETËVE

Sigurisht që është absurde të argumentosh se ekzistenca e Islamit nuk ka pasur asnjë ndikim të pavarur në Lindjen e Mesme apo në marrëdhëniet Lindje-Perëndim. Islami është anekënd një rajoni të gjerë një

forcë unifikuese e një rendi të lartë. Ai, si një besim universal global, ka krijuar një qytetërim të gjerë, që ndan shumë parime të përbashkëta mbi filozofinë, artin dhe shoqërinë, një vizion të jetës morale, një ndjenjë drejtësie, jurisprudencë dhe qeverisjeje të mirë, të tëra në një kulturë të lartë thellësisht të rrënjëzuar. Islami, si një forcë kulturore dhe morale, ka ndihmuar në kapërcimin e dallimeve etnike midis popujve të ndryshëm myslimanë, duke i inkurajuar ata të ndihen pjesë e një projekti më të gjerë civilizues mysliman. Fakti që Islami preku dhe gjeografinë politike vetëm i jep peshë të madhe. Të mos kishte qenë Islami, vendet myslimane të Azisë së Jugut dhe Azisë Juglindore, veçanërisht Pakistani, Bangladeshi, Malajzia dhe Indonezia, do të ishin rrënjëzuar në vend të kësaj në botën hinduiste.

Qytetërimi islam siguroi një ideal të përbashkët, të cilit mund t'i bënin thirrje të gjithë myslimanët në emër të rezistencës kundër dhunimit perëndimor. Edhe po qe se ai apel nuk arriti ta ndalë valën imperiale perëndimore, krijoi një kujtesë kulturore të një fati të ndarë normalisht, që nuk u largua. Europeanët ishin në gjendje të ndajnë dhe të pushtojnë një numër popujsh afrikanë, aziatikë dhe latino-amerikanë, të cilët u ndjenë të vetëm para fuqisë perëndimore. Mes atyre popujve ishte e vështirë të arrihej një rezistencë e bashkuar, transnacionale, nga mungesa e një simboli të përbashkët etnik apo kulturor të rezistencës.

Imperializmi perëndimor do ta kishte pasur shumë më të lehtë detyrën e ndarjes, pushtimit dhe sundimit të Lindjes së Mesme dhe Azisë në një botë pa Islamin. Nuk do të kishte mbetur një kujtesë e ndarë kulturore e përluljes dhe humbjes anembanë një hapësire të paanë. Sot, ndërkomunikimet globale dhe imazhet e ndara satelitore kanë krijuar një ndjenjë të fortë vetëdijeje mes myslimanëve dhe një ndjenjë të një rrethimi më të gjerë imperial perëndimor kundër një kulture të përbashkët islame. Ky rrethim nuk është për modernizmin. Është për kërkimin e papushimtë perëndimor të sundimit të hapësirës strategjike, burimeve, dhe madje të kulturës së botës myslimane.

Por ç'mund të thuhet për terrorizmin, çështjen më të ngutshme që Perëndimi e shoqëron menjëherë sot me Islamin? Me termat më të drejtpërdrejta, a do të kishte pasur një 11 shtator pa Islamin? Përsëri, është

e rëndësishme të kujtohet se sa lehtësisht mund të thirret në ndihmë feja edhe kur duhen fajësuar mëri të tjera, të mbajtura gjallë për një kohë shumë të gjatë.

Kujtimet në fokusin e Perëndimit në terrorizmin në emër të Islamit janë veç guerrilasit hebrej që përdorën terrorizmin kundër britanikëve në Palestinë. "Tigrat" tamilë hindu të Sri Lankës shpikën artin e jelekëve vetë-vrasës dhe për më shumë se një dekadë e udhëhoqën botën në përdorimin e bombave vetë-vrasëse, duke përfshirë vrasjen e kryeministrit indian Raxhiv Gandhi (Rajiv Gandhi; kryeministër gjatë viteve 1984-1991). Terroristët grekë kryen operacione për vrasjen e zyrtarëve amerikanë në Athinë. Terrorizmi i organizuar sik (sikh) vrau Indira Gandin, përhap kaos në Indi, vendosi një bazë në Kanada dhe rrëzoi një aeoplan të Air India që po fluturonte mbi Atlantik. Terroristët maqedonas i kishin shtënë frikën tërë Ballkanit në prag të Luftës së Parë Botërore. Në fundin e shekullit të nëntëmbëdhjetë dhe në fillimin e shekullit të njëzetë u kryen dhjetëra vrasje nga "anarkistët" europianë dhe amerikanë, duke mbjellë frikë kolektive. Ushtria Republikane Irlandeze përdori brutalisht për dekada terrorizmin kundër britanikëve, siç bënë terroristët dhe guerrilasit terroristë në Vietnam kundër amerikanëve, komunistët mallezë kundër ushtarëve britanikë në vitet 1950, terroristët Mau Mau kundër oficerëve britanikë në Kenia, e kështu vazhdon lista. Ajo nuk përfshin një mysliman që të kryejë terrorizëm.

Edhe historia e freskët e aktivitetit terrorist nuk shihet shumë ndryshe. Sipas Europolit, në vitin 2006 u kryen 498 sulme terroriste në Bashkimin Europian. Nga këto, 424 u kryen nga grupet separatiste, 55 nga ekstremistët e krahut të majtë, dhe 18 nga terroristët të tjerë të ndryshëm. Vetëm një u krye nga islamistët. Për të qenë të sigurt, pati një numër përpjekjesh të pasuksesshme në një bashkësi myslimane tejet tëurvejuar. Por këto figura zbulojnë rrezën e gjerë ideologjike të terroristëve potencialë në botë.

Pra, a është aq e vështirë t'i imagjinosh arabët, të krishterë apo myslimanë, të zemëruar me Izraelin apo invazionet, përmbysjet dhe ndërhyrjet e vazhdueshme të imperializmit, duke përdorur akte të ngjashme terrorizmi dhe duke bërë luftë guerrile? Pyetja mund të jetë në vend të kësaj, pse kjo nuk ngjau më herët? Ndërsa grupet radikale artikulojnë meritë në epokën tonë të globalizuar, pse nuk duhet të presim që ata ta mbartin luftën e tyre në zemër të Perëndimit?

Edhe sikur Islami si mjet rezistence të mos kishte ekzistuar kurrë, do të ekzistonte marksizmi. Eshtë një ideologji që ka lindur terroristë, guerrilje dhe lëvizje të panumërta nacionalçlirimtare. Ajo i ka dhënë formë ETA-s baske, FARK-ut në Kolumbi, Udhës së Ndrishme (Shinning Path) në Peru, dhe Fraksionit të Ushtrisë së Kuqe (Red Army Faction) në Europë, për të emërtuar vetëm një numër të vogël në Perëndim. Xhorxh Habashi (George Habash), themeluesi i Frontit Popullor për Çlirimin e Palestinës, ishte një i krishterë ortodoks grek dhe marksist, i cili studioi në Universitetin Amerikan të Bejrutit. Shumë palestinezë të krishterë i dhanë Habashit mbështetjen e tyre në një erë kur nacionalizmi i zemëruar arab flirtoi me marksizmin.

MË SHUMË SE E NJËJTA

Por mbetet pyetja, a do të ishte bota më e paqte, sikur të mos ekzistonte Islami? Pa diskutim që Islami shton një element akoma më emotiv përballë këtyre tensioneve mes Lindjes dhe Perëndimit, një masë më shumë komplikimesh për gjetjen e zgjidhjeve. Islami nuk është shkaku i problemeve të tilla.

Një botë pa Islamin do t'i shihte përsëri shumë nga rivalitetet e vazhdueshme të përgjakshme, luftërat dhe sprovat e të cilëve e dominojnë panoramën gjeopolitike. Të tërë këto grupe do të kishin gjetur flamur tjetër, po të mos ishte feja, nën të cilin të shprehnin nacionalizmin dhe kërkimin e pavarësisë. Sigurisht, historia nuk do të kishte ndjekur të njëjtën udhë

siç ka ndjekur. Por, në taban, konflikti midis Lindjes dhe Perëndimit mbetet i tëri rreth çështjeve të mëdha historike dhe gjeopolitike të historisë një-rëzore: etnicitetit, nacionalizmit, ambicies, lakmisë, burimeve, udhëheqësve vendorë, territorit, fitimit financiar, pushtetit, ndërhyrjeve. Si nuk mund të thirret në ndihmë forca e fesë përballë këtyre çështjeve të përhershme si këto?

Gjithashtu, kujtoni se në të vërtetë çdo një nga tmerret më të dëguara të shekullit të njëzetë erdhi pothuajse ekskluzivisht nga regjime ngurtësisht shekullare: Leopoldi II i Belgjikës në Kongo, Hitleri, Musolini, Lenini dhe Stalini, Mao Ce Duni dhe Pol Poti.

Sot ca mund të duan një "botë pa Islamin", në të cilën këto probleme ndoshta nuk do të kishin qenë kurrë. Por në të vërtetë, konfliktet, rivalitetet dhe krizat e një bote të tillë mund të mos shiheshin aq shumë ndryshe nga ato që njohim sot.

Pa diskutim që Islami shton një element akoma më emotiv përballë këtyre tensioneve mes Lindjes dhe Perëndimit, një masë më shumë komplikimesh për gjetjen e zgjidhjeve. Islami nuk është shkaku i problemeve të tilla.



DITA E LLOGARISË

Njeriu nuk është krijuar për t'u lënë në qef të vet. Një ditë ai do të japë llogari për gjithçka që bën. Në Ditën e Llogarisë askush nuk do të ketë mundësi t'i bëjë dobi ndokujt. Secili do ta japë vetë llogarinë e tij.

Dita e Llogarisë, për të cilën na lajmëron Kurani Fisnik, patjetër do të vijë; të gjithë do të japin llogari një nga një. Kushdo që ka bërë mirë apo keq sa një grimcë, do ta marrë shpërblimin e tij.

Në një hadith fisnik, të shënuar në Mesharik, shohim se përkrah dashurisë dhe mëshirës që ka Pejgamberi ynë (a.s.), ndaj vajzës së tij Fatma (r.a.), ai nuk ngurron ta porosisë atë në lidhje me botën tjetër:

"Bija ime Fatma Zehra! Përpiqu ta shpëtosh shpirtin tënd nga zjarri i xhehenemit, sepse në botën tjetër unë nuk do të kem fuqi ta largoj dënimin që do të bjerë mbi ju për shkak të braktisjes së farzeve dhe veprimit të haramëve. E megjithatë, unë nuk mund t'i braktis të afërmit në këtë botë. Unë do të vazhdoj t'u jap e t'u bëj mirë."

Në krahasim me ju, unë i ngjaj një njeriu që kur sheh një armik, i cili po sulmon fëmijët dhe familjen e tij, nuk mund të bëjë gjë tjetër për ta mbrojtur familjen dhe fëmijët e tij, përveçse t'u thërrasë atyre "ikni" ose "fshihuni". Pas kësaj, çdo gjë ju takon juve."

Me këto fjalë të bekuara, Pejgamberi ynë (a.s.), dëshiron që Ehl-i Bejti (familja e tij), të mos tregohet e dobët dhe e lëkundur në besim, të mos tregojë dembelizëm dhe përtaci në kryerjen e detyrave si myslimanë dhe të mos i braktisin veprat e mira dhe të bukura.

Në atë ditë të ashpër, të shtypurit do të marrin hakun e tyre ndaj zullumqarëve. Rasulullahu (a.s.), u drejtohet shokëve të tij dhe u thotë:

"Mos u bëni tiranë, por as të shtypur." Madje, ai i ka porositur se, nëse janë të detyruar, më mirë le të

zgjedhin të jenë të shtypur. Ne duhet të përgatitemi për atë ditë, kur askush nuk do t'i bëjë dobi askujt. Për këtë arsye, duhet të përpiqemi me të gjitha forcat të kryejmë detyrat që na ka ngarkuar Allahu ashtu siç duhet dhe me sinqeritet të plotë. Ata që kanë dobësi në besim dhe në sinqeritet do të përfundojnë në xhehenem, për shkak se veprat e tyre me qëllim të prishur nuk do t'u bëjnë asnjë dobi.

Pasi të forcojmë besimin, duhet të përpiqemi të zbatojmë me përpikëri urdhrat e Kuranit Fisnik, pra të ruhem nga gjërat që ka ndaluar Allahu i Madhëruar dhe të zbatojmë urdhrat e Tij. Ndërkohë që plotësojmë namazet dhe agjërimet tona me përkushtim, duhet të ruhem nga shkelja e të drejtës/hakut të robit. Vetëm tiranët dhe zullumqarët nuk e ruajnë veten nga shkelja e të drejtave të të tjerëve, sepse ata nuk kanë frikë as nga Allahu.

Ne duhet t'i japim rëndësi të madhe përmirësimit dhe ngritjes së gjendjes sonë morale. Përveç kësaj, duhet të ruajmë edhe familjen dhe fëmijët tanë, të cilët janë edhe amanetet e Allahut të Madhëruar. Ne kemi përgjegjësinë të kujdesemi për ta në çdo çështje, t'u shpjegojmë të vërtetën dhe t'i ndihmojmë në zbatimin e saj. Ne duhet të marrim shembull nga Rasulullahu (a.s.), i cili edhe pse e donte shumë vajzën e tij Fatman dhe sillej shumë butë me të, ai nuk e la atë pa e paralajmëruar për atë ditë të vështirë.

Ne duhet të punojmë shumë me fëmijët tanë dhe të fusim në zemrat e tyre dashurinë për Allahun e Madhëruar dhe të Dërguarin e Tij (a.s.). Prindërit që nuk u japin përgjigje fëmijëve dhe atyre që kanë nën kujdes kur pyesin se ç'është Allahu, ç'është Pejgamberi etj., do të bëhen shumë pishman në ditën e llogarisë së madhe. Por kjo nuk do t'u vlejë, sepse atë ditë çdo gjë ka mbaruar.



Ma. Muhidin Ahmeti

ZOTIMI PËR DASHURI DHE UNITET VËLLAZËROR

Të gjitha falënderimet i takojnë vetëm Allahut, Atë e falënderojmë, prej Tij ndihmë, falje dhe udhëzim kërkujmë. Qoftë lartësuar Ai, i Cili dërgoi Muhamedin për ta përkryer dritën dhe fenë e vërtetë, i udhëzoi përmes tij njerëzit, ua hapi atyre syrin e shpirtit dhe horizontin e dijes, i bashkoi pasi kishin qenë të përçarë, i bëri miq pasi kishin qenë armiq. Qoftë madhëruar Ai që na urdhëroi ta duam njëri- tjetrin si vëllezër besimtarë, Ai që kërkoi prej nesh të ndërtojmë ura lidhëse të dashurisë dhe të unitetit vëllazëror.

URAT E DASHURISË

S'ka dyshim se dashuria në emër të Allahut (xh.sh.), paraqet njërin nga postulatet më të rëndësishme të themelit të besimit, sikurse na ka bërë të ditur për këtë Pejgamberi ynë i dashur Muhamedi (a.s.).

Kjo dashuri ka urat e veta lidhëse, të cilat Zoti ynë i Lartësuar dhe i Madhëruar i ka vendosur mes njerëzve dhe me të cilat i ka lidhur zemrat e tyre. Allahu i lartësuar i ka përmendur këto ura në shumë vende në Librin e Tij madhështor – Kuranin (a.sh.). T'i shohim disa shembuj të ajeteve të tilla, të cilat emocionojnë çdo zemër të shëndoshë njerëzore.

Allahu (xh.sh.), thotë:

“O njerëz! Në të vërtetë, Ne ju krijuam ju prej një mashkulli dhe një femre dhe ju bëmë popuj e fise, për ta njohur njëri-tjetrin. Më i nderuari prej jush tek Allahu është ai që i frikësohet më shumë Atij. Vërtet, Allahu është i Gjithëdijshëm dhe për Atë asgjë nuk është e fshehtë.” (Huxhurat, 13)

“Sikur të shpenzoje tërë pasurinë që gjendet në Tokë, nuk do të mund t'i bashkoje zemrat e tyre, por Allahu i bashkoi ato. Ai është vërtet i Plotfuqishëm dhe i Urtë.” (Enfal, 63)

Kurani konfirmon se myslimanët janë vëllezër:

“S'ka dyshim se besimtarët janë vëllezër, pra bëni pajtim ndërmjet vëllezërve tuaj dhe kini frikë Allahun, që të jeni të mëshiruar (nga Zoti).” (Huxhurat,10)

Në një hadith kudsij, Allahu (xh.sh.), thotë:

“Dashuria lme është e siguruar për ata të cilët shpëtohen mes vete, ndihmohen dhe duhen. Unë jam i treti midis dy miqve (shokëve) gjithnjë, derisa njëri nuk e tradhton tjetrin. Unë atëherë i braktis.”

Edhe Pejgamberi (a.s.), i ka përmendur urat lidhëse të dashurisë, madje është ai i cili i themeloi, i ndërtoi dhe i vazhdoi lidhjet e dashurisë në zemrat dhe shpirtat e

pasuesve të tij deri në Ditën e Gjykimit. Pejgamberi (a.s.), në hadithin që e transmeton Ebu Hurejre thotë:

"Myslimani te myslimani ka gjashtë të drejta." Cilat janë ato të drejta, o Pejgamberi i Allahut,- e pyetën. Ai tha: "Kur ta takosh, t'i japësh selam, kur të thërret, t'i përgjigjesh thirrjes, kur kërkon prej teje ndonjë këshillë, ta këshillosh, kur teshtin dhe të falënderojë Allahun, të thuash: "jerhamukell-llah" (Allahu të mëshiroftë), kur sëmuret, ta vizitosh dhe kur vdes, t'ia përcjellësh xhenazen." (Myslimi)

Vlerën e dashurisë në emër të Allahut (xh.sh.), e vërteton edhe ky hadith i Pejgamberit (a.s.):

"Ka disa robër të Allahut, të cilët nuk janë as pejgamberë, as shehidë e do t'ua kenë lakmi edhe pejgamberët edhe shehidët në Ditën e Gjykimit, për shkak të pozitës së tyre tek Allahu." E pyetën sahabët: "Na trego, o Pejgamber i Allahut, kush janë ata?"

Pejgamberi i Allahut (a.s.), tha:

"Ata janë njerëzit të cilët e duan njëri-tjetrin në emër të Allahut (xh.sh.), e nuk janë farefis, as nuk kanë ndonjë përfitim prej saj. Fytyrat e tyre do të jenë dritë dhe ata do të jenë në dritë. Nuk do të kenë frikë atë ditë kur njerëzit do të frikësohen, as nuk do të dëshpërohen, kur të tjerët do të jenë të dëshpëruar." (Omer ibnu-l-Hattab r.a.)

Dhe pastaj, lexoi ajetin kuranor:

"Ta keni të ditur se të dashurit e Allahut (evliatë) nuk kanë frikë (në botën tjetër) e as kurrfarë bren-gosjeje." (Junus, 62)

ARTI I AFRIMIT TË SHPIRTRAVE

Të gjithë njerëzit janë krijesa të Zotit. Zoti (xh.sh.), e dhuron jetën dhe e ruan atë. Kush shpëton një jetë njerëzore, është sikur të ketë shpëtuar gjithë njerëzimin. Kush shkatërron një jetë njerëzore, është sikur të ketë shkatërruar gjithë njerëzimin. Kjo botë ekziston mbi besimin dhe solidaritetin mes njerëzve. Zoti do që njerëzit të ndihmohen në bamirësi dhe ndershmëri. Zoti nuk do që njerëzit të ndihmojnë njëri-tjetrin në gjynah dhe armiqësi.

Njeriu është krijesa më e shkëlqyer, më e përkryer dhe më e kompletuar që ekziston në Tokë. Është kurora e të gjitha krijesave në këtë botë. Zoti atë e ngriti në shkallë të larta dhe e bëri zëvendës të Vetin në Tokë.

Prandaj, Allahu është mbrojtësi i dinjitetit dhe i nderit njerëzor. Ai është mbrojtësi i të drejtave themelore njerëzore. Muhamedi (a.s.), ka thënë:

"Njeriu është vepër madhështore e Allahut dhe shkatërrim për atë që njollos nderin dhe dinjitetin e veprave të Allahut. O njerëz, nderoni dhe çmoni vlerën e personalitetit dhe të dinjitetit njerëzor." (Nga fjalimi i Resulull-llahut (a.s.), në Arefat)

Prandaj ne si myslimanë, duhet të nderojmë njeriun

dhe dinjitetin e tij. Të nderojmë njeriun si vepër të Zotit, si krijesë të Zotit, si vëlla të familjes nga babai i përbashkët Ademi (a.s.) dhe nëna e përbashkët Hava.

Është interesante se si Kurani përdor fjalë nga jeta familjare, në mënyrë që të pasqyrojë sa më fuqishëm unitetin që kërkohet prej myslimanëve. Myslimanët janë vellezër - kjo do të thotë se ata duhet të kenë në konsideratë njëri-tjetrin, të jenë sentimentalë (të ndjeshëm) ndaj njëri-tjetrit, të ndihmojnë dhe të kujdesen për njëri-tjetrin në të gjitha situatat jetësore, sikurse e bëjnë këtë vellezërit prej një nëne dhe një babai. Por edhe fjala ummet, që tregon për gjithë myslimanët e botës, vjen nga i njëjti rreth: nga fjala umm- që do të thotë: nënë, themel, bazë, kështu që të gjithë myslimanët e botës duhet të duhen mes vete siç i do nëna fëmijët e vet dhe të lidhen për themelin dhe bazën e njëjtë.

Myslimanët janë vellezër. Vellezërit e ndihmojnë njëri-tjetrin në punë të mira dhe të dobishme. Vellezërit nuk e sabotojnë njëri-tjetrin. Është obligim i çdo myslimani dhe myslimaneje të ndihmojë vëllain dhe motrën e vet. Nëse nuk e bën dot një gjë të tillë, atëherë le të mos e sabotojë (pengojë). Edhe ajo është ndihmë.

As vuajtjet e agonisë së vdekjes nuk mundën ta pengojnë Pejgamberin (a.s.), që në momentin e ndarjes nga kjo botë, në fundin e jetës së tij, t'u linte sahabëve këto këshilla të shkëlqyeshme:

"Jini të mëshirshëm ndaj njëri-tjetrit. Ju jeni vellezër e motra në mes vete. Ju mbështetni njëri-tjetrin sikur tullat dhe ashtu mbani fort ndërtesën e bashkësisë suaj. Ruajuni dyshimeve, sepse të dyshuarit është dukuria më e keqe. Mos lejoni që në prezencën tuaj të flitet keq për personat që nuk janë të pranishëm, mos spiunoni njëri-tjetrin, mos e urreni dhe mos ia ktheni shpinën njëri-tjetrit, mos bëni gara me të keqën, mos e kini zili njëri-tjetrin, mos e urreni dhe mos ia ktheni shpinën njëri-tjetrit. Bëhuni të drejtë dhe ruani shpirtin tuaj nga padrejtësia e zullumi. Mos mbillni urrejtje, veç dashuri..."

Bëhuni robër të Allahut, vellezër të vërtetë, ashtu si ju ka urdhëruar Ai...

Në qoftë se dikujt i kam mbetur borxh, i lutem të ma thotë këtu, sepse dua të turpërohem këtu para jush, se sa në Ditën e Gjykimit para Allahut (xh.sh.).

Ma pastroni shpirtin tim nga të gjitha padrejtësitë, që të mund të dal faqebardhë para Allahut (xh.sh.), etj., etj. (Muslimi nga Ebu Hurejre)

Ja, kështu foli Resulullahu edhe në momentin e vdekjes, ashtu siç kishte folur gjatë gjithë jetës. Paqja dhe dashuria ndërmjet njerëzve qenë preokupimi më i madh i tij. Kjo qe kështu, sepse ai e dinte që smira dhe urrejtja, përpjinnë dhe djegin çdo vlerë njerëzore, sikurse zjarri drutë e thata, siç thoshte vetë ai.

Myslimanët patjetër duhet të jenë në harmoni në mes vete dhe të bashkuar e unikë në të gjitha çështjet

e jetës së Bashkësisë dhe të mbledhur të gjithë rreth parimit kuranor:

“Dhe kapuni për litarin e Allahut dhe mos u përçani. Përkujtoni begatinë (nimetin) e Allahut ndaj jush, kur ju ishit të armiqësuar e Ai bashkoi zemrat tuaja dhe ashtu me dhuntinë e Tij u zgjuat si vëllezër. Madje, ishit buzë greminës së xhehenemit e Ai ju shpëtoi prej tij...” (Al' Imran, 103)

“Respektoni Allahun dhe Pejgamberin e Tij e mos u përçani në mes vete, që të mos dobësoheni e ta humbni fuqinë...” (Enfal, 46)

XHEMATI DHE QËLLIMI I IBADETIT

Islami erdhi që të lartësojë njeriun në shkallën më të lartë të moralit. Muhamedi (a.s.), tërë jetën ia kushtoi këtij misioni. Ai ishte i palodhshëm në afrimin, bashkimin dhe miqësimin e njerëzve. Ai shkëlqente në dashuri, ishte i këndshëm dhe i dashur për të gjithë. Shkonte vazhdimisht në vizita, i vizitonte të sëmurët, familjet e dëshmorëve dhe sahabët e varfër, bënte humor dhe i këshillonte të rinjtë, bënte marrëveshje me të rriturit, u ofronte mbrojtje të pambrojturve dhe të shkelurve, i inspironte të gjithë njerëzit rreth vetes me besnikëri dhe siguri. Pejgamberi kultivoi miqësinë e pashembullt midis mekasve dhe medinasve (muhaxhirëve dhe ensarëve). Dhe në fund, vendosi vëllazërinë reciproke e lidhja e vetme midis tyre ishte besimi i fuqishëm në Allahun (xh.sh.).

Meqë jemi te ibadeti, e shoh të arsyeshme të theksoj për njerëzit e xhamisë se ibadetet që ata bëjnë, qoftë individualisht apo në xhemat, nuk janë qëllim në vetvete.

Ibadetet janë bërë obligim për nevojat e njerëzve e jo për nevojat e Zotit, sepse Zoti nuk ka nevojë për asgjë. Allahu (xh.sh.), nuk shpërblen drejtpërsëdrejti për ibadetet, siç mendojnë shumë njerëz gabim, por vetëm për ndikimin shpëtimtar të ibadetit në natyrën njerëzore. Mëshira e Zotit nuk fitohet me vetë ibadetin. Mëshira e Zotit fitohet vetëm nëse ai ibadet e ka arritur qëllimin e vet dhe në mënyrë të dobishme ka ndikuar në shpirtin e njeriut. Ibadetet pra, nuk janë qëllim në vetvete, por janë instrumente dhe mjete të inspirimit shpirtëror, kurajës dhe pendesës, stimulimit shpirtëror dhe disiplinës, një paralajmërim i vazhdueshëm që të mendojmë dhe të punojmë ndershëm dhe si është më mirë. Shenja e jashtme, që ibadetet e kanë arritur qëllimin e vet, është braktisja definitive e gjynahut. Njeriu në rastet më shumta dhe më të shpeshta gabon në marrëdhëniet e tij me njerëzit e tjerë. Pasqyra e vlerësimit të secilit njeri janë njerëzit e tjerë, në mesin e të cilëve ai jeton, dhe aty (në marrëdhëniet reciproke) shikohet figura morale e secilit.

Kush jeton me mëshirë dhe dashuri ndaj njerëzve, ai tashmë i është afruar edhe mëshirës së Zotit, sepse dashuria mes njerëzve është rreze e dashurisë së Zotit,

e cila shpie te burimi i vet. Mirëpo, ne e shohim që në mesin e njerëzve ka edhe anomali të tilla, që disa pak i kushtojnë rëndësi harmonizimit të drejtë të marrëdhënieve të tyre me të tjerët dhe atë pikërisht, për arsye se mendojnë që me ibadet tashmë e kanë harmonizuar raportin e tyre me Zotin (xh.sh.) dhe me këtë kanë merituar mëshirën e Tij. Jo, me të menduarit dhe vepruarit e këtillë nuk fitohet mëshira e Zotit, sepse të menduarit e tillë është larg së vërtetës, po aq sa janë ibadetet larg qëllimit të tyre.

Qëllimi i parë, qëllimi kryesor, qëllimi më i madh i ibadetit, xhamisë dhe xhematit është harmonia e plotë dhe dashuria reciproke e xhematlinjve. Gabon rëndë ai xhematli, i cili duke vepruar në mënyrë përçarëse në xhemat, punon kundër atij qëllimi të lartë. Një fatkeq i tillë dhe një mistrec moral nuk është në gjendje që egoizmin e vet të ulët t'ia nënshtrojë altruizmit të lartë, sepse e mbyll zemrën dhe shpirtin e vet para ndikimit rilindës dhe inspirues të namazit dhe ibadetit. Duke iu përgjigjur thirrjes së muezinit dhe duke qëndruar pas imamit, shkojmë në namaz që Allahut të lartësuar t'i japim zotimin solemn se do t'ju përmbahemi fuqishëm të gjitha parimeve dhe udhëzimeve që i marrim në xhemat dhe xhami. Do të ishte guxim i madh dhe paturpësi që dikush me veprimet e tij të panjerëzishme dhe përçarëse në xhemat të shkelë mbi ato premtime dhe zotime të shenjta.

Xhemati nuk është çështje private e individit; xhemati është e mirë e të gjithëve. Askush nuk ka të drejtë të identifikojë xhematin me vetveten, por secili ka të drejtë veten e tij ta identifikojë me xhematin, në kuptimin e njëjtësisë së tij, d.m.th. të dinjitetit të tij në besimin e bashkësisë së vet apo popullit të cilit i takon.

Prandaj, ne si diasporë që është një dukuri jonatyrore e një populli, mund t'i lehtësojmë vështirësitë tona, nëse pranojmë tri vlera:

- vlerën e besimit në Zotin, si çështje e lirisë personale,

- vlerën e familjes, si çështje e vetëdijes së lartë shpirtërore,

- vlerën e xhematit, si çështje e pjekurisë së thellë kolektive.

PËRMBYLLJE

Islami na mëson se bota është krijuar për të gjithë njerëzit. Mëshira e Allahut i ka ofruar të gjitha të mirat e dynjasë tërë llojit njerëzor. Mu'mini nuk është egoist, nuk është vetjak. Zemra e tij është e madhe dhe në mirësinë e vet përfshin gjithçka që është e mirë dhe fisnike. Mu'mini nuk guxon të jetë vetjak. Nuk guxon të jetojë vetëm për vete. Kjo nuk është fisnike. Gjithmonë duhet të jesh vëlla dhe shok- vëlla dhe shok i njeriut të mirë. Dora jonë gjithmonë duhet të jetë e shtrirë për njeriun e mirë dhe me qëllime të mira. Kur gëzo-

het vëllai, gëzohemi edhe ne. Kur hidhërohet, duhet të marrim pjesë në hidhërimin e tij, duhet ta ndihmojmë dhe ta ngushëllojmë. Ky është obligim i vërtetë. Duhet t'i ofrojmë ndihmë, kur ka nevojë. Nganjëherë edhe vetëm fjala e mirë dhe e ngrohtë ia kthen fuqinë dhe vetëbesimin. Prandaj, sa të mjerë janë ata njerëz që mendojnë se e gjithë kjo që është krijuar rreth tyre është krijuar vetëm për ta.

Si nuk e sheh njeriu se e pret vdekja, vdekja e sigurt dhe se një ditë do të gjendet në tabut i verdhë si dylli? Si nuk mendon se në këtë botë është për një kohë të shkurtër...

Gjithmonë duhet ta kemi parasysh që harmonia dhe uniteti në xhemat është farz për çdo mysliman e myslimane, në mënyrë të veçantë në diasporën tonë shqiptare, sepse ai është kushti më i rëndësishëm që të jetojmë në lirinë e kohës dhe hapësirës sonë.

Nga shumë ajete të Kuranit dhe hadithe të Pejgamberit (a.s.), lidhur me temën në fjalë, mufessiret me ixhtihadin e lejuar kanë konkluduar që myslimanët, për ta realizuar unitetin e tyre, pasi t'i jenë dorëzuar vullnetit të Krijuesit të tyre dhe pejgamberit Muhamedit (a.s.), duhet t'u nënshtrohen atyre, të cilët i kanë zgjedhur në mënyrë të rregullt dhe legale si udhëheqës për veten e tyre.

Ata, udhëheqësit e tillë në jetën e tyre publike, janë halife apo trashëgimtarë të Pejgamberit të Allahut, por nuk janë njerëz të shenjtë, të paprekshëm, hije të Zotit në tokë etj.

"O ju që besuat, binduni Allahut, respektoni të Dërguarin dhe përgjegjësit tuaj. Nëse nuk pajtoheni për ndonjë çështje, atëherë parashtrojeni atë te Allahu (te libri i Tij) dhe te i Dërguari, po qe se i besoni Allahut dhe Ditës së Fundit. Kjo është më e dobishmja dhe përfundimi më i mirë." (Nisa, 59)

Në lidhje me këtë, Pejgamberi (a.s.), ka thënë:

"Myslimani është i obliguar të dëgjojë dhe të bindet, pavarësisht se e do një gjë apo e urren atë, gjithnjë derisa të mos urdhërohet të bëjë diçka që e shpie në gjynah, atëherë nuk ka as dëgjueshmëri as bindshmëri." (Buhariu dhe Muslimi nga Ibn Umeri)

"Obligimi juaj është të qëndroni me bashkësinë e bashkuar dhe me shumicën!" (Ahmet ibn Hanbeli nga Muadh ibn Xhebeli)

"Dora e Allahut është mbi xhematin (bashkësinë); e kush ndahet prej xhematit, është ndarë për në xhehem!" (Et-Termidhiu prej Abdullah ibn Umerit)

Pikërisht për arsyet për të cilat po flasim, namazi i përbashkët me xhemat ka vlerën e 27 namazeve individuale. Gati secili akt, element i namazit me xhemat i shërben dashurisë dhe unitetit vëllazëror. Nuk mund të imagjinohet ndonjë grindje a konflikt midis atyre të cilët falen bashkërisht në xhemat, të cilët, me të

gjitha pjesët e namazit: duke u lidhur pas imamit, duke u kthyer të gjithë drejt një kibleje dhe orientimi drejt Qabesë, duke rënë në ruku e në sexhde, shkurt me të gjitha veprimet e tyre në namazin me xhemat, i japin besën Zotit (xh.sh.) dhe zotohen se do të jenë robër të dashur të Allahut (xh.sh.). Do të ruajnë dhe mbrojnë nderin dhe dinjitetin e njëri-tjetrit, si nën kupolën e xhamisë, ashtu edhe nën kupolën qiellore jashtë faltores. Nëse ndodh e kundërta e kësaj, atëherë, xhamia do të jetë jashtë funksionit të saj, nuk do ta luajë rolin për të cilin është ndërtuar. Prandaj, po ju them se nuk është vështirë të ndërtojmë xhami, por është vështirë të ndërtojmë xhemat dhe njeri me plot kuptimin e këtyre fjalëve.

Falësi i namazit është roje e fytyrës së tjetrit, sepse në namaz e përsërit sa herë: *Es-selamu alejna ve ala ibadihis-salihin*. Me këtë garantojmë sigurinë e tjetrit, në kuptimin që nuk e përgojmë, nuk e shpifim (iftira), nuk ia uzurpojmë pasurinë, nuk e ofendojmë, nuk e poshtërojmë. Por, edhe nëse ndodhin raste të tilla, sepse jemi genie njerëzore, atëherë duhet të kërkojmë falje dhe t'i falim njëri-tjetrit gabimin e bërë në momentet e dobësisë njerëzore. Ja një rast i tillë nga jeta e sahabëve të Pejgamberit (a.s.).

Ebu Dherre (r.a.), me një rast i tha Bilal ibn Rebahut (r.a.), që është djali i zi i skllaves, në lidhje me këtë Bilali (r.a.), u ankua te Pejgamberi (a.s.), i cili e qortoi Ebu Dherren dhe i tha: *"Me të vërtetë, te ti ekzistojnë gjurmë të xhahilijetit."* Pas qortimit nga ana e Pejgamberit të Allahut (a.s.), Ebu Dherri shkoi te Bilali (r.a.), i doli përpara dhe e shtriu fytyrën e tij për tokë, duke thënë: *"Pasha Allahun, nuk do ta çoj kryet nga toka, derisa nuk shkel, o Bilal, me këmbën tënde mbi fytyrën time, sepse këmba jote është me e vlefshme se fytyra ime."* Nga këto fjalë Bilali nisi të qante dhe i tha: *"Pasha Allahun nuk do ta bëj këtë. Ne jemi vëllezër dhe unë të dua ty në emër të Allahut dhe ta fal ofendimin që më ke bërë."*

Ky është një shembull, nga i cili ne duhet të marrim mësim në marrëdhëniet tona me të tjerët. A ka kënaqësi më të madhe shpirtërore se kur dëgjon shembuj të tillë të akteve të larta të njerëzishmërisë dhe humanitetit, që aq shumë na mungojnë në ditët tona. Pikërisht janë këta njerëz me Resulullahun në krye, të cilët bënë bashkësinë unike të vëllezërve të shpirtit dhe të besimit, të cilët edhe Allahu (xh.sh.), i quajti si gjenerata më e mirë e parë ndonjëherë në historinë e njerëzimit.

Dhe së fundi Islami, si fe universale, me mësimin e vet, dispozitat dhe institucionet e veta, synon për qëllimin dhe idealin më të lartë – të ndërtojë njeriun e kompletuar pa urrejtje, mendjemadhësi dhe egoizëm, i cili në dritën e dashurisë së Zotit do t'i dojë të gjitha krijesat e Tij, e do të urrente vetëm urrejtjen dhe të keqen.

"O ju, që besoni! Ruani veten dhe familjet tuaja nga zjarri, lënda djegëse e të cilit janë njerëzit dhe gurët..."

(Tahrim, 6)

Interneti është bërë pjesë e pandashme e jetës sonë. Interneti ka hyrë në të gjitha fushat e jetës duke filluar nga tregtia, informacioni, argëtimi etj. Të gjithë përfitojnë nga interneti. Po thuajse në çdo shtëpi ka internet. Kjo ka bërë që informacioni të qarkullojë në kohë reale, pa asnjë pengesë nga një skaj i botës në skajin tjetër.

Bota virtuale e internetit është si një treg pafund ku çdo individ dhe shoqëri nxjerr në treg kulturën dhe stilin e vet të jetesës. Fatkeqësisht, në këtë treg ta madh krahas produkteve të dobishme tregtohen edhe produkte të dëmshme për njeriun. Këto produkte të dëmshme kanë hyrë në të gjitha shtëpitë tona duke hapur plagë të rënda në jetën, nderin, sjelljen dhe botën tonë shpirtërore.

Shoqëria e ndikuar nga interneti po pëson një traumë sociale dhe kulturore. Nën ndikimin e internetit po ndryshojnë vlerat morale, tradita dhe ndjeshmëria jonë. Interneti ka sjellë dobësimin në masë të lidhjeve dhe komunikimit njerëzor.

Interneti e ka zgjeruar ndikimin e tij edhe në familje, sot gjithnjë e më shumë po flitet për martesat përmes internetit.

Përmes internetit po realizohen një sërë mashtrimesh, vjedhjesh, kërcënimesh, lëndimesh, gënjeshtresh dhe shpifjesh.

Në mënyrë të veçantë imazhet erotike po ndikojnë në mënyrë negative mbi rininë. Kjo po ndikon jashtë mase në degjenerimin moral të rinisë, e cila është e ardhmja e kombit.

Bombardimi me shfaqje dhe imazhe erotike i fëmijëve sjell pasojë serioze në sjelljet dhe zhvillimin e tyre psikologjik. Kjo mund të sjellë pasojë të pariparueshme në të ardhmen e tyre.

Siç dihet, një nga qëllimet e fesë është edhe ruajtja e shëndetit mendor dhe shpirtëror të njeriut. Kurse sot shëndeti mendor dhe shpirtëror është më i rrezikuar se kurrë.

Përdorimi pa kriter i internetit i largon ata nga jeta sociale. Gjithnjë e më shumë po flitet për varësinë ndaj internetit. Varësia ndaj internetit nuk është e kufizuar vetëm me fëmijët, por edhe të rriturit janë bërë të varur prej tij.

Varësia ndaj internetit është e njëjtë me varësinë ndaj alkoolit dhe drogës. Sipas psikiatërve varësia ndaj internetit e dëmton trurin po aq sa varësia ndaj alkoolit dhe drogës.

Një nga qëllimet e edukimit islam është zhvillimi i aftësive komunikuese midis njerëzve, thënë edukimin e individëve të aftë për të krijuar marrëdhënie dhe komunikim midis njeri-tjetrit. Kurse interneti krijon një botë me qendër internetin. Kjo sjellë tëhuajzimin e njeriut me njerëzit e tjerë. Një person që e kalon pjesën më të madhe të kohës përballë kompjuterit nuk mund të krijojë komunikim dhe marrëdhënie sociale me njerëz të tjerë.

Feja synon krijimin e marrëdhënieve të shëndosha sociale, gjë të cilën varësia ndaj internetit e dëmton rëndë, sepse ajo krijon njerëz asocialë. Nga ana tjetër, feja synon mëshirën kundrejt dhunës dhe bashkëpunimin kundrejt egoizmit, por fatkeqësisht lojërat e ndryshme kompjuterike po nxisin dhunën, egoizmin, urrejtjen dhe gjakderdhjen.

Sot përmes internetit dhe televizionit është bërë e mundur arritja e çdo informacioni. Por në të njëjtën kohë po flitet gjithnjë e më shumë për ndotjen e informacionit. Ky lloj informacioni sjell një gjendje kaotike në mendjen e njeriut.

Në traditën islame dituria ndodhet në shkallën më të lartë të hierarkisë së vlerave. Por cila dituri është e vlefshme për njeriun? Sepse Pejgamberi (a.s.), na ka mësuar të kërkojmë mbrojtje prej Allahut nga dituria e padobishme. (Tirmidhi, Deavat, 68) Dituri e dobishme është ajo që kontribuon në jetën tonë shpirtërore dhe materiale.

Ebu Musa Esh'arij (r.a.) transmeton se
Pejgamberi -salallahu alejhi ve selem-, ka thënë:

"Shoku i mirë ngjan me tregtarin e aromave të këndshme. Prej tij mund të blihet parfum, mund të të vijë dhuratë një parfum ose tekefundit, mund të të vijë era e parfumit. Kurse shoku i keq është si farkëtari, qëndrimi pranë të cilit ose të djeg rrobat, ose të mbyt nga era e keqe." (Muslim, Birr, 146)

Krijimi dhe ruajta e miqësisë është dëshirë e çdo njeriu. Një shok i sinqertë dhe besnik është i nevojshëm po aq sa prindërit, vëllai apo bashkëshortja. Një shok me të cilin mund të ndajë gëzimet dhe hidhërimet në këtë botë. Ka shumë raste, çështje të cilat nuk i ndan dot me familjen i ndan shumë lehtë me shokun. Por gjetja e një shoku të mirë nuk është gjithmonë e lehtë. Zgjedhja e shokut është një zgjedhje shumë e rëndësishme në jetë, sepse ajo ndikon në jetën tonë në këtë botë dhe botën tjetër. Pejgamberi (a.s.), për të treguar rëndësinë e zgjedhjes së shoqërisë bën një krahasim të tillë: "Shoku i mirë ngjan me tregtarin e aromave të këndshme. Prej tij mund të blihet parfum, mund të të vijë dhuratë një parfum ose tekefundit, mund të të vijë era e parfumit. Kurse shoku i keq është si farkëtari qëndrimi pranë të cilit ose të djeg teshat ose të mbyt nga era e keqe."

Sipas hadithit, shok i mirë është ai që është shembull me moralin, edukatën, diturinë, devotshmërinë, dobinë dhe kontributin që ka shoqëria prej tij. Një person i tillë, sipas hadithit, i ngjason një personi i cili tregton misk dhe më së paku lëshon aromë të mirë përreth. Kurse shoku i keq ndikon negativisht me sjelljet e tij të ulëta mbi tjetrin, por edhe mbi gjithë shoqërinë. Shoku i keq mund të bëhet shkak për veprime që do t'i vuajsh në këtë botë dhe botën tjetër. Për të theksuar rëndësinë e ndikimit të shokut Pejgamberi (a.s.), në një hadith tjetër thotë: "Njeriu është në fenë e shokut të tij, prandaj kini kujdes në zgjedhjen e shokut tuaj." (Ebu Davud, Edeb, 16.)

Rëndësinë e zgjedhjes së shokut e trajton edhe Kurani në mënyrë më të detajuar. Ka shumë ajete që flasin për miqësinë e Allahut me njerëzit e mirë, miqësinë e shejtanit me të këqinjët dhe miqësinë e njerëzve të mirë me njerëzit e këqinj. Allahu kërkon në Kuran që besimtarët të jenë miq dhe shokë me njerëzit e devotshëm, të mirë dhe besnikë dhe ndalon krijimin e miqësisë me njerëzit e këqinj.

Allahu, në ajetin Kuranor: "Atë Ditë miqtë do të bëhen armiq të njëri-tjetrit, përveç të drejtëve, që e kanë pasur frikë Allahun." (Zuhruf, 67), vë në dukje ndikimin që ka shoku në Ditën e Gjykimit. Një shok i mirë mund të jetë shkak për lumturinë tënde në botën tjetër dhe një shok i keq mund të jetë shkak për mjerimin tënd në botën tjetër.

Përhapja e veseve të tjera të këqija, si alkooli, droga dhe kumari është e lidhur ngushtë me ndikimin e rrethit shoqëror. Prandaj zgjedhja e shokut është shumë e rëndësishme, për më tepër në kohën tonë, ku komunikimi ka marrë përmasat e një zhvillimi marramendës duke bërë të mundur edhe krijimin e shoqërive virtuale.

Në ditët e sotme, kur interesat materiale janë parësore koncepti i shokut dhe mikut po ndryshon në mënyrë të vazhdueshme dhe të shpejtë. Në zgjedhjen e shokut nuk po merren parasysh cilësitë morale dhe shpirtërore, ato gjithnjë e më tepër po anashkalohe. Prandaj është shumë e rëndësishme të reflektojmë mbi këtë hadith profetik, i cili e shpreh shumë bukur dhe qartë ndikimin e shoqërisë.

Mësimet që nxjerrim nga hadithi:

1. Nxitja për t'u shoqëruar me njerëz të mirë.
2. Njeriu ndikohet nga shoku me të cilin shoqërohet.
3. Qëndrimi larg prej shoqërisë së keqe.



TA BËSH SHPIRTIN FOLE MËSHIRE

Njeriu që është larg urtësive dhe të vërtetave të Islamit, valëvitet midis shpirtërores dhe materiales, si pasojë e ndryshimit të vazhdueshëm të kushteve në sprovat e jetës së kësaj bote. Ai i ngjan një anijeje me timon të thyer, e cila ndodhet në një oqean të errët me furtunë dhe vorbullla. Prej se e ka humbur orientimin shpirtëror, për të cilin ka nevojë shpirti i tij, ndodhet në një gjendje ku nuk e di se në cilën vorbull të nefsit do të shkatërrohet.

Njeriu, i cili lëviz nëpër korridorët tepër të ngatërruara të jetës, e ka të pamundur që vetëm me mendjen e tij të dobët të gjejë rrugën e duhur, që të mos humbë ndjenjën e devotshmërisë dhe nderit, që të mos shkatërrojë lumturinë e përjetshme dhe që të kuptojë mirësinë dhe butësinë e Islamit. Në rrugëtimin drejt përjetësisë, ai ka nevojë të madhe për udhëzimin dhe nënshtrimin ndaj ligjeve hyjnore.

Që të mund të jetojnë, gjallesat janë të detyruara të ushqehen. Po kështu edhe njeriu që të qëndrojë gjithmonë në rrugën e drejtë, duhet që jeta e tij të jetë në ekuilibër mes materiales dhe shpirtërores. Ai duhet të ushqejë mendjen dhe zemrën e tij me nurin e Kuranit dhe Sunetit,

pra me një fjalë, t'i nënshtrohet edukimit hyjnor.

DASHURIA DHE BINDJA

Në një hadith fisnik thuhet:

"Njeriu është bashkë me atë që do." (Buhari, Edeb, 96.)

Dashuria ndaj të Dërguarit të Allahut (a.s.), kërkon bindje dhe lidhje shpirtërore, sepse dashuria është si një linjë elektrike midis dy zemrave dhe intensiteti i dashurisë varet nga gjendja e kësaj lidhjeje. Kjo lidhje zemrash bëhet e mundur me thellimin e ndjenjave, duke përfituar nga morali profetik dhe duke i parë krijesat me syrin e mëshirës, ashtu siç i sheh Krijuesi i tyre.

Shpirtrat mund të marrin ushqim dhe begati shpirtërore prej të Dërguarit të Allahut (a.s.), aq sa janë të lidhur me të dhe aq sa i ngjajnë atij në moral. Dashuria për të varet nga bindja ndaj tij

dhe nga sakrifica e përpjekja që tregohet për t'i ngjarë atij. Ndërsa dashuria ndaj Allahut kërkon besim dhe bindje ndaj të Dashurit të Tij fisnik (a.s.). Në një ajet urdhërohet:

Thuaju (o Muhamed): **"Nëse ju e doni Allahun, atëherë më ndiqni mua, që Allahu t'ju dojë dhe**



t'jua falë gjynahet!.." (Al'Imran, 31)

"Ka njerëz që e flijojnë veten, për të fituar pëlqimin e Allahut..." (Bekare, 207)

Në fakt, njeriu duhet t'i bëjë të panjohurat, të njohura, duhet t'i ndriçojë shtigjet e errëta, si edhe të vëtdijësohet për të papriturat e botëve, që janë jashtë fushës së perceptimit të tij, si varri dhe jeta e përtejme. Gjithashtu, duhet t'i bindet me nënshtrim të plotë dhe dashuri të madhe Allahut Teala, i Cili do t'i falë paqe shpirtit të tij. Vetëm në këtë mënyrë robi do të arrijë pjekurinë shpirtërore, me të cilën Allahu do të jetë i kënaqur.

Në këtë pikë, rruga më e saktë për t'u ndjekur, është rruga e gjurmëve të ndritura të Profetit (a.s.), që Allahu Teala ia dhuroi të gjithë njerëzimit, si modelin e Njeriut të Përsosur.

PJEKURIA SHPIRTËRORE

Bota shpirtërore e atyre, që me besnikëri ia kanë kushtuar jetën rrugës së drejtë, shndërrohet në një det të gjerë mëshire, sepse Allahu, që është Rrahman dhe Rrahim, e ka dërguar Resulullahun (a.s.), si mëshirë për të gjithë njerëzit dhe e ka bërë atë shembull për njerëzimin, me cilësinë e kësaj mëshire.

Prandaj, ata që përfitojnë ashtu siç duhet prej moralit shpirtëror të Resulullahut (a.s.), arrijnë ta bëjnë shpirtin e tyre vend mëshire, i cili përqafton të gjitha krijesat. Ata tashmë janë liruar nga robëria e fiksimeve të nefsit dhe llogarive të interesave të tyre



**Thuaju (o Muhamed):
"Nëse ju e doni Allahun,
atëherë më ndiqni mua,
që Allahu t'ju dojë
dhe t'jua falë gjynahet!.."**

(Al'Imran, 31)

personale. Shpirtrat e tyre, duke dashur Allahun dhe Profetin (a.s.), kanë shijuar dashurinë e vërtetë. Për këtë arsye, çdo kënaqësi dhe shije e përkohshme e ka humbur ndikimin dhe rëndësinë në sytë e tyre. Tashmë, i gjithë mundi, mendimi, shqetësimi, halli dhe përpjekja i tyre është për paqen dhe lumturinë e të gjitha krijesave.

Si rezultat i edukimit hyjnor dhe profetik, ata kanë shpëtuar prej egoizmit, pra kanë ikur nga stacioni i "unit", janë bërë altruistë duke hyrë në stacionin e "bashkësisë". Ata që janë shqetësuar me shqetësimin e të tjerëve dhe janë qetësuar me qetësimin e të tjerëve, kanë arritur pjekurinë e një shpirti të butë dhe të ndjeshëm. Ata e kanë kuptuar shumë mirë se shpëtimi i tyre kalon nga përpjekja për shpëtimin e të tjerëve.

Sa bukur e shpreh ky tregim pjekurinë shpirtërore që kërkohet për takimin me Allahun:

Bejazid Bistami (Allahu e mëshiroftë), tregon:

"Në kohën tonë kishte me mijëra veli. Mirëpo, detyra e prijësit (në rrugën e drejtë) për atë shekull, i ishte besuar një hekurpunuesi me emrin Ebu Hafs. Për të mësuar më shumë rreth kësaj urtësie, shkova te dyqani i tij. Kur e pashë, vura re se ai ishte shumë i shqetësuar dhe i hidhëruar. E pyeta për arsyen e kësaj dhe ai m'u përgjigj me këto fjalë:

"Vallë, a ka dert më të madh se derti im, dhe njeri më me shumë derte se unë? Vallë, si do të jetë gjendja e umetit të Muhamedit (a.s.), në Ditën e Kiametit?"

Më pas filloi të qante dhe më bëri edhe mua të qaja. U bëra kureshtar dhe e pyeta:

“Përse të shqetëson kaq shumë fakti se njerëzit do të dënohen?”

Ebu Hafsi u përgjigj:

“Natyra ime është mburrur me mëshirë dhe dhembshuri. Nëse i gjithë dënimi që do t’u jepej njerëzve të shkujdesur do të binte mbi mua dhe ata do të faleshin, unë do të isha tepër i kënaqur prej kësaj dhe derti im do të merrte fund...”

Prej kësaj, kuptova se Ebu Hafsi nuk ishte nga ata që thoshin “unë, unë”, por duke qenë në rrugën e Profetit (a.s.), ishte nga ata që thoshin “umeti, umeti!”

Siç shihet, gjendja e trashëgimtarëve të Profetit të mëshirës (a.s.), të cilët kanë përfituar prej moralit të tij shpirtëror, reflekton ndjenjat e larta të një shpirti që është bërë fole mëshire.

I nderuari Hasan Harakani ka thënë: “Nëse në gishtin e një-rit prej vëllezërve të mi të fesë, që ndodhen midis Tur-kistanit dhe Shamit, ngulet ndonjë gjemb, është njësoj sikur ai gjemb të më ngulej në gishtin tim... Hidhërimi i zemrës së tyre, është derti im.”

I nderuari Serijji Sakati, tridhjetë vjet të jetës së tij, i kaloi duke bërë *teube* dhe duke kërkuar falje prej Allahut, sepse, për një shkujdesje të çastit nuk mendoi për fatkeqësinë që u kishte ndodhur vëllezërve të tij të fesë, por u gëzua që shpëtoi vetë. Këta dhe shembuj të tjerë prej të dashurve të Allahut, tregojnë qartë për ndjenjat e thella, që kishin këta njerëz në shpirtat e tyre.

VIRTYT MBI VIRTYT

I nderuari Rabi ishte një prej të dashurve të Allahut, i cili tregojë i butë, bujar dhe i mëshirshëm me të tjerët, duke sakrifikuar edhe veten e tij. Në kohën kur u paralizua, një i varfër i erdhi te dera dhe i kërkoi diçka. Rabi tha:

“Jepini një ëmbëlsirë!” Sepse edhe vetë i pëlqente shumë ëmbëlsirat. Kështu e kuptonte ai ajetin: **“Nuk kenë për ta arritur përkushtimin e vërtetë, derisa të ndani (lëmoshë) nga ajo (pasuri) që e doni...”** (Al’Imran, 92.)

Njëherë, kur iu shtuan shumë dhimbjet, dëshiroi të hante mish pule. Mirëpo, duke e mbajtur veten për dyzet ditë me radhë, nuk hëngri mish pule. Një ditë i tha së shoqes:

“Kam dyzet ditë që dëshiroj të ha mish pule, por po e mbaj veten duke shpresuar se mund të heq dorë edhe nga kjo dëshirë.”

E shoqja ia ktheu:

“Fesubhanallah! Shiko se prej çfarë po e mban veten! Allahu ta ka bërë hallall atë ushqim!”

Pas kësaj, e shoqja shkoi në pazar dhe bleu një pulë, të cilën e preu dhe e poqi për bukuri. Pastaj gatoi bukë dhe përgatiti një sofër me ushqime të ndryshme. Të gjitha këto i mori dhe ia çoi përpara të nderuarit Rabi. Por në atë moment, një i varfër u afrua tek dera dhe tha:

-Më jepni ndonjë gjë për hir të Allahut, që Allahu t’u japë begati!

Rabi hoqi dorë nga pula dhe i tha së shoqes:

-Merre këtë pulë dhe jepja atij!

E shoqja iu përgjigj:

-Fesubhanallah!

Rabi këmbënguli:

-Bëj atë që po të them.

Këtë herë, e shoqja re-agoi:

-Të paktën bëj diçka që do të jetë më e mirë për të.

-E çfarë të bëj?

-I japim paratë e pulës, ndërsa ti ha pulën që ke dëshiruar aq shumë!

I nderuari Rabi i tha:

-Një propozim shumë i bukur! Më sill aq para sa bën kjo pulë!

Kur e shoqja ia solli paratë, ai tha:

-Tani vendosi paratë pranë pulës dhe jepja atij nevojtarit!

E shoqja, mori paratë dhe pulën e ia çoi nevojtarit. (Bursevi, Ruhul-Bejan)

Padyshim që kjo gjendje është edhe niveli më i lartë i bujarisë, pra virtyti “ISAR”. Kjo është sakrifica e dhënies së pasurisë një vëllai të fesë, vetëm për hir të Allahut. Sa bukur shprehet Allahu Teala në lidhje

1. Të dhënit bujarisht e e asaj për të cilën ti vetë ke nevojë.

me këtë virtut të lartë:

“Ata i ushqejnë të varfrit, jetimët dhe të zënët rob, edhe pse vetë janë nevojtarë, duke thënë: ‘Ne ju ushqejmë vetëm për hir të Zotit. Për këtë, nuk duam shpërblim e as falënderim! Ne i frikësohemi Zotit tonë në një Ditë të ashpër, që do t’i bëjë fytyrat të jenë të vrenjtura.’ Por Allahu do t’i ruajë ata nga tmerret e asaj Dite e do t’u japë shkëlqim dhe gëzim”. (Insan, 8-11.)

HORIZONTI I MËSHIRËS

Ja pra, morali islam ka arritur të ndërtojë një shpirt me pjekuri të përsosur, i cili kur është nevoja, heq dorë nga nevoja e vet dhe qetësohet duke kënaqur shpirtin e një vëllai të fesë. Ata që arrijnë këtë pjekuri shpirtërore, i kanë kuptuar në mënyrën më të bukur fjalët e Profetit (a.s.), i cili ka thënë:

“Kush nuk shqetësohet për hallet e besimtarëve, nuk është prej tyre.” (Hakim, Mustedrek, IV, 352; Hejthem, Mexhmau’z-Zeuaid, I, 87.)

“Kush shtrihet i ngopur, ndërkohë që komshiu i tij është i uritur, nuk është prej nesh.” (Hakim, II, 15/2166a.)

Pra, ata e kanë kuptuar shumë mirë se janë përgjegjës për çdo gjë, të cilën duart e tyre mund ta arrijnë. Gjithashtu, ata kanë kuptuar se uria nuk është vetëm ajo e stomakut, por edhe ajo e shpirtit njerëzor, e cila bëhet shkas për sëmundje edhe më të rrezikshme.

Personaliteti i pashoq dhe shembullor, Profeti Muhamed Mustafai (a.s.), një ditë u tha shokëve:

“Betohem në Allahun, në dorën e plotfuqishme të të Cilit ndodhet shpirti im, se nëse nuk mëshironi njëri-tjetrin, nuk do të hyni në xhenet.”

Sahabët e nderuar thanë:

-O Resulallah! Ne të gjithë jemi të mëshirshëm.

I Dërguari i Allahut (a.s.), thotë:



“Mëshira (për të cilën po flas), nuk është vetëm ajo që duhet të keni ndaj njëri-tjetrit, siç e kuptoni ju, por mëshira e cila përfshin të gjitha krijesat, po të gjitha krijesat!..” (Hakim, IV, 185/7310.)

Pra, mëshira dhe dhembshuria e Profetit (a.s.), kishte cilësinë që përfshinte të gjitha krijesat, sepse shpirti i tij i bekuar, i shihte krijesat ashtu siç i sheh Krijuesi i tyre.

Kjo është arsyeja që ai edhe armikun e tij e shihte me sy mëshire. Në luftën e Bedrit, kur dy ushtritë u vendosën përballë njëra-tjetrës, Resulallahu (a.s.), u dërgoi mushrikëve përfaqësuesit e tij, që të merreshin vesh pa luftë. Në atë çast, disa mushrikë, në mesin e të cilëve gjendej edhe Hakim bin Hizami, erdhën të pinin ujë tek pusi i myslimanëve. Myslimanët deshën t’i pengonin, por i Dërguari i Allahut (a.s.), tha:

“Lërinin të pinë!”

Ata erdhën, pinë ujë dhe më vonë, përveç Hakimit, të gjithë mushrikët e tjerë nxorën shpatat kundër ushtrisë islame dhe të gjithë përfunduan të vvarë. Ndërsa Hakimi, më vonë do të nderohej me udhëzimin në rrugë të drejtë. (Ibën Hisham, II, 261.)

Në vitet kur mushrikët e Mekës, të cilët i torturuan myslimanët vite me radhë, i kapi zia e bukës dhe nge lën të uritur, Profeti (a.s.), dërgoi ushqime për ta. Në këtë mënyrë, ai u tregoi atyre, të cilët njëherë e një kohë kishin vendosur embargo ndaj myslimanëve duke i lënë të vdisnin urie, botëkuptimin e moralit të lartë që zotëron Islami.

Profeti (a.s.), sa herë që i jepej rasti, i këshillonte njerëzit të tregonin mëshirë ndaj krijesave për hatër të Krijuesit, dhembshuri, delikatesë dhe veçanërisht për të pasur kujdes që të mos thyenin askujt zemrën. Në sajë të këtyre këshillave,

zbuteshin zemrat, delikatesa dhe butësia arrinin majat më të larta dhe ndërtohej një pjekuri shpirtërore, e cila do të përfaqësonte bukuritë e Islamit.

Resulallahu (a.s.), ka dhënë shumë këshilla edhe në lidhje me mirëmbajtjen dhe pastrimin e kafshëve. Veçanërisht, ka kërkuar që delet dhe dhitë të pastroheshin mirë nga papastërtitë dhe dheu. (Hejthemi, IV, 66-67.)

Ai na ka urdhëruar, që edhe kur vrasim ndonjë gjarpër ose ndonjë kafshë të rrezikshme, ta bëjmë me një të rënë dhe pa e torturuar.

Një prej sahabëve, Ebu Derda (r.a.), kishte parë disa njerëz që i ngarkonin shumë devetë e tyre, aq sa ato nuk mund të ngriheshin në këmbë prej ngarkesës së rëndë. Ebu Derda (r.a.), pasi ia hoqi ngarkesën e tepërt, e ngriti njerën nga devetë në këmbë dhe, duke iu drejtuar të zotit të kafshës, tha:

“Nëse Allahu Teala do t’ju falë për këtë keqtrajtım që u bëni kafshëve, do të tregohet shumë falës ndaj jush. E kam dëgjuar Resulallahun (a.s.), të thotë:

“Allahu Teala ju urdhëron të silleni mirë me kafshët, sepse ato nuk mund të flasin! Nëse kaloni në ndonjë tokë pjellore, lejojini kafshët të kullosin! Nëse kaloni në ndonjë tokë të shkretë, ecni shpejt...” (Ibën Haxher, Metalibu’l-’Alije, II, 226/1978.)

Njëherë, Resulallahu (a.s.), pa një njeri i cili po milte delen e tij dhe i tha:

“O filan! Kur ta mjelësh kafshën, lër qumësht edhe për të voglin e saj!” (Hejthemi, VIII, 196)

Seuade bin Rebi (r.a.), na transmeton këtë shebull të mëshirës dhe delikatesës së pashoqe:

“Shkova tek Profeti (a.s.), dhe kërkoja diçka prej tij. Ai urdhëroi që të më jepeshin disa deve. Pastaj më këshilloi me këto fjalë:

“Kur të shkosh në shtëpi, thuaji familjes t’i mirëmbajë kafshët dhe t’u japë ushqim të bollshëm! Urdhëroje atë që t’ua lëmojë thundrat dhe, kur t’i mjelë, të mos i dëmtojë e t’u shkaktojë plagë!” (Ahmed, III, 484; Hejthemi, V, 168, 259, VIII, 196.)

Njëherë tjetër, kur Profeti (a.s.), ishte duke udhëtuar për në Mekë bashkë me sahabët, panë një gaze-

lë që po flinte në rrugë. Profeti (a.s.), që ishte dërguar mëshirë për botët, urdhëroi njerin prej sahabëve të qëndronte pranë gazelës derisa të kalonin të gjithë, me qëllim që kafsha të mos trembej. (Muvatta, Haxh, 79; Nesai, Haxh, 78.)

Kur po shkonin për të çliruar Mekën me një ushtri prej dhjetë mijë vetash, në rrugë vuri re një qen, i cili ishte shtrirë dhe po u jepte gjë këlyshëve të vet. Profeti (a.s.), caktoi Xhuajl bin Surakan (r.a.) rojë pranë qenit dhe këlyshëve të tij dhe e porositi atë të kujdesej për të. (Uakidi, II, 804.)

Njëherë, Profeti (a.s.), pa një fole milingonash së cilës i ishte vënë zjarri. Ai u pezmatua nga një gjë të tillë. Foleja e djegur e milingonave ia kishte hidhëruar aq shumë zemrën e tij të ndjeshme, prandaj dhe me hidhërim të madh tha:

“Kush e ka djegur këtë fole? Dënimin me zjarr, i takon ta japë vetëm Zoti i zjarrit.” (shih. Ebu Daud, Xhihad 112/2675, Edeb 163-164/5268.)

Njëherë tjetër, Profeti ynë (a.s.), pa një beduin, i cili kishte marrë një shkop dhe u binte degëve të një peme, duke u përpjekur të shkundte gjethet e saj për kafshët e tij. Pastaj u tha atyre që kishte pranë:

“Ma sillni këtu atë beduin, por silluni butë dhe mos e trembni!”

Kur beduini i erdhi pranë, Profeti (a.s.), me delikatesë të madhe i tha:

“O beduin! Gjethet shkundi me kujdes e butësi dhe jo duke gjuajtur e thyer degët!” (Ibnu’l-Esir, Usdu’l-Gabe, Bejrut 1417, VI, 378.)

Profeti ynë (a.s.), zemra e të cilit nuk duronte dot as thyerjen pa arsye të një dege të njomë, sa herë që i jepej rasti, e ftonte umetin e tij të sillej me delikatesë, butësi dhe mëshirë ndaj çdo gjëje. Në një hadith, Profeti (a.s.), në lidhje me mirëmbajtjen e bimëve, thotë:

“Nuk ka asnjë bimë, e cila ka mbirë në tokë dhe të mos ketë një melek që e ruan me krahët e tij. Kjo vazhdon deri sa të vijë koha e korrjes së asaj bime. Atë që e shkel dhe prish atë bimë, ai melek do ta mallkojë.” (Ali Muttaki, Kenz, III, 905/9122.)

MOS I BËJ KEQ AS MILINGONËSI..

Në sajë të begatisë së moralit profetik, që ishte shembulli më i mirë i zemrave të besimtarëve, u edukuan njerëz me ndjenja të thella, të cilët nuk këpusnin as edhe një lule, e nuk u bënin keq as milingonave...

Kjo ngjarje që vijon më poshtë, është një nga shembujt më të përsosur të mëshirës:

Sulltani Kanuni Sulejman, me një bejte, kërkoi fetva prej Shejhu'l Islamit Ebu Suud Efeنديut, që të vriste milingonat që kishin tharë pemët e darthave të kopshtit të sarajit:

Nëse milingonat dëmtojnë të mbjellat,

A lejohet t'i vras, çfarë thotë feja?

Kërkesës për fetva të sulltanit, Ebu Suud Efeنديu i përgjigjet me një bejte tjetër:

Nesër, kur para Hakut të dalë,

Prej Sulejmanit, milingona hakun do ta marrë!

Zemrat e besimtarëve të përsosur janë mbrytur me një edukatë aq të lartë shpirtërore, saqë nuk mund t'i bëjnë keq as edhe një milingone. Në sajë të butësisë dhe mëshirës së tyre të gjerë, ata i gjallërojnë dhe i gjelbërojnë bahçet e zemrave.

PËR HATËR TË KRIJESIT

Njëri nga të dashurit e Allahut, Ahmed er-Rufai, ishte shumë i mëshirshëm ndaj kafshëve. Një qen ishte sëmurë me zgjebe dhe kushdo që e shihte neveritej prej tij. Ai dëbohej nga çdo derë në të cilën shkonte, derisa arriti te dera e Ahmed er-Rufaiut. Ishte i rraskapitur dhe i mbushur me plagë. Kur e pa gjendjen e kafshës, e mori qenin dhe e çoi në një vend jashtë qytetit. I bëri një vend me hije dhe filloi ta kuronte. E pastroi mirë e mirë, ia leu plagët me melhem dhe pastaj e ushqeu.

Pas dyzet ditësh kurim, shëndeti i qenit u përmirë-

sua dhe nuk i ngeli asnjë shenjë prej sëmundjes së zgjebes. Pastaj e lau mirë e mirë dhe e çoi në qytet. Kur arriti në qytet, ata që e panë, e pyetën:

-Zotëri! U kujdesët jashtë mase për këtë qen. A mund ta dimë urtësinë dhe arsyen?

Ahmed er-Rufai u përgjigj me këto fjalë:

-U frikësova se mos Ditën e Kijametit Zoti im, do të më pyesë: "Si s'të erdhi keq për atë qen? Përse nuk u mundove ta shëroje? Përse nuk mendove se edhe ti mund të sëmuresh një ditë në atë mënyrë?"

O njerëz! Mbushini zemrat tuaja me mëshirë ndaj krijesave të Allahut Teala! Kini frikë se mos Allahu ju sprovon me të njëjtat fatkeqësi si të tyre!"

Ja pra, të dashurit e Allahut, nuk cenonin askënd, nuk i hynin askujt në hak dhe nuk e zgjasnin dorën në atë që s'u takonte. Mirësitë që ata zotëronin i shihnin si amanete të Allahut dhe me një ndjenjë të thellë përgjegjësie, kanë vepruar me përpikmëri dhe delikatesë të veçantë.

Nuk duhet harruar se Allahu Teala, në çdo moment i fton besimtarët për në Daru's-Selam, pra në Xhennet. Prandaj çdo besimtar:

- Duhet të jetë gjithmonë me Allahun dhe në çdo moment të kërkojë kënaqësinë e Tij.

- Duhet ta dojë dhe t'i bindet të Dërguarit të Allahut (a.s.).

- Nuk duhet të harrojë përgjegjësinë e vëllazërisë fetare.

- Duhet që çdo krijesë ta shohë me syrin e mëshirës.

Allahu Teala bëftë që këto ndjenja të mos mungojnë kurrë në shpirtin tonë! I bëftë zemrat tona fole ku çdo krijesë gjen paqen dhe qetësinë!

Amin!..



NJERIU I LIRË I KOHËVE MODERNE

Nuredin Nazarko

Qysh në fillet e veta, botëkuptimi modern është mbështetur qartë mbi dy elemente, të cilët janë kthyer në referencë ontologjike, rilindja dhe humanizmi. Humanizmi i mëshoi fort njeriut, madje themeli mbi të cilin ngrihet është vetë njeriu. Humanizmi i njuh njeriut një pozitë tërësisht të veçantë në aureolën e të gjitha gjërave që janë dhe ekzistojnë. Humanizmi nuk është një shkollë e caktuar mendimi, apo një drejtim i caktuar filozofik, por themeli nga duhet të ngrihet pika e këndvështrimit të botës me qendër njeriun. Kësisoj humanizmi u shndërrua në përmasën e gjykimit të universit, botës, dhe statusit të njeriut në të, vetëm nën prizmin e njerëzores. Kjo mënyrë e të vështruarit të gjërave nuk është se ishte e re dhe e panjohur më herët në historinë e njerëzimit, por në kohët moderne mori një zhvillim krejtësisht të ri dhe të panjohur më parë përse i përket përmasave të shpërhapjes në atmosferën e shoqërisë njerëzore. Humanizmi, duke qenë se themeli të tijin ka njeriun dhe i njuh njeriut një status të veçantë beson se mund të ndërtojë njeriun si njeri jashtë sferës së ndikimit metafizik, prandaj qysh në agun e tij shkëputja nga tradicionalizmi do të

ishite jetësore për të. Madje në gjithë zhvillimet e mëvonshme humanizmi do të përpiqej të vendoste nën hyqëm tradicionalizmin, duke e detyruar këtë të fundit të merrej vetëm me sferën spirituale në qoshkun e vet, në mënyrë që e gjithë hapësira e lënë bosh nga tërheqja e tradicionalizmit të mbushej nga humanizmi. Humanizmi nuk ia mohon potencialitetet njeriut, madje i mbithekson shumë më tepër sesa është e nevojshme dhe jo pa arsye. Duke mbitheksuar potencialitetet e njeriut, humanizmi besonte se nëpërmjet edukimit do të ndërtohej një njeri që do të bazohej në vlera, një njeri që do të pranonte të jetonte në një shoqëri të lirë në fqinjësi me sillojin e vet, duke iu bindur të njëjtave parime, ide dhe ligje. Duke mbitheksuar potencialitetet e njeriut humanizmi besonte se nëpërmjet edukimit do të ndërtohej një njeri që jo vetëm nuk do të kishte nevojë për autoritetin përtejnjëzësor, por do ta kundërshtonte hapur dhe do të tentonte t'i atribuonte vetes të drejtën për të qenë autoritet. Rrjedhimisht, humanizmi kërkonte sendërtimin e një individi, për të cilin autoriteti i parë dhe i fundëm është po vetë ai, që do të thoshte se e drejta dhe kontrolli mbi jetën e tij apo sillojin e tij



i takonte vetëm autoritetit njerëzor dhe jo autoritetit përtejnjëzor. Dhe i gjithë rrugëtimi për të mbërritur në finalizimin e projektit natyrisht do të realizohej nën mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë të këtij autoriteti të ri humanist. Duke “e çliruar” njeriun humanist nga kufizimet e tradicionalizmit, humanizmi po mëtonte se po i kthente njeriut, dinjitetin, vlerat, potencialitetet që i ishin nëpërkëmbur nga tradicionalizmi. Por përtej këtij çlirimi humanizmi po mëtonte se po i kthente njeriut një element të rëndësishëm, po “e çlironte” nga burgosja tradicionaliste, duke i dhënë gjënë më të çmuar, lirinë. Pra, mbi të gjitha të tjerat humanizmi synonte ndërtimin e njeriut të lirë.

Por lindin pyetjet: -I lirë nga kush? I lirë nga çfarë? I lirë për çfarë?

Natyrisht që këtu nuk duhet të harrojmë edhe pyetjen mbi atë që e bën njeriun të ketë statusin njeri, pra ç'është liria? Kjo pyetje e fundit duhet shtruar me forcë dhe po me aq forcë duhet dhënë edhe kuptimi i të qenit i lirë në mënyrë që të mos korrkolepsemi me fanitje të shpjegimeve të autoritetit të njeriut humanist mbi dilemën se ç'është liria. Por, le t'i kthehemi pyetjeve që shtruan më sipër për tu qasur në terrenin ku humanizmi vendosi lirinë si epiqendër të fushës ku do të zhvillonte veprimtarinë e tij.

I LIRË NGA KUSH?

Me pretendimin se njeriu është një qenie që mbart potencialitete të caktuara dhe zotëron inteligjencë atëherë kjo qenie e pajisur me të tilla potenciale është e aftë që nëpërmjet operacioneve logjike të sigurojë atë çfarë është më e mira e mundëshme për të jetuarin e tij. Rrjedhimisht kjo qenie nuk ndjen, apo nuk ka nevojë të ndjejë nevojën për një autoritet më të lartë sesa mendja e saj, për ta drejtuar në mënyrën e të jetuarit. Kështu që me pretendimin se po i japim njeriut lirinë, humanizmi po e kalonte drejtimin e mënyrës së të jetuarit të njeriut në binarët e ndërtuar nga vetë ky i fundit. Kufizimet që i kërkoheshin njeriut nga autoriteti përtejnjëzor, për të balancuar natyrën e dyfishtë të tij, u konsideruan si pranga të robërisë që duheshin thyer. Kjo nuk ishte thjesht thyerje “prangash robërie”, por tentativë arratisje nga autoriteti përtejnjëzor, në mënyrë që çdo vendim se çfarë duhej të bënte me jetën e tij, të vendosej tashmë nga vetë autoriteti njerëzor.

I LIRË NGA ÇFARË?

Hapi i parë dhe themelor në rrugëtimin e mëpasshëm të njeriut humanist tashmë u hodh. Duke “e çliruar” veten nga lidhja me autoritetin përtejnjëzor, tashmë njeriu humanist nuk do të kishte më një sistem referimi, një busull orientimi në jetën e tij të përkohshme që do ta

udhëzonte se çfarë ishte e drejtë dhe çfarë e padrejtë, çfarë ishte e mirë dhe çfarë ishte e keqe, çfarë duhej përmbushur në mënyrën e të jetuarit dhe çfarë nuk duhej përmbushur. Largimi i autoritetit përtejnjëzor i çeli udhë pikërisht lënies dorë të lirë autoritetit njerëzor për të vendosur për mënyrën e të jetuarit, pra i çeli udhë lënies dorë të lirë njeriut për përmbushjen e dëshirave që ka njeriu në vetvete. Por dikush mund të thotë se përse duhet të shqetësohemi, kur njeriu është një qenie që tek e fundit duhet t'i plotësojë dëshirat e tij? Shqetësimi nuk lidhet thjesht dhe vetëm me faktin që njeriu duhet të plotësojë dëshirat, por lidhet me faktin që njeriu e ka të pamundur t'i rezistojë përkuljes para zjarrmisë së fortë të plotësimit të dëshirave. Kjo do të thotë se vetëm lidhja me autoritetin përtejnjëzor mund ta ndalë njeriun nga nënshtrimi ndaj zjarrmisë së dëshirave të vetvetes dhe vetëm lidhja me këtë autoritet mund ta sjellë mënyrën e të jetuarit të njeriut drejt balancës, të qenit gati dhe përgjegjshmërisë.

I LIRË PËR ÇFARË?

Pasi u hodh themeli dhe u trasua udha, tashmë njeriut humanist nuk i mbetej gjë tjetër veçse të shkelte këtë udhë. Pafuqishmëria e njeriut në përkuljen para zjarrmisë së ethshme të plotësimit të dëshirave do të manifestohej me një mijë e një forma. Tashmë njeriu humanist nuk do të shqetësohej nëse fjala e thënë dhe vepra e kryer ishte apo jo morale, nëse fjala e thënë dhe vepra e kryer ishte apo jo etike, nëse fjala e thënë dhe vepra e kryer ishte apo jo fyese, nëse fjala e thënë dhe vepra e kryer ishte apo jo e drejtë, nëse fjala e thënë dhe vepra e kryer ishte apo jo e mirë. Edhe në qoftë se njeriu humanist do t'i shqyrtonte fjalët dhe veprimet e tij duke përfshirë moralin, etikën, të drejtën, të mirën, këtë do ta kryente duke u bazuar tërësisht tek autoriteti vetjak. Pra ajo çfarë është ose jo morale, etike, fyese, e drejtë dhe e mirë do të përcaktoheshin nga vetë njeriu dhe jo nga ndonjë autoritet tjetër më i lartë sesa njeriu. Por a mund t'i vendosë njeriu fre vetvetes dhe për më tepër të artikulojë parime universale, të përbotshme dhe të mbarëkohëshme në kohën kur gjithësecilit i është ushqyer dhe injektuar bindja se është zot i fatit dhe jetës së tij? Kështu që udha që iu çel njeriut humanist ishte udha e jetesës liberale pa u përkufizuar dhe përqarkësuar nga asnjë autoritet tjetër përveç autoritetit vetjak.

Ky është njeriu i lirë i kohëve moderne, që përkulet me nderim dhe përvaajtje vetëm para altarit të vetvetes dhe zjarrmisë së përmbushjes së dëshirave, pa u vramundur për përgjegjësinë që ka mbi mënyrën sesi e jeton jetën e vet.



Ejmen A. Ismaili

Njeriu kjo qenie e preferuar e Zotit

“Ne u ofruam amanetin (obligimet) qiejve, tokës dhe maleve e ato nuk deshën ta marrin përsipër atë, u frikësuan prej tij, ndërsa njeriu e mori mbi vete...”
(Ahzab, 72)

Islami i ka kushtuar rëndësi të veçantë njeriut, për shkak se atë e konsideron si pranues të shpalljes dhe komunikimit të Allahut (xh.sh.), me gjithësinë. Si pasojë e kësaj edhe Kurani edhe hadithet e Pejgamberit (a.s.), i kanë kushtuar vend të rëndësishëm njeriut.

Perspektiva kuranore e sheh njeriun njëherësh si mëkëmbës (halif) i Allahut mbi tokë dhe shërbëtori i Tij ('abd). Këto të dyja përbëjnë natyrën themelore të njeriut. Si shërbëtor i Allahut, njeriu duhet t'i nënshtrohet Vullnetit të Allahut, të marrë prej Tij drejtim për jetën e vet dhe urdhrave se si ta zbatojë atë Vullnet në rendin e krijuar. Si mëkëmbësi i Tij, ai duhet të jetë aktiv, pikërisht pse është përfaqësuesi i Allahut në këtë botë. Ai është ura mes qiellit e tokës, instrumenti nëpërmjet të cilit realizohet dhe kristalizohet Vullneti i Allahut në këtë botë. (Sejjid Husein, Nasr)

Përmasës materiale të njeriut Allahu (xh.sh.), i ka fryrë nga shpirtit i Tij, siç e përmend edhe Kurani: **“Unë fryva në të nga Shpirti Im.”** (Hixhr, 29) Kjo gjë e bën njeriun zotërues në tokë, e bën njeriun mëkëmbës të Zotit, ndërsa krijimi i tij nga dheu, rrjedhimisht nga balta (Fatir, 11) e paraqet përmasën e të qenit të tij shërbëtor i Allahut në faqen e dheut, që domethënë, fryma e Zotit në të e bën atë të lidhur me tejlëndoren, kurse dheu, rrjedhimisht balta, me lëndoren. Nëse anojmë tepër drejt materies, atëherë nuk do të kemi kurrfarë dallimi prej kafshës dhe anasjelltas, nëse anojmë tërësisht në përmasën tejlëndore, atëherë do të pretendojmë të bëhemi si melekët.

Në të dyja rastet përballemi me humbjen e karakterit real të njeriut të krijuar dhe dhuruar nga ana e Allahut, sepse ai nuk është i krijuar vetëm për të kënaqur nevojat e tij materiale dhe as vetëm për t'u përqëndruar në përmasën metafizike dhe si pasojë, t'i neglizhojë nevojat e tij lëndore në këtë botë. Realisht njeriun e bën njeri vetëm ekuilibrimi i tyre.

Kurani ka përdorur dy terma për identifikimin e njeriut: **Besher** dhe **Insan**. Për shembull, Kurani, në lidhje me karakterin e qenies biologjike të Pejgamberit (a.s.), dhe me gjuhën e tij thotë: **“Unë jam besher (njeri) si ju.”** (Kehf, 110), ndërsa në lidhje me karakterin e bartësit të amanetit (fesë) së Zotit nga ana e njeriut thotë: **“Insani (njeriu) u krijua i ngutshëm.”** (Isra, 11) Sipas kësaj, kur përmendet fjala **besher**, Kurani flet për krijesën me dy këmbë... kurse **Insani** është qenia që nuk është e zakonshme si turma, por është enigmatike dhe që ka një definicion special. [Ali Sheriati]

Në esencë, "Insani" në 3 pika kryesore dallohet nga "besheri":

1) Insani është krijesë që ka vetëdije, në të vërtetë është krijesa e vetme që ka arritur vetë-vetëdijen;

2) Insani e ka lirinë e zgjedhjes, ai në të vërtetë ka aftësi të revoltohet kundër natyrës dhe rendit që sundon me atë, rrjedhimisht zgjedhja midis përkushtimit dhe revoltimit është gjëja më madhështore që ia jep vlerën Insanit;

3) Insani është e vetmja gjallesë që mundet të riprohohet, prej një gjëje të vogël deri në atë më të madhe.

Kurse "besheri" është qenia që i përmban karakteristikat biologjike e psikologjike, të cilat i kanë të gjithë njerëzit, pa bërë asnjë dallim; të bardhë, të zinj, kinezë, evropianë, arabë, religjiozë apo joreligjiozë. Zgjedhja i ka mbetur individit, a do të zgjedhim të bëhemi "insan" apo do të pajtohemi të ngelim vetëm si "besheri"!

Vula e pejgamberëve, Muhamedi (a.s.), në Hutben e Lamtumirës e ka thënë fjalën e fundit për njeriun, me aq elokucencë dhe qartësi: *"Njeriu është vepër madhështore e Allahut dhe mjerë ai që e nënçmon nderin dhe dinjitetin e veprës së Allahut."* Ky citat na tregon se njeriu, edhe pse e ka dimensionin imanent, është vepra më madhështore e Allahut, pasi ai e ka pranuar amanetin që as qiejt, as tokat as malet nuk mundnin ta mbanin dhe prej të cilit u frikësuan me të madhe.

Pikërisht për këtë, themi që Islami është fe adekuate për njeriun, pasi i ngërthen të dy dimensionet, edhe botën lëndore, edhe atë tej-lëndore, si dhe çfarë është më e rëndësishmja, vendos ekuilibrin midis tyre.

Hebraizmi karakterizohet me teprim dhe përqendrim esencial në përmasën lëndore, duke e shpërfillur shpirtëroren, kurse krishterimi, në ide, është përqendruar në asketizmin dhe e ka neglizhuar lëndoren, edhe pse në realitet këta të fundit nuk janë sjellë sipas kësaj ideje. Ndërsa, Islami ka vendosur barazpeshën mes tejbotsmërisë dhe përbotshmërisë.

Në fenë islame njeriu nuk është i nënçmuar dhe i përbuzur nga Zoti, pasi ai është i përkushtuari, i besuari dhe mëkëmbësi i Tij në tokë. Zoti ia mësoi konceptet njeriut dhe të gjithë melekët u përlulën para tij.

Si rrjedhojë, një qenie e tillë dydimensionale ka nevojë për një religjion, që mund ta mbrojë atë nga animi (i tepërt) kah asketizmi ose kah përbotshmëria, e ta mbajë vazhdimisht në ekuilibër. Vetëm një religjion dydimensional është në gjendje ta paraqesë realitetin dhe konceptin e vërtetë të përgjegjësisë së madhe të njeriut. [Ali Sheriat] Duke llogaritur në këtë lidhje të fortë të njeriut me botën materiale, pjesë përbërëse e së cilës është edhe ai vetë, Islami as që mundohet ta ndajë njeriun nga ajo; qëllimi i tij kryesor nuk është

ta dematerializojë dhe ta bëjë njeriun melek. Përkundrazi, ai duhet të mbetet brenda kufijve të natyrës së vet dhe si i tillë, t'i përkushtohet me tërë qenien e tij Fuqisë krijuese.

Islami me të gjitha dispozitat e veta tenton që ta vërë dhe ta mbajë barazpeshën ndërmjet komponentes shpirtërore dhe asaj materiale, ndërmjet materies dhe shpirtit në kuadër të gjenit shoqëror dhe individual të njeriut. [Husein Gjozo]

Po ashtu, Islami kërkon prej njeriut që të jetë i lidhur me shoqërinë, pasi që veprimtaria shoqërore e njeriut është arsyeja kryesore që njeriu ia mundëson ta bartë në dukje përmasën e frymës hjynore dhe etikës njerëzore në fushë të veprimit. Pjesa më e madhe e sureve të Kuranit e diskuton njeriun nga aspekti i veprimit të tij shoqëror, porositë konstituive të Pejgamberit (a.s.), pandërprerë e theksojnë veçanërisht veprimtarinë shoqërore të njeriut, madje edhe pjesa dërmuese e filozofëve dhe mendimtarëve në historinë e njerëzimit e kanë definuar njeriun si qenie shoqërore, si për shembull Aristoteli (e konsideron njeriun si zoon politikon).

Gjithashtu, një prej arsyeve kryesore e dërgimit të pejgamberëve është krijimi i kushteve për bashkëjetesë të njerëzve dhe si pasojë e saj edhe ndryshimi dhe zhvillimi shoqëror.

Diskursi kuranor, siç thotë Tabatabai, njeriun e paraqet si më poshtë: "...në kohët e hershme, njerëzit jetonin thjesht, ndaj ishin liruar nga dallimet. Më vonë, duke shpënë drejt kundërshtimeve, dallimet u bënë të dukshme. Perëndia i caktoi pejgamberët dhe ua dërgoi librat e shenjtë me qëllim që t'i heqin dallimet dhe t'i sjellin njerëzit prapë në një shoqëri të bashkuar, e cila do të sigurohej nga ligjet e pejgamberëve." [Tabatabai]

Islami kërkon prej njerëzve që, duke zhvilluar ndjenjën e personalitetit, të ndihen anëtarë të bashkësisë së cilës i takojnë. Kjo shihet në të gjitha normat fetare dhe jetësore të tij. Falja e namazit në përgjithësi preferohet në trajtë kolektive. Haxhi është nga shembujt më konkretë të ibadetit të përbashkët, meqë myslimanët e mbarë botës takohen në një vend të përbashkët për ta kryer atë. Aspekti kolektiv i agjërimit qëndron në faktin se ai mbahet në të njëjtën kohë për të gjithë myslimanët e botës. Obligimi për dhënie të zekatit, si rrjedhojë e të cilit do të plotësoheshin nevojat e shoqërisë, nevoja për një halif, i cili do t'i bashkonte në një vend ndjenjat e myslimanëve, madje edhe nëse mendohet në trajtë të ndryshme nga e kaluara, do të thotë të gjitha këta çojnë në një qëllim të përbashkët. Kuptohet se në këtë kolektiv solidar ekziston një fuqi, të cilën po ata njerëz individualisht nuk e kanë. [Muhamed Hamidullah]



THELBI I ÇËSHTJES ËSHTË NË FILLIMIN E PUNËS

Doç. Dr. Harun Egmysh

Në përgjithësi ngjarjet i shohim pa u kushtuar rëndësinë dhe kujdesin e duhur. Kur ndodhin krime ndaj grave dhe fëmijëve, menjëherë kërkojmë që të shtohen ndëshkimet dhe të futet përsëri në fuqi ligji i ekzekutimit të fajtorit. Sapo të bjerë një tërmet, menjëherë vijnë në rendine ditës mangësitë në lidhje me licencën e ndërtimit të ndërtesave, çështjet në lidhje me kontrollin e ndërtimeve, pamjaftueshmëria e kontrollit dhe shtimi i ndëshkimeve të sipërmarrësve që vjedhin nga materialet e ndërtimit. Ndodhin aksidente në punë dhe minatorët ngelin brenda në minierë. Çështja që diskutohet më parë, janë rregullat në lidhje me sigurinë e punës, vazhdimësia e kontrolleve dhe ndëshkimet e

lehta që u jepen biznesmenëve të cilët keqpërdorin çfarëdo gjëje që të kenë mundësi. Përfundimisht jemi të bindur se çdo problem zgjidhet me sanksione. Ne pandehim se këto ngjarje të dhimbshme do të parandalohen kur shtohen ndëshkimet. Sikur e gjithë çështja përbëhet nga të ndëshkuarit. Sigurisht se ndëshkimet duhen shtuar, nëse nuk janë në shkallën e duhur apo janë të pamjaftueshme, por a do të mjaftonte sikur të sillnit edhe ndëshkimin më të madh për t'i parandaluar këto ngjarje të kobshme? A janë bërë ato që duhet të bëhen para se të arrihet në ekzekutimin e ndëshkimit? Askush nuk pyet për këtë.

Ky lloj këndvështrimi, që e merr në qendër ndëshkimin,

i ngjan perceptimit që kanë disa gjoja organizata islamike për Islamin, të cilat janë shfaqur në disa vende islame. Këto organizata, të cilat pohojnë se do të sjellin shariat, siç thuhet nëpër gazeta dhe televizione, e kuptojnë Islamin vetëm si zbatim ndëshkimesh të rënda, si prerja e dorës së vjedhësit dhe rrahja me kërbaç e atyre që kanë kryer marrëdhënie seksuale të paligjshme. Në të vërtetë, nuk mund të gjendet një mënyrë më e mirë për ta shfaqur të shëmtuar Islamin në sytë e jomuslimanëve dhe madje edhe në sytë e myslimanëve. Në këtë mënyrë e poshtërojnë Islamin, duke e shfaqur sikur Islami të jetë prerje dore dhe rrahje me kërbaç dhe përhapi islamofobinë. Sigurisht se prerja e dorës së vjedhësit dhe rrahja me kërbaç e atij që ka kryer marrëdhënie seksuale të paligjshme është urdhër i Kuranit, por qëllimi i Islamit kurrë nuk janë këto gjëra. Për këtë arsye, sikundër përshtypjes që japin organizatat islame (e kam fjalën për ato të mësipërmet), Islami nuk kërkon për të gjetur njerëz amoralë dhe për t'i rrahur me kërbaç. Sikundër kësaj, Islami nuk mjaftohet vetëm me ndalimin e ndërhyrjes në jetën private të njerëzve, me ndalimin e të folurit pa argument në lidhje me ta dhe me ndalimin e paragjykitimit të të tjerëve, por në të njëjtën kohë i dënon ashpër këto gjëra. Krimi më i vështirë për t'u argumentuar në Islam është marrëdhënia seksuale e paligjshme. Për ta vërtetuar këtë krim, duhen katër dëshmitarë, të cilët njihen për ndershmërinë e tyre, për mendjemprehtësinë e tyre dhe për aftësinë e të shikuarit. Këta dëshmitarë duhet ta shohim qartë penetrimin e organit mashkullor në organin femëror, siç përngjasohet në literaturën e jurisprudencës islame, siç hyn pena në shishen e bojës. Po ashtu, ndërmjet rrëfimeve të dëshmitarëve nuk duhet të ketë ndonjë kundërshtim me njëri-tjetrin. Mbi të gjitha, dëshmitarët nuk janë të obliguar ta padisin në gjykatën fetare ngjarjen që kanë parë. Madje, hadithet profetike përfshijnë një inkurajim në të kundërt me këtë, duke u shprehur se kush mbulon gabimin e vëllait mysliman, edhe Allahu do t'ia mbulojë gabimin atij. Ajo që duam të themi është se Islami nuk ka për qëllim të ndëshkojë, por ai e ndalon përhapien e kësaj veprë të shëmtuar në shoqëri duke u bërë në mënyrë të hapur. Të mos harrojmë se ka edhe fakihë që mendojnë se ndëshkimi bie me pendim.

Qëllimi i Islamit është mbrojtja e pesë vlerave që përbëhen nga jeta, pasuria, mendja, feja dhe nderi për të realizuar të drejtat e jetesës e pronësisë dhe

liritë e mendimit, të shprehurit, fesë, ndërgjegjes, martesës dhe shtimit. Për t'i mbrojtur këto vlera në shkallë universale, të cilat quhen Makasidu'sh-Sheriah (qëllimet e shariatit), sigurisht se mund të përdoret edhe ndëshkimi. Por ndëshkimi është një masë dhe aplikohet më në fund. Prandaj shariat nuk kërkon njerëz për t'u prerë dorën dhe amoralë për t'i rrahur me kërbaç. Synimi parësor i tij është realizimi i drejtësisë në shoqëri. Për këtë arsye, Islami siguron formimin e mundësive social-ekonomike, në mënyrë që të gjithë të kenë ushqim dhe punë, të gjithë të martohen dhe të bëhen me familje e fëmijë. Nisur nga kjo, zhvillohet shpirti i solidaritetit dhe ndihmës shoqërore, lehtësohen të martuarit, mbështeten ata që nuk mund të martohen, formohen vakëfe për t'u ardhur në ndihmë njerëzve dhe parandalohen mediat që i shtyjnë të rinjtë drejt marrëdhënieve të paligjshme. Sigurisht se para të gjitha këtyre, individëve, duke filluar që nga familja, u injektohet frika ndaj Allahut Teala, u jepet vetëdija për t'i respektuar të drejtat e të tjerëve, u mësohet se një ditë do të dalin në gjykatën supreme (gjykatën e madhe hyjnore) dhe se çdo gjë e ka një llogari.

A mund t'i dhunojë të drejtat e të tjerëve një individ i edukuar në këtë mënyrë në një shoqëri të tillë? A vjedh nga materialet e ndërimit nëse është sipërmarrës? A merr punëtorë pa sigurancione dhe a dhuron të drejtën e punëtorëve, nëse është biznesmen? A i favorizon të paaftët duke i penguar të aftët dhe duke marrë rryshfet, nëse është administrues? A mund t'i ngrejë dorë veçanërisht bashkëshorti bashkëshortes? A do të dëgjonim më për abuzimin me fëmijët dhe për krimet ndaj fëmijëve? Nëse del ndonjë që guxon t'i bëjë këto krime, edhe pse janë marrë që në fillim të gjitha këto masa, atëherë ai është një egërsirë dhe kriminel që e meriton ndëshkimin.

IMAZH

Siç shikohet, çdo gjë rrotullohet rreth moralit. Por morali është çështja që e shtjellojmë më pak, madje, që nuk flasim aspak për të dhe që shpeshherë e anashkalojmë. Me të vërtetë, nëse shohim programin e shkollave, vëmë re se morali është njëri prej mësimëve që jepet më pak. Të gjitha ngjarjet e tmerrshme që pushtojnë rendin e ditës në vendin tonë, janë çështje që kanë të bëjnë me moralin. Për t'i zgjidhur këto probleme mund t'i shtojmë ndëshkimet, por të mos harrojmë se së pari duhet ta marrim seriozisht edhe kryerjen e atyre gjërave që duhet të bëhen që në fillim.



Cfarë gjuhe të huaj do të mësojmë në shkollë?

Michael A. Morris

A e keni vrarë mendjen ndonjëherë se pse ca breza mësojnë frëngjisht, ca gjermanisht e ca rusisht si gjuhë të huaj në shkollat e tyre? Gjuha angleze e ka gjetur vendin e saj në programet mësimore në shumë shkolla publike dhe private. Kjo tendencë pasqyron prirjet e përgjithshme mbi informacionin dhe ekonominë globale. Askush nuk është i sigurt nëse kjo ka për të zgjatur për shumë kohë, por tashmë janë dhënë sinjale të rëndësishme që tregojnë se tashmë po shfaqen gjuhë të reja.

HISTORI DHE PARASHIKIME

Natyra dhe zhvillimi i blloqeve gjuhësore përgjatë historisë ka një bashkëlidhje të fortë me lëvizjet e kolonializmit në Europë, që filluan në shekullin e pesëmbëdhjetë. Argumentet mbi zhvillimin e gjuhës janë të lidhur ngushtë me periudhën e kolonializmit. Për shembull, shumë gjuhë afrikane nuk ishin të institucionalizuara gjatë kësaj kohe, dhe kolonizatorët imponuan gjuhën e tyre në administratë, shkolla e në komunikimet e tjera zyrtare shtetërore. Ky rend i ri i gjuhëve do të bashkekzistonte me ato lokalet, duke formuar kështu hierarki të reja dhe duke shtyrë më tej institucionalizimin e këtyre gjuhëve lokale. Të rriturve dhe fëmijëve u është mësuar frëngjishtja apo anglishtja, duke lënë pas dore gjuhët vendase të këtyre kolonive.

Dejvid Gredol (David Graddol) bën në studimin e tij dallimin midis niveleve të ndryshme të gjuhës. Perceptimi i tij mbi gjuhët e mëdha në vitin 1997 ishin anglishtja dhe frëngjishtja, por parashikimi mbi gjuhët e mëdha në vitin 2050 përfshin kinezishten, hinduishten/urduishten, spanjishten dhe arabishten. Ai shpjegon se këto zhvillime kanë për t'u nxitur nga shumë ndryshime ekonomike. Zhvendosja e gjuhës do të jetë e pashmangshme për shkak të numrit të këtyre folësve dhe rritjes së ekonomive midis tyre. "Asnjë gjuhë nuk do të ketë në shekullin e njëzetë pozitën hegjemone që pati anglishtja në shekullin e njëzetë", shprehet Gredol (Graddol).

Hierarkia aktuale e gjuhëve sipas Graddol-it:

Gjuhët e mëdha: anglishtja dhe frëngjishtja.

Gjuhët rajonale: arabishtja, kinezishtja, anglishtja,

frëngjishtja, gjermanishtja, rusishtja, spanjishtja.

Gjuhët kombëtare: rreth 80 gjuhë, u shërbejnë 180 shteteve-kombe.

Gjuhët zyrtare brenda shteteve-kombe: rreth 600 gjuhë në tërë botën.

Gjuhët e folura lokale: pjesa e mbetur e 6000 gjuhëve të botës.

Hierarkia e parashikuar e gjuhëve në vitin 2050 sipas Graddol-it:

Gjuhët e mëdha: kinezishtja, hinduishtja/urduishtja, anglishtja, spanjishtja, arabishtja.

Gjuhët rajonale (gjuha e blloqeve të mëdha tregtare): arabishtja, maleizishtja, kinezishtja, anglishtja, rusishtja, spanjishtja.

Gjuhët kombëtare: rreth 90 gjuhë, u shërbejnë 220 shteteve-kombe.

Gjuhët e folura lokale: 1000 apo më pak gjuhë të botës, me shkallë të ndryshme njohjeje zyrtare.

GPUHA DHE PJESËMARRJA NË EKONOMITË GLOBALE

Gjuha dallon nga "mallrat" e tjerë në terma ekonomikë, sepse nuk është e konsumueshme. Gjuhës i rezervohet një besnikëri e lartë, sepse njerëzit nuk mund ta lëshojnë brenda natës zotërimin e gjuhës dhe të sigurojnë një tjetër, siç mund të jetë rasti me një produkt apo me një shërbim. Mësimi i gjuhës kërkon kohë, përpjekje, e shpesh angazhim në procesin e gjatë që mund të jetë i kushtueshëm.

Zgjedhjen tonë e përcaktojnë teknologjia, llojet e ndryshme të mjeteve të informimit, edukimi formal në shkollë dhe përfitimet e veçanta që sigurojmë me zotërimin e gjuhës. Ky varg kompleks faktorësh ka për të ndikuar në faktin nëse ne do të zgjedhim të mësojmë anglisht, kinezisht (apo, të themi më mirë, dialektin mandarin), portugalisht, spanjisht, apo ndonjë gjuhë tjetër. Afërsia e gjuhës suaj amtare me ndonjë gjuhë tjetër është gjithashtu një faktor i rëndësishëm dhe nxitje që ka për t'ju shtyrë drejt zotërimit të saj. Për shembull, rumanishtja i përket familjes së gjuhëve romane. Kjo do të thotë se folësit vendas të rumanishtes kanë për

ta mësuar spanjishten, italishten apo frëngjishten me më pak përpjekje e me më pak kohë të harxhuar se një folës vendas gjerman.

Por çfarë e bën gjuhën globale? Vetëm numri i folësve vendas nuk mjafton për ta bërë gjuhën globale. Për shembull, nëse flasim për shifrën, kinezishtja mund të ketë numrin më të madh, por ajo mbetet një gjuhë e rëndësishme për rajonin aziatik, në veçanti për tregtinë dhe prodhimin industrial. Një gjerman, francez, kinez a indian ka për të zgjedhur anglishten si mjet komunikim në një takim ndërkombëtar biznesi. Kjo zgjedhje nuk është e rastësishme. Politikat publike në arsim në këto vende i kanë dhënë përparësi mësimi të anglishtes si gjuhë të huaj kundrejt gjuhëve të tjera. Së fundi filloi të shfaqet në shkencat shoqërore termi "shoqëri rrjetesh", si rezultat i zhvillimit në teknologji. Termi "shoqëri rrjetesh" u fut nga Manuel Kastels (Manuel Castells), dhe më tej ai e përkufizon termin si "një shoqëri, struktura e së cilës përbëhet nga rrjete të fuqizuara nga informacioni me bazë mikroelektronikën dhe teknologjitë e komunikimit". Rëndësia e këtij koncepti e kapërcen vetë termin. Ndryshimet në shoqëri ngjasin më shpejt, shkëmbimi i informacionit ngjet më shpejt, çështjet globale mund të jenë në pak minuta çështje lokale, dhe e kundërta. Ekonomitë nën një ndikim shumë të fuqishëm të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit kanë drejtime të ndryshme nga praktikrat e shkuara, apo mund të ndryshojnë kryekëput në vetëm pak sekonda. Mendoni normën e këmbimit të aksioneve për firma të ndryshme aksionere globale; në pak sekonda ju mund të fitoni apo të humbisni miliona.

ZOTËRIMI I GJUHËS

Gjuha hap dyert e informacionit. Lindja e epokës së informacionit dhe zhvillimet e shpejta në internet dhe në platformat mediatike globale i bëjnë shumë tërheqëse format e reja të ekonomisë. Ekonomia informative është tashmë në agjendën e tendencave globale. I vetmi parakusht për kapitalin njerëzor është zotërimi i gjuhës.

Le të hedhim një vështrim retrospektiv në gjuhën e përdorur në teknologjinë e informacionit dhe komunikimit. Tendencat në vitin 1997 treguan një shtrirje të gjuhës angleze në internet. Por rezultatet në vitin 2000 provuan shfaqjen e shumë blloqeve të tjera gjuhësore në përmbajtjen e internetit. Është e rëndësishme të vihet në pah rënia e dukshme e përqindjes së

përmbajtjes në anglisht të internetit, nga 84 në 64.8 për qind. Kjo nuk do të thotë se materiali në anglisht është fshirë. Është rritur numri i gjuhëve të tjera, dhe thjesht anglishtja nuk ka qenë në gjendje ta ndjekë këtë prirje me të njëjtën përqindje. Të dhënat e vitit 2010 tregojnë shfaqjen e blloqeve të tjera gjuhësore, sipas Internet World Stats. Anglishtja zbrit në 26.8%, e ndjekur këmba-këmbës nga gjuha kineze, me një diferencë prej 2.6%.

Përqindja e faqeve elektronike sipas gjuhës në vitin 2000:

anglisht	64.8
japonisht	5.9
gjermanisht	5.8
kinezisht	3.9
frëngjisht	3
spanjisht	2.4
rusisht	1.9
italisht	1.6
portugalisht	1.4
koreanisht	1.3
në gjuhë të tjera	4.6

Dhjetë gjuhët më të përdorura gjatë vitit 2010 në faqet elektronike (përqindjet):

anglishtja	26.8
kinezishtja	24.2
spanjishtja	7.8
japonishtja	4.7
portugalishtja	3.9
gjermanishtja	3.6
arabishtja	3.3
frëngjishtja	3
rusishtja	3
koreanishtja	2
gjuhët e tjera	17.8

Politikat publike, së bashku me faktorë të tjerë shtesë, kanë për të vendosur se ç'gjuhë kemi për të mësuar në shkollë. Cila do të jetë më me përfitim gjatë dhjetë viteve? Kjo mbetet për t'u parë!

GANXHAT MBI URËN E SIRATIT

Dr. Murat Kaja

Ebu Hurejra (r.a.), na tregon:

“Një herë, disa njerëz e patën pyetur Resulullahun (a.s.):

- O Resulullah! A do ta shohim Zotin Ditën e Kiametit?

I Dërguari i Allahut (a.s.), qe përgjigjur:

- A do të donit të shtynit njëri – tjetrin, për të parë diellin, ndërkohë që nuk ka asnjë re që ta mbulojë atë?

Sahabët i qenë përgjigjur:

- Jo, o Resulallah!

Atëherë, i Dërguarit i Allahut (a.s.), vazhdoi në këtë mënyrë:

- Ja pra, pikërisht kështu do ta shikoni Zotin e Madhëruar në Ditën e Kiametit. Allahu i Madhëruar do t'i bashkojë të gjithë njerëzit së bashku dhe do t'u thotë: “Le të shkojë secili pas atij që ka adhuruar!” Pas kësaj, të gjithë do të adhurojnë atë që kanë adhuruar në këtë botë; ai që ka adhuruar Diellin, do të adhurojë Diellin; ai që ka adhuruar hënën, do të adhurojë hënën, ai që ka adhuruar tagutët, do të vazhdojë të adhurojë tagutët. Vetëm ky ymet, mund të qëndrojë në këmbë, ndërkohë që brenda tij ka dhe hipokritë. Allahu i Madhëruar, duke u shfaqur në një trajtë që nuk e njihnin ata, u tha: “Unë jam Zoti juaj!”

Ata, (nga që nuk arritën ta njihnin Zotin e tyre përmes atij manifestimi), thanë: “I mbështetemi Allahut, nga ty! Derisa Zoti të na vijë neve ky është vendi

ynë, (nuk ndahemi nga ky vend). Kur Zoti ynë të na vijë neve, ne e njohim Atë.”

Ndërkohë, Allahu i Madhëruar, kur u shfaq në një formë që ata e njihnin, Ai u tha: “Unë jam Zoti juaj!” Dhe ata i thanë: “Po, ti je Zoti ynë!” dhe ndoqën Atë (urdhurat dhe rregullat e Tij).

Pas kësaj, krijohet Ura e Xhehenemit. Ai që do ta kalojë më parë ymetin e vet do të jem unë. Lutja e të dërguarve ishte: “All-llahumme slim slim: Allahu ynë, shëro, shëro!” Në Urën e Siratit gjenden plot ganxha si gjembat e sa’dan-it. A i keni parë vallë ju gjembat e sa’dan-it?”

Sahabët:

“Po, i kemi parë, o Resulallah!” Atëherë Resulallahu (a.s.), vazhdoi në këtë mënyrë:

“Atëherë ato çengela u ngjajnë gjembave të sa’dan-it. Mirëpo, se sa të mëdhenj janë ato, nuk i di kush tjetër veç Allahut të Madhëruar. Ja pra, këto ganxha kapin njerëzit për arsye të punëve të tyre (të këqija). Dikush shkatërrohet për arsye të punëve të veta të liga, e dikush tjetër merr plagë (aq sa ka gjynahe) duke u zvarritur përdhe, pastaj shpëton. Si përfundim, pasi Allahu i Madhëruar ta ketë përmbushur vendimin në çështjet mes njerëzve, kur të dëshirojë të nxjerrë nga Xhehenemi njerëzit e Xhehenemit, që kanë dëshmuar se nuk ka zot tjetër përveç Allahut, urdhëron engjëjt që t'i nxjerrin që aty.

Engjëjt i njohin ata përmes shenjës së sexhdes. Ndaj dhe Allahu i Madhëruar ka bërë haram në Xhehenem djegien e she-njave të sexhdes së njerëzve. Engjëjt pasi i djegin, i nxjerrin nga Xhehenemi ashtu të

përflakuar. U hedhin nga sipër një ujë që quhet “Uji i jetës” dhe pas kësaj gjallërohen me shpejtësi sikur të jenë farërat e rejhanit të egër që dalin pas një shtërngate. Nga mesi i tyre njëri mbetet me fytyrë duke parë Xhehenemin dhe thotë:

“O Zot! Aroma e tij po më helmatis, flaka e tij po më djeg. Të lutem, ma drejto fytyrën në ndonjë anë tjetër përveçse nga Xhehenemi!” Vazhdon aq gjatë të lutet në këtë mënyrë, sa Allahu i Madhëruar i tha:

“Sikur të të jap unë atë çfarë do, ti përsëri do të duash diçka tjetër.” Ndërkohë, ai njeri i thotë:

“Betohem në Madhështinë Tënde që nuk kërkoj asgjë tjetër! Nuk do të të kërkoj asgjë tjetër përveç kësaj.” Kështu betohet dhe jep fjalën para Allahut të Madhëruar se nuk do të kërkojë gjë tjetër. Si rezultat, Allahu i Madhëruar e shpie pranë Portës së Xhenetit.

Ai njeri kur sheh bukuritë që gjenden brenda vetes së tij, bën pak pushim aq sa dëshiron Allahu, por sërish nuk reziston më gjatë dhe thotë:

“O Zot! Më vendos brenda Xhenetit!” Zoti i Madhëruar thotë:

“A nuk patë dhënë fjalën se nuk do të kërkoje tjetër gjë? Jazëk të qoftë, o njeri! Sa krijesë që nuk qëndron në fjalë dhe që nuk mban premtimin që je!” Ai përgjigjet:

“O Zot! Mos më bëj mua krijesën më fatkeqe.” Dhe vazhdon të lutet pa u mërzuar. Pas kësaj, Allahu i Madhëruar qesh me të (kënaqet me të). Pasi kënaqet, bën të mundur që ai të hyjë në Xhenet. Pasi hyn në Xhenet, i drejtohet njeriut:

“Kërkoji edhe këto e ato!” (Pra, kujtohu dhe mendohu mirë se çfarë do të duash.) Ai i kërkon. Pastaj i thuhet:

“Kërkoji edhe këto edhe ato!” Ai bën një listë të gjatë kërkesash. Përfundimisht, kur përfundojnë të gjithë dëshirat dhe nevojat, Allahu i Madhëruar i drejtohet atij:

“Të gjitha këto, madje edhe një herë aq (madje edhe 10 herë më shumë) për ty janë.”

Ebu Hurejre (r.a.), thotë se ai njeri është njeriu i fundit që do të hyjë në Xhenet.” (Buhariu, Rikak, 52.)

Sipas një varianti tjetër të transmetimit, i Dërguari i Allahut (a.s.), është shprehur kështu:

“...Ata që kalojnë të parët mbi Urën e Siratit, kalojnë porsì një vetëtimë... Ata që kalojnë pastaj, kalojnë porsì era, ata më pas kalojnë si fluturimi i zogut dhe si vrapim

mi i një njeriut. Ato çfarë i bëjnë ata që të kalojnë në atë mënyrë janë veprat e tyre. Ndërkohë, Pejgamberi juaj, duke qëndruar në krye të urës, thotë vazhdimisht:

“O Zot! Shëro, shëro!” Kjo situatë vazhdon në këtë mënyrë, derisa të arrijë në atë gjendje saqë veprat e njerëzve të mos kenë më fuqi të kalojnë njerëzit. Madje vjen njëri, nuk arrin dot as të ecë, por duke u zvarritur përpiqet ta kalojë. Në dy anët e urës ekzistojnë ganxha të varura. Këto janë të urdhëruara që të kapin njerëzit e caktuar. Një pjesë prej njerëzve, arrijnë të shpëtojnë të plagosur në sajë të këtyre ganxhave, kurse një pjesë hidhen në Xhehenem.” (Muslimi, Iman, 329.)

Thirrja e besimtarit në Urën e Siratit është: o Zot! Shëro, shëro!” (Tirmidhiu, Kijamet, 9/2432.)

Një transmetim të ngjashëm e bën edhe Aishja (r.anha):

“Një herë m’u kujtua Xhehenemi dhe qava. Kur më pa Resulullahu (a.s.), në këtë gjendje, më pyeti:

“Aishe, çfarë ke?”

“Kujtova Xhehenemin, ndaj dhe qava. Ju pejgamberët, a nuk i kujtoni pjesëtarët e familjes Ditën e Gjykimit?” – e pyeta.

I Dërguari i Allahut (a.s.), më ktheu këtë përgjigje:

“Ekzistojnë tre vende, në të cilat askush nuk kujton askënd:

1. Gjatë kohës kur peshohen veprat, pa e mësuar nëse peshorja po anon nga e mira jote apo nga e keqja jote.

2. Atëherë kur do të thuhet “... Ja, lexoni librin tim!” (Hakka, 19), pa e ditur akoma nga ç’anë do të të jepet libri i veprave, nga e djathta, nga e majta apo nga mbrapa.

3. Në kohën kur do të ndërtohet mbi Xhehenem Ura e Siratit. Në dy anët e urës do të vendosen plot ganxha e gjemba të fortë. Allahu i Madhëruar, përmes këtyre ganxhave, krijesat që do, i kap dhe i hedh në Xhehenem. Ja pra njeriu, në këtë situatë kur njeriu nuk di nëse do të jetë prej atyre që shpëton apo prej atyre që nuk shpëton.” (Hakimi, IV, 622/8722)

Çdo gjynah që është bërë, është një ganxhë dhe gjemb i vënë në Urën e Siratit. Për sa kohë që ato gjenden aty, Ura e Siratit është, ose shumë e vështirë për t’u kaluar, ose e pamundur. Gjithsecili, si të dëshirojë, ose t’i shtojë këto ganxha, ose duke u penduar e duke bërë istigfar t’i heqë që aty!

Çdo gjynah që është bërë, është një ganxhë dhe gjemb i vënë në Urën e Siratit. Për sa kohë që ato gjenden aty, Ura e Siratit është, ose shumë e vështirë për t’u kaluar, ose e pamundur.



Xhafer Durmush



KUSHTET e të qenit njeri me shpresë

Në suren Zumer thuhet kështu: **Thuaj: "O robërit e Mi, që i keni bërë keq vetes me gjynahe, mos e humbni shpresën në mëshirën e Allahut! Allahu, me siguri, i fal të gjitha gjynahet. Vërtet, Ai është Falësi i madh dhe Mëshirëploti."** (Zumer, 53)

Kuptimin e ajetit kuranor mund ta shpjegojmë më gjerë në këtë mënyrë: "O robërit e Mi, që keni dëmtuar veten tuaj dhe keni bërë disa gjynahe të caktuara! Mos hiqni dorë nga shpresa prej Allahut! Mos jini të pashpresë lidhur me faljen që do t'ju bëjë Ai. Padyshim që Allahu, nëse dëshiron, ua fal gjynahet robërve të vet dhe nuk i gjykon fare ata të cilët i janë shmangur shirkut. Zotëruesi i bujarisë ju fal ju. Mjafton të mos hiqni dorë nga shpresa për mëshirën e pafund të Tij; mbështetuni në mëshirën e Tij, duke kërkuar pendim dhe falje prej Tij."

Sipas komentatorëve të Kuranit, ajeti në fjalë është shpallur për një grup shoqëror të caktuar që kishte frikë se mund të mos ua falte Zoti gjynahet e mëdha të mëparshme, si shirku, shqetësimi i tjetrit, marrëdhënia seksuale jashtë kurorës, armiqësia ndaj Resulullahut (a.s.), lufta e bërë kundrejt tij etj. Aq sa Pejgamberi ynë i dashur (a.s.), ishte gëzuar që ishte shpallur një ajeti i tillë, kurse sahabët e kishin vlerësuar si sihariqi më gjithëpërfshirës lidhur me faljen e gjynaheve. Ndaj dhe ishte bërë e ditur që dera e pendesës është gjithnjë e

hapur për ata që e kanë kaluar cakun duke e tepruar përmes gabimeve dhe harresës, deri në një kohë të caktuar.

Sipas asaj çfarë bëhet e ditur në **Ruhul-Bejan**, lidhur me ajetin në fjalë Pejgamberi (a.s.), është shprehur kështu: "Këtë ajete nuk e ndërroj me asgjë çfarë ka bota." Pra, ky ajete është i barabartë me tërë botën dhe, edhe sikur t'më ofrohet e gjithë bota në këmbim të këtij ajeti, nuk e ndërroj. Pasi, Allahu i Madhëruar ka premtuar se do t'u falen të gjithë gjynahet edhe robërve të vet që i kanë bërë keq vetes së tyre dhe u është ndaluar të heqin shpresat nga mëshira e Zotit. Mirëpo, ky ajete tregon se Allahu nuk do ua falë të gjitha gjynahet të gjithë njerëzve, por vetëm atyre që Ai dëshiron t'ua falë. Ndaj dhe urdhri për pendim që kalon në ajete, nuk bie ndesh me njoftimin se Ai do t'i dënojë ata që i kundërvihen Atij, as me urdhrin për sinqeritet në vepra e as me kanosjen (tehdid) me dënim që u bën Zoti njerëzve. Allahu i Madhëruar e fal shirkun vetëm atëherë kur njeriu pendohet dhe kur heq dorë tërësisht prej tij. Kurse gjynahet e tjera, të mëdha apo vogla qofshin, ua fal përmes pendimit, por kujt Ai dëshiron ia fal edhe pa pendesë. Përndryshe, nuk kuptohet se Allahu ua fal njerëzve çdo lloj gjynahu."

Sipas asaj çfarë transmetohet, një ditë, **Ibni Mesudi** kishte hyrë në mesxhid. Vaizi i xhamisë po fliste mbi

zjarrin e xhehenemit, zinxhirët dhe prangat. Ibn Mesudi nuk rezistoi dot dhe i tha: "Përse po i drejton njerëzit drejt pashpresës?" dhe pastaj shtoi këto fjalë: "A nuk e ke lexuar ajetin: **O robërit e Mi, që i keni bërë keq vetes me gjynahe, mos e humbni shpresën në mëshirën e Allahut..!?**"

Këtu mbi të gjitha, duam të theksojmë këtë: shpallja e ajetit kuranor lidhur me një çështje të caktuar, nuk përbën pengesë që gjykimi i tij të jetë i përgjithshëm. Pasi, thuajse në të gjithë librat e komentimit të Kuranit Famëlartë (tefsir) bëhet e ditur se ky ajet bën fjalë për faljen dhe mëshirën që përfshin të gjithë ata që i kanë bërë keq vetes duke bërë gjynah.

Ajeti kuranor në fjalë është ajeti më shpresëdhënës i Kuranit Famëlartë. Kësisoj, bëhet e ditur gjerësia e mëshirës hyjnore dhe madhështia e faljes së Zotit të Madhëruar ndaj të gjithë njerëzve që bëjnë pjesë brenda rrezes së Islamit. Kur shohim ajetet që janë në vijim, vërejmë se ekzistojnë dy kushte të rëndësishme, në mënyrë që të mos heqim shpresën nga mëshira e Allahut. **E para:** kthimi nga Zoti, para se të vijë dënimi dhe dorëzimi në plot kuptimin e fjalës tek Allahu; të tregohesh i kujdesshëm duke zbatuar urdhrat e Allahut dhe duke u ruajtur nga ndalesat e Tij. Përndryshe, duhet të jemi të vetëdijshëm që nuk na vjen ndihma prej Tij. **E dyta:** të ndjekim me rigorozitet Fjalën më të Bukur (gjykimin e Kuranit) para se të përplasemi me fatkeqësitë. Të praktikohen me përpikëri dhe tërësisht

çështjet që përmenden aty.

Ata që nuk ndjekin këto dy kushte, janë ata që nuk hyjnë në rrezen e besimit, ngaqë ndjekin arrogancën dhe mendjemadhësinë. Janë ata që këmbëngulin që të rrinë në batakun e gjynaheve. Janë ata që nuk i drejtohen derës së pendimit. Pikërisht ata janë njerëzit që i kundërvihen ajetit kuranor në fjalë dhe që nuk do t'i përfshijë mëshira hyjnore. Pasi edhe në ajetet në vijim u përmendet shembulli i tyre fatkeq. Në Ditën e Kiametit përmendet se do të thonë të penduar: "*Sa keq për mua që kundërshtova Allahun! Vërtet unë jam prej atyre që kam nënçmuar Fjalën Hyjnore!*" Si dhe: "*Ah sikur të kisha edhe një herë mundësi të rikthehesha dhe të bëhesha prej të mirëve!*" Ndërkohë që nuk do të vlerësohen përgjërimet e tyre të penduara atë ditë dhe do t'u thuhet: "*Ajetet tona erdhën për ty, por ti i përgënjeshtrove, u solle si arrogant dhe u bërë prej mohuesve.*" Si dhe: "*Allahu bën që të shpëtojnë ata që kanë devotshmëri (takva). Ato nuk i shqetëson asgjë e ligë. Ata nuk kanë pse të mërziten...*"

Si përfundim, kushtet për të qenë njeri që shpreson janë të pakta dhe të përmbledhura. Rruga që shkon drejt mëshirës hyjnore është e drejtë dhe e qartë. Për të qenë njerëz që shpresojmë dhe shpresëdhënës kemi shumë arsye; përveç pengesave që ofron nefsi nuk kemi tjetër pengesë. Dyert e pendesës janë të hapura deri në çastin e fundit, deri atëherë kur nuk pranohen më. Mjafton që ne të përpiqemi, të ecim, të përgjërohemi.

Lexo Mendo

SHËRIMI I SËMUNDJEVE TË ZEMRËS

Në suren Kamer, thuhet: "**Vërtet, Ne e kemi bërë Kurranin të lehtë për t'u kuptuar dhe kujtuar, prandaj, a ka ndonjë që të marrë këshillë?**" (54/17). Kurse në suren Isra, jepet ky sihariq: "**Ne shpallim nga Kurani atë që është shërim dhe mëshirë për besimtarët e që mohuesve keqbërës u shton vetëm humbje.**" (17/82)

Ne e dimë që Kurani Famëlartë është dhuntia më e madhe që ofron mundësinë e komunikimit të Allahut me njeriun. Është dhikri, që hap dyert e meditimit. Është çelësi i lumturisë së dy botëve. Të lexosh, të dëgjosh dhe të shohësh me *ihlas* Fjalën Hyjnore është ibadet. Pasi, leximi shëron sëmundje shpirtërore si arrogancën dhe dyfytërsinë. Dhe bën që të gjallërohen thellësitë e zemrës. E hap zemrën pranë përshtatshmërisë së Krijuesit të Lartë. Ndaj dhe ajeti "**Prandaj, më kujtoni Mua (me namaz e lutje) që Unë t'ju kujtoj (me shpërblime)...**" (Bekara, 152), është një shenjë e sakinitet që do të krijohet në rast kur kujtohet Ai...



Sipas asaj që përmendet në tefsir, lëngata më e madhe është pikërisht të mos bësh këtë dhikër; ashtu sikurse bëhet e ditur edhe në ajetin "**Ata e kanë harruar Allahun, por edhe Ai i ka harruar ata.**" (Teube, 67), është të jesh gafili që përmendet. Kështu që, nuk duhet treguar të shkujdesur ndaj ushqimit që duhet të marrë zemra, që mos ta kaplojnë sëmundjet *batini*. Le të mos priset natyrshmëria, për arsye të harrësës që bëjmë për Allahun. Butësia dhe shëndeti të mos shndërrohen në vrazhdësi dhe ashpërsi. Që të mos shndërrohen modestia në arrogancë, përshtatshmëria në papërshtatshmëri, bashkimi në ndarje, dashuria në armiqësi, etj.

Meqë arsyeja kryesore e sëmundjeve të zemrës është mungesa e dhikrit dhe mosmirënjohja ndaj Zotit, a mund të shërohen atëherë pa u diagnostikuar siç duhet? Ai që nuk e di saktësisht shqetësimin që ka, a mund ta kërkojë siç duhet shërimin e tij?



Bashkë me të rinjtë në rrugën EDUKIMIT

Idris Arpat

Çështja e mësim-edukimit është një nga çështjet më serioze të njerëzimit. Ashtu siç ka lidhje mënyra e botëkuptimit dhe jetesës sonë me mësim-edukimin, ashtu ka lidhje edhe grada jonë me cilësinë e arsimit. Dashuritë tona, dëshirat, aftësitë dhe dobësitë tona; mungesa e idealeve, jeta pa qëllime dhe të gjitha të metat tona të ngjashme me këto, në një farë mënyre janë të lidhura me mësim-edukimin.

Thonë se mësim-edukimi është një "profesion pejgamberësh". Kjo mund të thuhet edhe për shkak se pejgamberët kanë qenë mësuesit e njerëzimit, por edhe për të theksuar rëndësinë e kësaj çështjeje.

Popujt që e marrin seriozisht jetën dhe mendojnë për të tashmen e të ardhmen e tyre, i japin shumë rëndësi mësim-edukimit. Ata, jo vetëm që ndajnë pjesën më të madhe të buxhetit për fushën e arsimit, por i orientojnë në këtë fushë edhe fëmijët më të zgjuar dhe mendjet më të mprehta. E njëjta gjë është edhe nëse e shohim nga aspekti i familjes dhe i nxënësit. Cilëndo familje të pyesni se "cila është gjëja më e shtrenjtë për ju?", "fëmijët", do t'u përgjigjen. Sigurisht që familjet dë-

shirojnë t'i edukojnë fëmijët e tyre nëpër shkolla me emër. Fëmijët e tyre që i kanë rritur me aq mund, nuk do të dëshironin kurrë t'i linin në dorën e mësuesve të rëndomtë nëpër shkolla të thjeshta.

Në fillim, deri në një farë mase nxënësi mund ta kuptojë rëndësinë e çështjes së edukimit dhe se a janë apo jo të përshtatshme kushtet e mësimi. Por me kalimin e kohës dhe me zhvillimin e aftësisë së perceptimit, ai arrin ta kuptojë mirë nivelin e shkollës dhe të mësuesve. Për rrjedhojë, ai e di mirë se çfarë themelesh po hidhen, ato të lumturisë apo të shkatërrimit.

Një temë e gjerë siç është kjo e mësim-edukimit, është e vështirë ta përmbledhësh të gjithën brenda kufijve të këtij shkrimi, por megjithatë, do të dëshiroja të hyja pak në detaje.

Le të marrim në dorë lëndën e letërsisë. Për shkak se është një lëndë me përmbajtje të gjerë dhe plot ngjyra, ajo e tërheq vëmendjen e nxënësit, e emocionon dhe zgjeron botën e tij të imagjinatës. Kështu duhet të jetë mësimi, nëse mësuesi i lëndës është i vetëdijshëm për përgjegjësinë që ka, e ka pasion lëndën dhe është i aftë.

Po ashtu, edhe lëndët e tjera varen nga këto parime.

Çdo lëndë ka ngjyrat dhe veçoritë e saj tërheqëse. Mjafton që mësuesi i lëndës të kuptojë rëndësinë e çështjes, të ndjejë përgjegjësinë dhe të përdorë potencialin që ka.

Këtu duhet të theksojmë se edhe aftësitë dhe prirjet e nxënësit duhet të merren patjetër në konsideratë. Ashtu si çdo fëmijë nuk është i aftë në çdo lëndë, edhe prirjet e tij nuk janë të njëjta për çdo lëndë. Padyshim se orientimi i nxënësit në një degë sipas aftësive dhe prirjeve të tij, është e detyrueshme. "Puna më e lehtë është ajo që bëhet me dashuri". Prandaj duhet ta kuptojmë mirë rëndësinë e aftësisë dhe dashurisë dhe të besojmë në forcën e saj.

Nëse shkolla arrin t'i japë fëmijës zakonin e leximit, do të thotë se ka arritur një sukses shumë të madh. Do të thotë se tashmë, orët e mërzitshme janë kthyer në orë tërheqëse. Allahu betohet në penën dhe ato që shkruhen me të. Por kushedi çfarë mirësish do të falë Ai për shkak të edukimit të mendjeve të arta dhe zemrave të gjera. Në këtë mënyrë, njeriu do të kapërcejë një nga një të gjitha shkallët e zhvillimit dhe do të arrijë mendime të larta e ndjenja të pastra. Kufijtë e kënaqësisë do të qartësohen dhe do të zgjerohen me zgjerimin e botës së mirësisë. Prej mirësive të qiejve dhe të tokës do të burojnë gëzime dhe festa të ndryshme.

Prej lëndëve të logjikës e matematikës do të arrihen mendime të qarta, ndërsa prej filozofisë dhe tasavufit thellësi e gjerësi. Me qartësimin e dijes do të kenë saktësi edhe mendimet e mbështetura në dije. Mendimet e sakta do të sjellin vendime të sakta, ndërsa vendimet e sakta, do të sjellin zbatime të suksesshme. Kushti i domosdoshëm për arritjen e këtyre sukseseve dhe pasurive, janë mësuesit që vlojnë nga brenda.

Mësuesi...

Njeriu që ka marrë mbi supë misionin e peygamberëve, ka marrë përsipër një barrë shumë të rëndë prandaj jeton me ndërgjegje. Ai është njeriu që i ka kthyer gjembat nga brenda dhe nga jashtë çel gjithmonë trëndafilta. Sado shqetësime të ketë, ai është njeri

që preferon të qeshë. Ai është njeriu që jeton për të ardhmen.

Edhe një bukuri, edhe një urtësi, edhe një varg, edhe një fjali të bukur... në këtë mënyrë, këta njerëz nuk e kuptojnë përfundimin e ditëve të numëruara... Vetëm për të edukuar një nxënës durojnë një mijë të këqija. Ata janë njerëz që thonë "vdes nëse nuk jap mësim", "ditën kur të mos vij në mësim, ejani në varrimin tim". Për ta nuk ka kufi në shërbimin ndaj nxënësve dhe arsimit. Ata edhe prej vrasësve më të këqij arrijnë të nxjerrin flamurtarë të besimit.

Nëse nuk gjeni dot mësues të mirë, gjithçka bëhet e vështirë. Fati më i keq i fëmijëve nuk është mungesa e shkollës, e pajisjeve mësimore apo e parave. Këto mund të zgjidhen në njëfarë mënyre. Por çfarë do të

bëni nëse mësuesit i shuhet ideali, i ngushtohet horizonti dhe i ndalen përpjekjet? Mungesa e vizionit, e përpjekjes dhe e entuziazmit e bën jo vetëm shkollën sikur ka rënë zjarri, por edhe fëmijët i kthen në lule që vyshken pa çelur ende mirë. A nuk ia nxin të ardhmen shoqërisë ky problem?

Ja pra fëmijë e të rinj! Ju jeni të interesuarit e drejtpërdrejtë të gjithçkaje që ndodh. Programi i shkollës kështu, mësuesit ashtu, botëkuptimi i edukimit një përrallë tjetër etj... Por sido që të jetë, ju duhet patjetër të gjeni një mënyrë për të zhvilluar veten. Nuk ndodhemi në vendin e ankesave dhe qarjeve, por në testin e seriozitetit dhe sinqeritetit. Askush nuk i ka ngjitur shkallët e suksesit me

duar në xhepa e duke fishkëlyer. Kjo është koha për të shtrënguar dhëmbët dhe për të mësuar durimin. "Fillimet e dijes janë më djegëse se qepa, por fundi është më i ëmbël se mjalti", miku im. Ti duhet të dish të përtypësh hidhërimet pa e shtrembëruar fytyrën dhe t'u vësh gjoksin vështirësive.

Nëse e mësoni mirë arabishten, do t'u hapen dyert e dijes islame e, nëse e mësoni anglishten, u hapen dyert e kulturës botërore. Prandaj, këto dy gjuhë duhen mësuar në mënyrë sa më të dobishme. Përndryshe, nuk mund të hapeni në oqeanet e gjera të dijes, mendimit dhe artit, por do ta burgosnit veten në një hapësirë shumë të ngushtë.

Nëse shkolla arrin t'i japë fëmijës zakonin e leximit, do të thotë se ka arritur një sukses shumë të madh. Do të thotë se tashmë, orët e mërzitshme janë kthyer në orë tërheqëse. Allahu betohet në penën dhe ato që shkruhen me të. Por kushedi çfarë mirësish do të falë Ai për shkak të edukimit të mendjeve të arta dhe zemrave të gjera.

Nga ana tjetër, duhet të fitoni një zakon të vazhdueshëm e të rregullt të leximit. Ka shumë libra dhe shkrime që ju presin për t'i lexuar. Me të lexuar e mësuar, shtohet edhe kureshtja, ngrihet edhe niveli i botëkuptimit dhe perceptimit tuaj.

Gjatë leximit nuk duhet të nxitohemi. Duhet të shpëtojme nga ndjenja e mbarimit sa më shpejt të shkrimt apo të librit. Përndryshe, do të na shpëtojnë shumë urtësi dhe shprehje të bukura.

Një çështje tjetër e rëndësishme është edhe marrja e shënimeve. Kur lexojmë një libër, duhet të marrim shënim çdo gjë të rëndësishme dhe çdo fjali që na pëlqen. Në sajë të shënimeve, prej atyre që mësojmë kur jemi pesëmbëdhjetë vjeç do të përfitojmë edhe kur të jemi dyzet e pesë vjeç. Shënimet e mbajtura, në të ardhmen do t'ju falin emocione të reja dhe do t'u hapin derën shumë zhvillimeve të dobishme.

Njeriu nuk duhet ta detyrojë veten të lexojë këtë apo atë libër të caktuar. Ai duhet të lexojë atë libër që dëshiron. Ashtu siç nuk i pëlqejnë gjithmonë të njëjtat gjellë, njeriut nuk i pëlqejnë gjithmonë edhe të njëjtët libra. Në lidhje me këtë çështje, kriteri më i mirë është interesi i njeriut. Njeriu duhet të lexojë librin për të cilin ka interes dhe dëshiron ta lexojë. Në këtë mënyrë edhe kultura jonë mbushet me ngjyra, por edhe lexojmë me dëshirë e pasion.

Njeriu që merret me dije dhe mendime, në të njëjtën kohë duhet edhe të shkruajë. Ai duhet t'i shkruajë mendimet dhe disa prej ndodhive të gëzueshme e të hidhura, duke shënuar edhe datën e tyre. Këto mund të jenë ditarë të çmuar, poezi ose tregime të shkurtra. Në këtë mënyrë, nuk i çojmë dem frytet e mendjes dhe zemrës sonë. Duke shkruar vazhdimisht, do të arrijmë mendime më të qarta, pjekuri dhe tekste më të bukura.

Pjesëtarët e një feje që betohet në penën dhe ato që shkruhen me të, nuk duhet ta lëshojnë kurrë penën nga

dora. Ju e dini, është një metodë që quhet "Të mendosh duke shkruar, të shkruash duke menduar".

Njeriu nuk duhet t'i mbajë për vete ato që mëson. Në një farë mënyre, ai duhet t'i shprehë ato në çdo moment të përshtatshëm. Mendimet e qëlluara dhe fjalitë e bukura duhen shprehur patjetër në një moment kafeje, gjatë një bisede ose gjatë një shëtitjeje. Është e mundur që këto të tërheqin vëmendjen e dëgjuesit dhe të ndikojnë tek ai. Fshehja e dijes nuk ka asnjë dobi. Retë mbajnë shumë shi, por nëse nuk e lëshojnë, janë të padobishme.

Bisedat në aspektin e dijes dhe mendimit, në të njëjtën kohë janë edhe stërvitje e mendjes. Rruga e dijes dhe njohjes, është një rrugë e gjatë dhe e hollë, e cila kërkon durim, vazhdimësi, kujdes dhe metodë. Këto janë elementet e domosdoshme të kësaj rruge.

Le të kujtojmë edhe një çështje: Ashtu siç është "leximi" një mënyrë mësimi në rrugën e dijes, ashtu është edhe "dëgjimi". Në Kuranin Fisnik, urdhërohet: "**Ata të cilët dëgjojnë fjalët dhe pasojnë atë më të bukurën prej tyre...**" (Zumer, 18) Pra, të dëgjosh me vëmendje, të marrësh atë që është më e bukur e të lësh atë që nuk është e dobishme. Me një fjalë, të kesh një mendje që zgjedh e jo që merr ose lë gjithçka. Nëse përvetësohet kjo metodë, udhëtari i dijes do të përfitojë shumë.

Edhe një çështje:

Qëllimi ynë i vetëm në veprimtaritë tona drejt dijes e njohjes, është kënaqësia e Allahut të Madhëruar. Në hyrjen e sures Muddeththir, e cila është një nga suret e para që është zbritur, pasi Allahu i drejtohet Pejgamberit tonë (a.s.), duke i thënë të ngrihet e të thërrasë njerëzit, të madhërojë Allahun, të pastrohët nga papastërtitë trupore dhe shpirtërore, Ai e urdhëron që pas të gjitha këtyre: "Të durojë për hir të Zotit!". Pra, çështja është shumë e qartë. Në të kundërtën, gjithçka bëhet e pamundur.





Pëlqimi i Allahut

Dr. Kerim Bulladë

Konceptet, si “pëlqimi i Allahut”, “kënaqësia e Zotit”, “për hir të Allahut”, “në emër të Allahut”, kanë një përdorim të shpeshtë në mesin e myslimanëve. Besimtarët e sinqertë dhe të devotshëm, gjithçka çfarë bëjnë, vepra apo ibadete, i bëjnë me qendër këtë koncept. Padyshim që ky besim dhe kjo vetëdije arrihet përmes shpjegimit të Kuranit dhe haditheve. Kurani kërkon nga besimtarët që pëlqimin e Allahut ta vendosin në bosht të të gjitha veprave, ibadeteve dhe nënshtrimeve.

Në Kuran, folja “radije” dhe fjalët që rrjedhin prej saj, përmenden shtatëdhjetë e tri herë. Ndërkohë që në një pjesë të këtyre ajeteve, disa nga këto folje dhe derivate të tyre bëjnë fjalë për pëlqimin e Allahut, pjesa tjetër bën fjalë për pëlqimin e njerëzve.

Fjalët “er-rida”, “er-ridvan”, që përmenden në ajete, janë në kuptimin e të qenit i kënaqur. “Er-Radi” është në kuptimin e njeriut të kënaqur, kurse “mardijj” është në kuptimin e atij që është bërë i kënaqur.

Allahu i Madhëruar ka treguar se nga cilat gjëra dhe nga cilët njerëz është i kënaqur. Allahu i Madhëruar ka bërë të ditur se është i kënaqur nga njerëzit që janë besnikë në besimin e tyre dhe në detyrën e tyre si krijesa të Zotit, nga ata që i qëndrojnë fjalës së dhënë, nga ata që realizojnë atë që kanë premtuar. Ka bërë të ditur se është i kënaqur prej atyre që për hir të Islamit lanë gjithçka kishin në Mekë dhe bënë hixhret dhe prej atyre që pa asnjëfarë ngurrimi, ndihmuan dhe përkrahën këta emigrantë në vatrat e tyre. Ai është i kënaqur edhe prej atyre që i besuan Atij dhe që bënë vepra të mira, si dhe ka thënë se këta janë krijesat më të mira në mesin e të gjitha krijesave. Allahu i Madhëruar gjithashtu ka bërë të ditur në Kuran se pëlqen Islamit si fe dhe që

ka pëlqyer atë si fe të njerëzimit, ka shpallur se është i kënaqur nga ata njerëz që nuk krijojnë miqësi e as që i duan ata të cilët janë armiq të Allahut dhe të Dërguarit e Tij. Ka theksuar se i pëlqen ata njerëz që urdhërojnë për mirë (emru bil-ma’ruf) dhe që qortojnë për vepra të këqija (en-nehju anil-munker), ata që falin namazin siç duhet, ata që japin zeqat dhe nga ata që i binden Allahut dhe të Dërguarit të Tij. Allahu i Madhëruar i ka lavdëruar dhe ka bërë të ditur po ashtu që, do të jetë i kënaqur edhe prej atyre që bëjnë xhami për hir të Tij, prej atyre që i binden pëlqimit të Tij, prej atyre që janë detyruar të largohen nga vendi i tyre vetëm për atë kauzë dhe të heqin dorë nga pasuria e tyre, prej atyre që bëjnë tavaf Mesxhidi Haramin me qëllim për të fituar pëlqimin e Tij, prej atyre që harxhojnë pasurinë e tyre në rrugë të Zotit, prej atyre që flijojnë edhe jetën e tyre për hir të Allahut, prej atyre që urdhërojnë mirësinë dhe sadakanë, prej atyre që bëjnë pajtime mes njerëzve, prej atyre që kërkojnë pëlqimin e Tij duke bërë sexhde dhe ruku.

Allahu i Madhëruar ka theksuar se nga fasikët nuk do të jetë i kënaqur dhe nuk mund të ketë pëlqimin e Tij ndaj femohimit. Në krahun tjetër, në Kuran bëhet e ditur se Allahu nuk i do dhe do të ndëshkohen me ndëshkime të rënda ata që janë të kënaqur vetëm me jetën e kësaj bote, të cilët nuk marrin në konsideratë aspak botën tjetër, duke mos e besuar takimin me Allahun; ata që dezertojnë nga xihadi, pa pasur ndonjë arsye justifikuese, ata që sillen me dy fytyra për t’i pëlqyer besimtarët, me qëllim interesat e tyre, ata që bëjnë vepra që shkaktojnë zemërimin e Allahut, në vend të pëlqimit të Tij.

Ashtu siç po vihet re, në Kuran është bërë qartësisht

e ditur cilët njerëz dhe cilat vepra Ai pëlqen, po ashtu është i mjaft e qartë edhe se nga kush dhe nga cilat vepra nuk është i kënaqur.

Kësisoj, besimtari duhet të jetë i kënaqur nga njerëzit, prej të cilëve Allahu është i kënaqur, ai duhet të bëjë ato vepra me të cilat Ai është i kënaqur, si dhe duhet t'u shmanget atyre njerëzve dhe veprave, të cilat Allahu nuk i pëlqen. Besimtari nuk e ka të drejtën të pëlqejë asnjë njeri apo vepër, të cilën Allahu nuk e pëlqen.

Çështja e pëlqimit të Allahut duhet parë bashkë me dashurinë e Allahut. Kështu, kjo gjë do të bëjë që kjo çështje të kuptohet më mirë. Allahu i Madhëruar në Kuran ka bërë të ditur se i do ata që bëjnë mirë, ata që bëjnë vepra të bukura dhe të dobishme (muhsinët), të penduarit, ata që janë pastruar nga papastërtia fizike dhe shpirtërore, të devotshmit, ata që iu dorëzuan Zotit, durimtarët, ata që sillen me drejtësi. Kurse ata që e teprojnë, ngatërrestarët, ata që këmbëngulin në femohim dhe në gjynahe, blasfemuesit, mizorët, ata që mburren dhe që shprehin mendjemadhësi, gjynahqarët, që e kanë bërë profesion mashtrimin, ngatërrestarët, ata që e teprojnë, tradhtarët, mendjelehtët, tradhtarët mohues, të llastuarit.

Muslimani e pozicionon dashurinë dhe padashurinë, pëlqimin dhe mospëlqimin në raport me të tjerët sipas këtyre parimeve që i parashtron Kurani. Sipas asaj që Allahu është i kënaqur dhe asaj që Ai nuk është i kënaqur, është e bazuar edhe dashuria dhe pëlqimi i muslimanit. Besimtari, i cili nuk duhet të bëjë dallime fetare, gjuhësore, racore dhe kombëtare dhe që duhet të sillet i drejtë, nuk duhet t'i dojë të gjithë, të jetë i kënaqur nga të gjithë apo të pëlqejë çdo sjellje a vepër, përkundrazi, ai duhet të krijojë marrëdhënie me njerëzit duke pasur parasysh këtë kornizë të parimeve. Kështu bazohet dashuria dhe urretja ndaj Allahut.

ADHUROJE ZOTIN TËND DERISA TË TË VIJË DIJA E QARTË!

Mustafa Erlsh

Kuptimet e ajeteve në Kuranin Fisnik ndahen në dy kategori: "muhkem", ajete me kuptim të qartë dhe "muteshabih", ajete me kuptim të mbyllur apo të fshehtë. Sipas Imam Rabbanit, kategoria e parë janë burimi i sheriatit (legjislacionit islam), ndërsa kategoria e dytë janë si dhomat e thesarit ku mbahen dijet e vërteta dhe të fshehta. Ndërkohë që kategorinë e parë e njohin dijetarët e sheriatit, ajetet muteshabih, siç janë "huruf-u mukattaa", mund t'i kuptojnë vetëm dijetarët e thellë në dije. Secili prej ajeteve muteshabih dhe çdo germë e këtyre ajeteve, janë si një oqean i mbushur me enigma të fshehta midis të dashuarve. Ato janë si simbole të fshehta të mbushura me shenja midis atij që dashuron dhe atij që dashurohet. (II, Letra 276.)

Sipas Imam Rabbanit, ajetet muteshabih janë zemra ose thelbi i Kuranit, ndërsa ato muhkem janë si mbështjellësja e jashtme e këtij thelbi. Ajetet muteshabih janë e vërteta, ndërsa ato muhkem janë pamja e jashtme ose forma e këtyre të vërtetave. Pra, simbolet dhe shenjat e vërteta nuk fshihen tek ajetet muhkem, por tek ato muteshabih.

Dijetarët që kanë mbledhur dijet dhe urtësinë, mësojnë ajetet muhkem dhe i komentojnë ajetet muteshabih me ndihmën hyjnore, duke arritur kështu dituri të thella. Në këtë mënyrë, ata mbledhin të vërtetën dhe formën e jashtme, ajetet muteshabih dhe ato muhkem.

Mirë, po si mund t'i mësosh dijet e ajeteve muhkem dhe muteshabih të dyja së bashku. Në lidhje me këtë, Imam Rabbani përgjigjet: "Kush mundohet të interpretojë ajetet muteshabih pa i mësuar dhe pa i praktikuar siç duhet ajetet muhkem, i ka hyrë rrugës së mendimit të së vërtetës (thelbit) duke braktisur formën e saj. Këta njerëz janë edhe të paditur, por edhe nuk e dinë që janë të paditur. Edhe pse kanë devijuar nga e vërteta, këta kujtojnë se janë në rrugë të drejtë. Gjithashtu, këta nuk e dinë që kjo botë përbëhet nga forma dhe e vërteta (thelbi). Sa të ekzistojë kjo botë, e vërteta nuk ndahet kurrë nga forma." (II, Letra 276.)

Imam Rabbani mendon se ajetet muhkem dhe muteshabih, e dukshmja dhe e fshehta, tarikati dhe sheriatit, janë të bashkuara si mishi me thoin dhe nuk duhet të ndahen nga njëra-tjetra. Kush lë njërin prej këtyre, privohet edhe nga tjetra. Ndërsa dallimin në zbatimin e këtyre njohurive midis sufive, Imami e shpjegon duke komentuar ajetin: "**Adhuroje Zotin tënd derisa të të vijë dija e qartë!**" (Hixhr, 99) Shprehja "jakin /dija e qartë", që kalon në ajet, sipas komentuesve të Kuranit, nënkupton vdekjen. Allahu i Madhëruar u jep fund adhurimeve

1. - Huruf-u mukattaa: Disa prej sureve të Kuranit fillojnë me germa të ndara ose të bashkuara, që në dukje nuk kanë kuptim, siç janë "Ja-Sin", "Sad", "Bekare/Elif, Lam, Mim" etj.

të robit me ardhjen e fundit të jetës së kësaj bote që është vdekja. Kjo, sepse për njeriun që ka vdekur, ka ndodhur edhe kiameti. Ndarja e formave që shprehin të vërtetat, mund të realizohet vetëm në botën tjetër, e cila është edhe vendi ku do të shfaqen të vërtetat.

Secila prej dy jetëve ka ligjet e saj të posaçme. Kush i ngatërron ligjet e njëres me të tjetrës, e bën ose nga padituria, ose nga mosbesimi. Ndërsa qëllimi është që të nxjerrë jashtë loje ligjet e shariatit. Çdo ligj i shariatit, që ka për detyrë të zbatohet çdo fillestar, i cili ndodhet në fillim të rrugës, është i detyrueshëm të zbatohet edhe nga ata që kanë arritur në fund të rrugës. Në lidhje me këtë çështje, nuk ka asnjë dallim ndërmjet myslimanëve të thjeshtë dhe atyre të ditur, të gjithë janë të barabartë. Pra, nuk bëhet fjalë që njëra palë të ndahet nga tjetra në këtë çështje. (II, Letra 276.)

Me anë të këtyre fjalëve, Imami u tërheq vëmendjen disa rretheve të tasavufit, të cilët duke përdorur ajetet muteshabih, shpikën rrugë të devijuara sipas dëshirës së tyre. Përkundër asaj që mendojnë këto rrethe sufiste, shariatit është i detyrueshëm për të gjithë sufistët, si në fillim ashtu edhe në fund të rrugës së tyre. Për shembull, namazi e largon njeriun nga çdo e keqe. Pra, e vërteta (thelbi) e namazit, i cili vetë është një lloj forme, e ndalon njeriun nga amoraliteti dhe të këqijat. Nëse një njeri thotë: "Zemra ime është e pastër, unë nuk bëj asnjë të keqe, prandaj nuk kam nevojë të fal namaz", ai njeri e ka ngatërruar shariatit me të vërtetën dhe ka masakruar njërin në emër të tjetrës. Në mënyrë të veçantë, Imami kritikon prirjet e disa sufistëve, të cilët e vendosin "marifetin"² kundër shariatit:

Sufistët fillestarë e të paedukuar dhe njerëzit e devijuar, duke e nxjerrë veten nga nënshtrimi ndaj shariatit, pandehin se ligjet e shariatit janë vetëm për njerëzit e thjeshtë, ndërsa dijetarët si ata vetë, duhet të merren vetëm me marifetin... Ata thonë se qëllimi i zbatimit të ligjeve të shariatit, bëhet për të arritur marifetin, prandaj, kur arrihet marifeti bie edhe përgjegjësia ndaj ligjeve të shariatit. Dhe për të argumentuar këtë pretendim ata tregojnë ajetin: **"Adhuroje Zotin tënd derisa të të vijë dija e qartë!"** Me këtë, ata e lidhin përfundimin e adhurimeve me njohjen e Allahut të Madhëruar, pra me arritjen e marifetit. Mirëpo, qëllimi i atyre që e komentojnë fjalën "Jakin" me njohjen e Allahut të Madhëruar, është të deklarojnë se përfundimi i vështirësive të adhurimeve vjen me arritjen e marifetit, njohjen e Allahut. Në fakt, nga interpretimi i kësaj fjale nuk duhet të synohet përfundimi i adhurimeve, sepse një kuptim i tillë e

2. **Marifet:** Si term i tasavufit do të thotë, urtësi, dije, njohje e thellë e të vërtetave hyjnore, e cila shpesh përjetohet dhe përfitohet nga gjendjet e larta shpirtërore dhe jo thjesht me lexim e studim.



devijon dhe e nxjerr njeriun nga feja.

Imam Rabbani, përveç këtyre lloj sufive që e prishin kuptimin e një ajeti muhkem duke i dhënë formën e një ajeti muteshabih, kritikon edhe pretendimet e tjera të gabuara në lidhje me adhurimet. Ata që kanë pretendime të tilla, thonë: "Kush ka arritur marifetin, nuk i kryen adhurimet, për shkak se ka nevojë vetë, por për të qenë shembull për të tjerët". Po ashtu, ata thonë: "Nëse Shejhu nuk tregohet dyfytirësh (në çështjen e adhurimit), muridët (nxënësit) e tij nuk do të përfitojnë prej tij". Këtyre lloj pretendimeve, Imami u përgjigjet duke thënë: "Allahu i poshtëroftë këta lloj njerëzish. Sa të paditur që janë! Në fakt, ata që kanë arritur marifetin, kanë nevojë për adhurimet dhjetë herë më shumë se muridët e tyre. Kjo, sepse ngritja e tyre në grada të larta, varet nga adhurimet dhe zbatimi i ligjeve të shariatit."

Si rezultat i adhurimeve të tyre, ata i arrijnë sot ato që njerëzit e thjeshtë do t'i arrijnë nesër. Nga kjo, kuptojmë se ata që kanë arritur marifetin, kanë më tepër përgjegjësi për kryerjen e adhurimeve dhe kanë më shumë nevojë se të tjerët për zbatimin e ligjeve të shariatit.

Si përfundim, adhurimi kërkon marifet dhe marifeti adhurim. Asnjëra nuk është alternativa e tjetrës, por plotësuesja e saj. Sufitë që i ngatërojnë me njëri-tjetrin Shariatit, Tarikatit dhe Hakikatit (të vërtetën), janë një gabim të madh.

I lutemi Allahut të Madhëruar, që të mos na ndajë kurrë nga rruga e mesme dhe na dhëntë mendje të shëndoshë për të kuptuar dhe jetuar siç duhet fenë e Tij. Amin!..



Islami

FE E SIGURISË

Që nga dita e parë e ardhjes në këtë botë njeriu e ka të domosdoshme të jetë i sigurt nga çdo gjë që do ta rrezikonte apo dëmtonte atë. Nevoja për siguri është e mbjellur në instinktin e natyrës së njeriut. Ndjenja e sigurisë është njëra nga nevojat themelore të njeriut. Siguria dhe rehatia janë ndër begatitë më të çmuara që na ka dhënë Allahu (xh.sh.). Siguria është njëra nga shtyllat e lumturisë dhe të suksesit. Pikërisht për këtë arsye, Profeti (a.s.), ka thënë: *“Atij që zgjohet në mëngjes duke qenë i sigurt për familjen dhe pasurinë e tij, gëzon shëndet të plotë dhe ka të siguruar ushqimin e asaj dite, ta dijë se i janë dhënë të mirat e kësaj dynjaje.”* Vetë Ibrahim (a.s.), i është lutur Allahut (xh.sh.), që t’i japë siguri vendit të tij: **“O Zoti im, bëje këtë vend qytet të siguri...”** (Bekare, 126)

Siguria dhe qetësia, numërohen si mirësitë më të mëdha që të fal Zoti, gjë të cilën Ai ia vë në dukje kurejshëve të Mekës: **“Prandaj le të adhurojnë Zotin e kësaj shtëpie (Qabes), i Cili i ushqen ata në ditë urie dhe i siguron në ditë frike”**. (Kurejsh, 3-4) Zoti e quan xhenetin, shtëpinë dhe vatrën e sigurisë dhe të stabilitetit. **“Atyre do t’u thuhet: ‘Hyni atje me paqe dhe siguri’**” (Hixhr, 46)

Përshëndetja e myslimanëve **Selami** është siguri: Të japësh dhe përshëndetësh me selam, do të thotë të nënshkruash marrëveshje paqeje dhe sigurie mes teje dhe tjetrit.

SIGURIA DITORE:

Pejgamberi (a.s.), ka thënë: *“Kush e fal namazin e sa-*

bahut me xhemat, është në mbrojtjen e Zotit (xh.sh.). (Muslim) Gruaja e cila e fal namazin e sabahut në kohë, në shtëpi, ka sevape sa burri që e fal sabahun në xhami. Pejgamberi (a.s.), ka thënë: “Kush e fal namazin e sabahut dhe të ikindisë hyn në xhenet”. (Buhari) Dijetarët kanë dhënë dy kuptime lidhur me këtë hadith:

1. Këtë hadith Pejgamberi (a.s.), e ka thënë në fillim të Islamit, kur myslimanët kanë pasur si detyrim faljen 2 herë në ditë, para lindjes së diellit dhe para perëndimit të tij. Në atë kohë nuk ishin obliguar ende 5 namazet.

2. Nuk kemi argumente se Pejgamberi (a.s.), këtë e ka thënë në fillim të Islamit. Ky hadith vlen si në fillim të Islamit, si më vonë në ditët tona. Pejgamberi (a.s.), me këtë hadith do të tregojë vlerën dhe rëndësinë që kanë këto dy namaze, por pa i nënvleftësuar me këto fjalë veprat dhe namazet e tjera. Në shumë hadithe të tjera ka thënë: *“Kush respekton prindërit hyn në xhenet”, “Xheneti është në këmbët e nënës”*. Këto hadithe tregojnë vlerën dhe rëndësinë e prindërve në Islam.

Pejgamberi (a.s.), ka thënë: *“Ju shoqërojnë disa melaike natën dhe disa të tjerë ditën dhe mblidhen në namazin e ikindisë dhe namazin e sabahut, pastaj ngrihen ata të cilët kanë qëndruar natën dhe i pyet (edhe pse Allahu e di më mirë se ata) dhe u thotë: ‘Si i latë robërit e Mi?’ Melaiket do të thonë: ‘I lamë duke falur namaz dhe kur shkuam i gjetëm duke falur namaz.’”* (Buhariu, Muslimi)

Pejgamberi (a.s.), ka thënë: *“Ai që e fal jacinë me xhemat e ka shpërblimin si të ishte falur gjysmën e natës,*



kurse ai që e fal namazin e sabahut me xhemat e ka shpërblimin si të jetë falur tërë natën.” (Muslimi)

Ubej ibn Kabi ka thënë: “Një ditë na priu Pejgamberi (a.s.), në namazin e sabahut dhe pastaj tha: “A e patë filanin (në xhami)?” Të pranishmit i thanë: “Jo.” Tha: “Po filanin e patë?” I thanë: “Jo.” Pejgamberi (a.s.), tha: “Me të vërtetë këto dy namaze janë namazet më të vështira për munafikët dhe sikur ta kishit ditur se çfarë shpërblimi kanë, do të vinit në xhami edhe duke u zvarritur.” (Ebu Davudi) Dijetarët thonë se munafikët janë fshehur në sabah dhe në jaci, sepse në kohën e Profetit (a.s.), nuk ka pasur drita.

SIGURIMI I SHËNDETIT:

Tensionet e ditës dhe stresi ndikojnë negativisht në shëndetin e njeriut dhe e dobësojnë sistemin imunitar ndaj sëmundjeve.

Allahu (xh.sh.), thotë: **“Vërtet, zemrat qetësohen me përmendjen e Allahut!”** (Ra’d, 28) Prandaj shtojë përmendjen e Allahut, që të qetësohet zemra jote, të forcohet trupi dhe të gëzosh shëndet të plotë.

SIGURIMI I LUTJES:

Nëse kërkon që të të pranohet lutja, atëherë lutu për vëllain tënd mysliman me atë dua që do të dëshiroje që ai të lutet për ty. Pejgamberi (a.s.), ka thënë: “Lutja e myslimanit në fshehtësi për vëllain e tij është e pranuar. Pranë tij qëndron një melek dhe sa herë që ai lutet për vëllain e tij, meleku thotë: Amin – O Zot pranoje (Ashtu qoftë)”.

SIGURIMI I GJUMIT:

Në mënyrë që mos të të shqetësojnë ëndrrat e këqija, kujdesu që të lexosh lutjet e gjumit. Më e rëndësishmja prej tyre është leximi i Ajetit Kursij (Bekare, 255)

Pejgamberi (a.s.), ka thënë: “Kur të shtrihesh për të fjetur, lexoje Ajetin Kursij, sepse pranë teje do të qëndrojë një melek i dërguar nga Allahu, që të të mbrojtë nga shejtani deri në agim”.

Gjithashtu Profeti (a.s.), ka thënë: “Dy ajetet e fundit të sures Bekare do t’i mjaftojnë për një natë kujtdo që i lexon ato” (Buhari)

SIGURIMI KUNDËR SHEJTANIT:

Profeti (a.s.), ka thënë: “Kush thotë kur del nga shtëpia e tij:

“Me emrin e Allahut, vetëm te Allahu mbështetem, nuk ka forcë as fuqi përveç forcës dhe fuqisë së Allahut”, i thuhet: “Të mjafton ajo që the dhe Shejtani do të largohet prej tij”. (Ibn Maxhe)

SIGURIA PËR FITIMIN E XHENETIT:

Pejgamberi (a.s.), ka thënë:

“Kush e lexon Ajetin Kursij pas çdo namazi farz, nuk ka për ta ndaluar atë nga hyrja në xhenet asgjë përveç vdekjes.” Ky hadith ka dy kuptime:

a. Ky njeri është gjallë, prandaj nuk ka hyrë në xhenet.

b. Në botën tjetër nuk ka vdekje, pra nuk e pengon asgjë për të hyrë në xhenet. (Nesai dhe Ibn Hibbani, dhe e ka saktësuar Shejh Albani)

SEJIDUL-ISTIGFAR MË E PËRZGJEDHURA MËNYRË E PENDIMIT.

O Allah, ti je Zoti im, nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Teje; Ti më ke krijuar dhe unë jam robi Yt, e unë ndaj besëlidhjes dhe premtimit Tënd do të qëndroj besnik sa të mundem, Kërkoj mbrojtjen Tënde nga e keqja që kam vepruar.

Jam mirënjohës ndaj dhuntive të Tua, i pranoj gjynahet e mia, prandaj më fal, sepse vërtet gjynahet nuk i fal askush tjetër përveç Teje!

Profeti (a.s.), tha: “Kush e thotë këtë lutje gjatë ditës, me bindje të plotë në lutjen e tij dhe vdes para se të ngriset, ai do të jetë banor i Xhenetit. Gjithashtu, kush e thotë këtë dua në mbrëmje dhe vdes para se të agojë, ai do të jetë banor i xhenetit.” (Buhari)

SIGURIA NDAJ FATKEQËSIVE TË PAPRITURA:

“Kush e thotë këtë dua tri herë në mëngjes dhe në mbrëmje, nuk do t’i bëjë dëm asgjë.”

Me emrin e Allahut pranë emrit të të Cilit nuk bën dëm asgjë në tokë dhe as në qiell, Ai dëgjon çdo gjë dhe di çdo gjë. (Ebu Davudi, Tirmidhiu, Ibn Maxhe dhe Ahmedi)

EDHE NJË HAFIZ I RI NGA MEDRESEJA E GJAKOVËS

Medresesë së Gjakovës iu shtua edhe një hafiz i ri. Dëshira dhe pasioni për të mësuar Kuranin përmendësh e detyroi Albion Qerkinin të lërë vendlindjen Ferizaj për t'u regjistruar në medresenë e madhe të Gjakovës. Albioni krahas ndjekjes rregullisht të programit mësimor të shkollës fillore arriti të mësojë përmendësh gjithë Kuranin.

Përfundimi i Kuranit përmendësh ishte një ditë e veçantë për Albionin, familjen e tij, shkollën dhe gjithë komunitetin mysliman.

Në ceremoninë që u organizua midis shumë personaliteteve nga Gjakova dhe Prizreni mori pjesë edhe kryetari i komunitetit mysliman të Kosovës z. Naim Tërnavë. Z. Tërnavë në fjalën e tij midis të tjerash falënderoi edhe shoqatën Istanbul për kontributin dhe ndihmën e madhe që jep në fushën e arsimit dhe edukimit. Gjithashtu Z. Tërnavë nuk harroi për falënderuar stafin e përkushtuar të medresesë së Gjakovës me në krye z. Gençer Dirvari.



KJO PAJISJE DO TË PËRGJYSMOJË KOHËN E KARIKIMIT TË TELEFONIT TUAJ



SONICable mund të përgjysmojë sasinë e kohës që nevojitet për ta mbushur një bateri nga zero në 100 për qind kur është i fikur. Ai vepron si një kabëll USB-je që karikon pajisjen. Shumë nga teknologjitë e karikuesve që premtojnë përsheptimin e kohës së karikimit të plotë të një telefoni ose tablete, janë ende koncepte, ose ndodhen në fazat e hershme të zhvillimit. Ndërsa SONICable është ndryshe – jo vetëm që pretendon të përgjysmojë sasinë e kohës që nevojitet për ta mbushur një bateri nga zero në 100 për qind, por mund të blihet

edhe me porosi për një set iPhone dhe Android.

Kur lidhet, por është i fikur, SONICable vepron si një kabëll USB-je standard dhe e karikon pajisjen, duke sinkronizuar përmbajtjen. Mirëpo, ku ndizet, sinkronizimi merr fund dhe kabëlli e përqendron të gjithë energjinë në karikim. Krijuesit e tij pretendojnë se ky proces zgjat sa gjysma e kohës normale të karikimit të pajisjes.

Teknikisht, ai është ende një prototip, por modelet në zhvillim mund të blihen nga Indiegogo dhe do të eksportohen brenda më pak se 2 muajsh. SONICable shoqërohet me një kabull për iPhone 5 dhe modelet e radhës, brezin e katërt të iPad dhe seritë mini të iPad, si dhe një mikroUSB për modele si Samsung, HTC dhe pajisje të tjera, përfshirë ereaders.

Fushata e zhvilluar nga Indiegogo ka mbledhur deri tani 178.832 dollarë. Produktet fillestare prej 20 dollarësh dhe 23 dollarësh janë shitur, por ende mund të blihet një kabëll i vetëm me 27 dollarë ose dy të tillë, me 49 dollarë. Çmimi i produktit jashtë SHBA-ve pritet të jetë 36 dollarë.

KUJDES NË POSTIMET E FOTOVE TË FËMIJËVE NË FACEBOOK

Nuk kalon asnjë ditë që fëmijët mos të bëjnë diçka që meriton të regjistrohet me smartphone: fjala e parë, një vizatim, fytyra. Me dëshirën për të fiksuar çdo moment, ju shkrepni, filmni, arkivoni tonelata me material, që pa u menduar shumë, i postoni në Facebook dhe në rrjete të tjera sociale.

Por edhe mund të ndalni! Dhe jo vetëm sepse miqtë tuaj mund të jenë lodhur së pari foto e video kalamajsh, por sepse kjo mani për të ndarë gjithçka, kur bëhet fjalë për fëmijët, mund të mos jetë një ide aq e mirë. Dhe me këtë mendim, një numër në rritje prindërisht amerikanë, ka nisur, muajt e fundit, të heqë foto, video dhe informacione për fëmijët nga rrjeti social më i famshëm në botë. Sipas këtyre prindërve, në fakt, të arkivosh përvojën e prindërimit në Facebook mund të të kthehet kundër për një varg arsyesh:

1- Imazhet, videot dhe informacionet (ditëlindja,

festat e shkollës etj.) i japin të dhëna çdo keqbërësi, që me disa click të mësojë ç'pamje ka fëmija juaj, në çfarë shkolle shkon dhe në ç'orë ti e lë në palestër për orën e karatesë.

2- Nuk e dini asnjëherë me saktësi si do i përdorë rrjeti social imazhet dhe informacionet për fëmijët tuaj.

3- Nuk është e thënë që fëmija juaj do jetë shumë i lumtur kur të hyjë vetë në Facebook e të shohë që disa nga etapat më të sikletshme të fëmijërisë janë përhapur në të katër anët e rrjetit.

Por nëse numri i prindërve të ndërgjegjësuar po rritet, nga ana tjetër copa e tortës e prindërve që ndajnë foto të fëmijëve në Facebook, ngelet e madhe. Nga një studimi i bërë në vitin 2011 nga Instituti për Kërkime Sociale i Universitetit të Michigan-it, 66% e prindërve amerikanë të lindur ndërmjet viteve '60 e '70 e ndajnë pa frikë jetën e fëmijëve në rrjete online.



USHQIMET QË JU NDIHMOJË TË PËRQENDROHENI




Ka disa ushqime të cilat janë veçanërisht të pasura me substanca si kripërat minerale, antioksidantë dhe aminoacide, të cilat ndihmojnë në përmirësimin e funksioneve të trurit.



Kombinimi i këtyre ushqimeve të shëndetshme në dietën tuaj të përditshme ndihmon trurin të punojë më mirë duke rritur përqendrimin. Ngrënia e ushqimeve të shëndetshme (këshillohen të jenë integrale dhe natyralë/bio), fjetja mjaftueshëm dhe aktiviteti fizik

që redukton stresin, janë disa nga faktorët kyç që ndikojnë në aktivitetin e trurit dhe rrisin mundësitë për të qenë të përqendruar.

Ju ndodh shpesh që në punë të shpërqendro-



heni, të mos arrini në kohën e duhur në mbledhje, të ngatërroheni dhe të pini shumë kafe për të mbajtur zgjuar receptorët tuaj? Nëse po, ju këshillojmë të provoni një dietë ku të kombinoni ushqimet e mëposhtme, dhe keni për ta parë se sa do të forcohet kujtesa juaj, e si rrjedhojë, do të rritet përqendrimi:

- Çokollatë fondente dhe kafe
- Salmon
- Farat e lulediellit dhe të kungullit
- Arrat
- Bananet dhe mollët
- Boronica
- Avokado
- Drithërat
- Bishtajoret
- Veza
- Brokoli dhe lule lakër
- Qepa
- Spinaqi
- Çaji jeshil dhe xhinxheri.



DOBITË E SHERBETIT TË MJALTIT



Mjafton një lugë çaji mjaltë në një gotë me ujë të vakët dhe do të përfojmë një ilaç shumë efikas për shëndetin tone.

Ja disa nga dobitë e kësaj recete të thjeshtë:

- Sjell fundin e problemeve në "zorrën qore".

- Forcon sistemin imunitar dhe është i shkëlqyer në luftën kundër bronkitit.

- Pastron traktin e tretjes nga parazitët dhe liron trupin nga toksina.

- Me të fillon një spastrim i plotë i trupit tuaj, sepse ajo ka veti antibakteriale dhe antivirale.

- Përmirëson zorrën e trashë dhe shkatërron mikroorganizmat.



- Gjithashtu mund të ndihmojë për urinimin e pa-kontrolluar gjatë natës.

Kjo përzierje duhet pirë në mëngjes me stomakun bosh. Por mund të përdoret edhe brenda natës. Kjo pije mund të konsumohet edhe para gjumit, sepse lehtëson punën e veshkave. Nga ana tjetër, kjo pije do ta bëjë lëkurën të ndritshme dhe të butë.

ARSYET PSE PIJET E GAZUARA JANË TË DËMSHME

Pijet me gaz edhe pse të shijshme janë të dëmshme për shëndetin. Mos i konsumoni ato nëse dëshironi të qëndroni në formë dhe të shëndetshëm.

Sipas studimeve këto janë 5 arsyet që tregojnë se konsumimi i pijeve me gaz është i dëmshëm:

DËMTON DHËMBËT

Kur ju konsumoni pije me gaz, të cilat kanë përmbajtje të lartë acidi ushqimor dhe sheqeri, kaviteti i dhëmbëve dëmtohet.

RREZIKONI DIABETIN

Sheqeri që përmbajnë pijet e gazuara është mjaft i dëmshëm për shëndetin. Konsumimi i tij rrit riskun për

tu prekur nga diabeti.

DOBËSON METABOLIZMIN

Mos i besoni reklamave se pijet e gazuara dhe energjike mund t'ju forcojnë dhe se duhet t'i konsumoni ato para stërvitjeve. Ju vetëm do të shtoni në peshë dhe do dobësoni metabolizmin tuaj.

DËMTON ORGANET

Është e vërtetuar shkencërisht se konsumimi i pijeve me gaz, "vret" gradualisht organet. Nëse konsumoni rregullisht pije me gaz mund të t'ju ndodhë të keni impakt negativ në sistemin e riprodhimit.



CIGARET ELEKTRONIKE, MË TË RREZIKSHME SE ATO NORMALE

Që cigaret mund të shkaktojnë kancer dhe të vrasin kjo është një gjë e ditur botërisht, madje edhe ata që e pijnë duhanin janë mëse të bindur.

Por sipas një studimi të fundit cigaret elektronike mund të vrasin më shumë se cigaret normale. Cigaret

elektronike kanë dalë si një alternativë e atyre normale dhe si një opsion për të lënë duhanin. Por studimi i fundit thonë se ato mund të shkaktojnë më shumë kancer se një duhan normal.

Cigaret elektronike lëshojnë më shumë formaldehidë, një lloj substance e cila shkakton kancer. Testimet janë kryer në disa lloje cigaresh elektronike dhe rezultatet kanë qenë të ngjashme. Sasia e formaldehidës që lëshojnë ato është më e madhe se gjithë cigaret normale.

"Është një flamur i kuq, një alarm për përdorimin e cigareve elektronike", tha Stephen Hecht, një kërkues për kiminë dhe duhanin në Universitetin e Minesotas.

